



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për situatën aktuale të sigurisë në vend, si dhe konstatimet e kryera nga vizitat e Komisionit për Sigurinë Kombëtare në drejtoritë vendore të policisë

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Luan Harusha, Artemis Dralo, Luan Duzha, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Edmond Rrushi, Ylli Shehu, Myslim Murrizi, Anduel Xhindi, Alban Zeneli, Edmond Stojku dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Arben Elezi, Lefter Maliqi dhe Paulin Sterkaj.

Të ftuar:

Ardi Velu – Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (drejtues madhor)
Tonin Vocaj – Drejtor i Departamentit për Policinë Kriminale (drejtues i lartë)
Gjovalin Loka – Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike (drejtues i lartë)
Edmond Tarkaj – Drejtor i Drejtorisë së Policisë Rrugore në DPPSH (drejtues i parë)
Shkëlqim Saço – Këshilltari i Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (drejtues i parë)

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare. Në rendin e ditës sot ne kemi planifikuar një seancë dëgjimore me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe me drejtues të tjerë të lartë të Policisë së Shtetit.

Tema kryesore e kësaj mbledhje lidhet me rezultatet e luftës kundër krimit për 9-mujorin e vitit 2019 dhe do të përqendrohem edhe në çështjen e aksidenteve rrugore, veprave penale që lidhen me këtë pjesë, për shkak se gjatë kësaj periudhe është parë që trendi i kësaj veprave penale ka qenë në rritje dhe ne nuk mund të jemi indiferent ndaj kësaj çështjeje. Prandaj si deputetë të këtij komisioni jemi të interesuar që të kemi një informacion të hollësishëm për të gjitha këto çështje.

Unë mendoj, dhe besoj se kam edhe mbështetjen e të gjithë kolegëve të mi, që informimi për çështjet në fjalë nuk i shërben thjesht punës tonë si deputetë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, por nëpërmjet nesh informohet publiku dhe nxitet përgjegjësia, për sa u takon aktorëve në linjën e parë të luftës kundër krimit, por njëkohësisht sensibilizohen akoma më shumë të gjitha agjencitë ligjzbatuese.

Puna e Policisë së Shtetit nuk zhvillohet në mënyrë të veçantë, por kërkon mbështetjen dhe suportin e të gjithë aktorëve të tjerë, si prokurorisë dhe gjykatës. Pra, nëse duam të kemi një shikim më objektiv të gjërave, ne duhet t'i lidhim të tre këta komponentë njëri me tjetrin.

Kolegëve të komisionit sot u është vënë në dispozicion një tabelë me rezultatet ose me të dhënat e veprave penale për 9-mujorin e vitit 2019.

Do t'u lutem medieve që të na lënë ta kryejmë këtë punë në qetësi. Ju keni punën tuaj dhe ju falënderojmë për interesin, por njëkohësisht mundemi që çdo gjë ta zhvillojmë në qetësi.

Falënderoj drejtorin e Përgjithshëm që ka qenë i gatshëm për ta informuar Komisionin e Sigurisë me të dhënat e kriminalitetit dhe të tjera, gjithashtu ka qenë gjithmonë korrekt për sa u takon të gjitha aktivitetëve dhe zhvillimeve të tjera të rëndësishme në Policinë e Shtetit, ku anëtarë të këtij komisioni kanë qenë pjesë, jo thjesht si të ftuar, por edhe si kontribuues.

Pa humbur kohë po ju prezantoj me të ftuarit. Të ftuar për të zhvilluar këtë seancë dëgjimore kemi drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotin Ardi Veliu, të cilit i uroj mirëseardhjen në këtë komision.

Faleminderit!

Kemi drejtorin e Departamentit për Policinë Kriminale, drejtuesin e lartë, zotin Tonin Vocaj. Mirëserdhe, zoti Vocaj!

Drejtorin e Departamentit për Sigurinë Publike, drejtuesin e lartë, zotin Gjovalin Loka. Faleminderit!

Drejtorin e Drejtorisë së Policisë Rrugore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtuesin e parë, zotin Edmond Targaj. Faleminderit!

Këshilltarin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtuesin e parë, zotin Shkëlqim Saço.

Faleminderit për prezencën dhe për faktin që ne u morëm vesh për një kohë të shpejtë, pavarësisht angazhimeve tuaja, për të pasur mundësinë e zhvillimit të kësaj seance dëgjimore!

Fjala është për zotin Veliu.

Faleminderit edhe një herë!

Ardi Veliu – E nderuara zonja kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë,

Është vlerësim dhe përgjegjësi për institucionin e Policisë së Shtetit që Komisioni i Sigurisë Kombëtare shpreh interesimin për punën dhe performancën në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër krimit. Në përgjigje të interesimit të anëtarëve të nderuar të këtij komisioni dhe në funksion të ushtrimit të përgjegjësi për kontrollin e ligjshmërisë dhe të veprimtarisë së Policisë së Shtetit, me lejon t'ju informoj për punën tonë në drejtim të parandalimit dhe goditjes së veprimtarisë kriminale në vend për periudhën janar – tetor të vitit 2019.

Në qendër të vëmendjes së të gjithë strukturave të Policisë së Shtetit, ka qenë puna për realizimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike të përcaktuara në politikat prioritare në fushën e rendit e sigurisë publike, në programin vjetor të punës të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, si dhe në dokumente të tjera të rëndësishme. Mund të veçoj strategjinë kombëtare për integrim dhe zhvillim, planin kombëtar të integritetit evropian të viteve 2018 – 2020, strategjinë për rendin dhe sigurinë publike gjatë viteve 2015 – 2020, strategjitë ndërsektoriale për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, për menaxhimin e integruar të kufijve e të tjerë.

Synimi ynë ka qenë dhe mbetet edhe përafrimi i standardeve të sigurisë në vend me ato të vendeve të Bashkimit Evropian dhe sundimi i ligjit në të gjithë territorin e vendit, duke punuar

në të njëjtën kohë si për realizimin e të gjitha objektivave që rrjedhin nga procesi i integritetit, ashtu dhe për përafrimin e legjislacionit të vendit me atë të vendeve të BE-së.

Unë jam munduar që materialin ta konkretizoj edhe me disa *slite*, sepse mendova se do t'i paraqisja këto, por meqenëse nuk mundem, me lejoni t'ju paraqes nga ana vizuale. Pra janë 3, boshte kryesore ku ne jemi fokusuar për të raportuar dhe njëkohësisht për të përmbushur edhe objektivat tona, siç e thashë, për përafrimin e standardeve të sigurisë dhe legjislacionit me vendet e BE-së, që është shtylla e parë.

Shtylla e dytë, është sundimi i ligjit në të gjithë territorin e vendit tonë dhe shtylla e tretë, është realizimi i të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit.

Paraprakisht më lejoni t'ju bëj me dije se gjatë muajit tetor kemi zhvilluar analizat e strukturave, ku ndërmjet të tjerave është bërë bilanci i punës së deritanishme dhe kemi përcaktuar se ku duhet të përqendrohemi në të ardhmen për të mundësuar realizimin e prioritetëve dhe objektivave në fushën e ruajtjes së rendit dhe të parandalimit e goditjes së kriminalitetit. Në këto analiza rezultoi se, si rezultat i masave dhe aktiviteteve të kryera, si dhe duke gjykuar nga trendi i deritanishëm i treguesve të punës, është plotësisht i mundshëm realizimi i prioritetëve dhe objektivave të vendosura në dokumentin tonë strategjik dhe në programin vjetor të punës.

Në funksion të realizimit të përgjegjësi, gjatë kësaj periudhe janë kryer një sërë veprimtarish të karakterit legjislativ, organizativ, operacional etj. Kështu, është miratuar ligji nr. 6 i vitit 2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë”, siç e njohim ndryshe FRONTEX, si dhe janë finalizuar disa marrëveshje në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve me një vend partner të BE-së, me OSBE-në, me Policinë e Kosovës dhe me Malin e Zi.

Aktualisht janë në ndjekje procedurat për finalizimin e disa marrëveshjeve të tjera, të cilat kanë për qëllim forcimin e bashkëpunimit me partnerët tanë ndërkombëtarë, ndër të cilat, më të rëndësishme mund të përmendim atë me FBI-në, për shkëmbimin dhe shfrytëzimin e informatorëve në hetimet kundër terrorizmit, me FRONTEX-in, për bashkëpunimin operacional dhe me Kosovën për përdorimin e përbashkët të oficerëve ndërlidhës.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar përmirësimit të kapaciteteve dhe rritjes së aftësisë së strukturave në luftën kundër krimit. Në këtë drejtim veçoj synimet tona për rritjen e kapaciteteve

të Policisë Shkencore, nëpërmjet zhvillimit të shumë kurseve trajnimeve, konferencave dhe takimeve, si pjesë të projekteve të ndryshme me BE-në, misionin PAMECA V dhe me shërbimet homologe. Ndërkohë vijon puna për akreditimin i Institutit të Policisë Shkencore në fushën e shkencave kriminalistike në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO/IEC 17205.

Edhe në *slite* ne jemi munduar për të paraqitur të gjitha kontaktet dhe bashkëpunimet që kemi si me organizatat ligjzbatuese në Bashkimin Europian, me homologët e Policisë së Shtetit, duke u fokusuar me EUROPOL-in, me FBI-në, me FRONTEX-in, me PAMECA V, me OSBE-në, me Interpolin dhe me radhë.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar me EUROPOL-in, oficeri i tyre i ndërlidhës ka filluar punë në vendin tonë si dhe jemi anëtarësuar në Platformën Europiane Multidisiplinore Kundër Kërcënimeve Kriminale, për Krimin e Organizuar Kundër Pronës, ndryshe EMPACT OPC.

Duke vlerësuar domosdoshmërinë e bashkëpunimit në rritjen e efikasitetit, sidomos në luftën kundër krimit të organizuar, ne i kemi kushtuar rëndësi shkëmbimit të informacionit me partnerët tanë. Kështu: Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana ka shkëmbyer 15478 informacione me zyrat homologe dhe Sekretariatin e Përgjithshëm të Interpolit, janë shkëmbyer 6634 informacione nëpërmjet kanalit të komunikimit SIENA të EUROPOL-it dhe nga oficerët tanë të kontaktit janë shkëmbyer 4680 informacione, duke realizuar 6,6% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera kanë dhënë rezultatet e tyre, duke bërë të mundur ndërmjet të tjerave që në bashkëpunim me Sekretariatin e Përgjithshëm të INTERPOL-it, EUROPOL-in dhe zyrat homologe, të zhvillojmë 55 operacione të përbashkëta, duke shënuar një rritje me 21 operacione ose 61,7% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Si rezultat i punës së bërë, nga ana e strukturave përgjegjësve për parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar është rritur numri i evidentimit të këtij krimi në masën 18%. Gjithashtu, është rritur numrit i konstatimit të dokumenteve false në masën 33% dhe numri i konstatimit të rasteve të kalimit të paligjshëm të kufirit në masën 34%. Është ulur numri i rasteve të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit në masën 12% dhe numri i rasteve të trafikimit të lëndëve narkotike në masën 32%. Vetëm nga këto struktura janë kapur 428 shtetas në kërkim, nga të cilët 339 në kërkim kombëtar dhe 48 në kërkim ndërkombëtar. Në 48 raste janë

sequestruar lëndë narkotike me një sasi prej 3.545 kg në total. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një ulje me 31 raste ose 39 % më pak, si dhe me 1919 kg ose 35% më pak se në vitin e kaluar.

Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin është vlerësuar gjithmonë si një drejtim i rëndësishëm pune, jo thjesht në funksion të luftës kundër krimit, por në radhë të parë për t'u shërbyer qytetarëve në kohën dhe me cilësinë e duhur. Është bërë e mundur rritja e besimit të ndërsjellë midis policisë dhe komunitetit si pasojë e vlerësimit në kohë dhe seriozitetit të ndjekjes së problematikave apo shqetësimeve. Kështu, mund të veçojmë se për këtë periudhë janë marrë 454 602 telefonata nga publiku, mesatarisht 1515 telefonata në ditë ose 150 249 telefonata më shumë se vitin e kaluar. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për numrin e njoftimeve të ardhura në portalin “Komisariati dixhital”, ku kanë ardhur gjithsej 38 628 njoftime ose 1333 raste më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Pra çdo gjë që theksova më sipër ka ndikuar në përmirësimin e parametrave të punës sonë, në mënyrë të veçantë të treguesve të punës për parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit. Kështu, gjatë periudhës janar – tetor të vitit 2019 nga Policia e Shtetit janë evidentuar 29 676 vepra penale dhe janë zbuluar 25 648 ose 86,4% prej tyre. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rezulton se janë evidentuar 446 vepra penale më shumë ose 1,5% më shumë, ndërsa zbulueshmëria është pothuajse në të njëjtën nivel.

Për këtë periudhë janë verifikuar, hetuar dhe sequestruar shumë prona dhe llogari bankare që janë vënë nga veprimtaria kriminale e personave dhe e grupeve kriminale. Konkretisht janë kryer 91 hetime pasurore, nga 83 hetime për të njëjtën periudhë të vitit 2018, si dhe janë kryer 5647 verifikime pasurore për asete kriminale, nga 2625 verifikime të kryera vitin e kaluar. Këto aktivitete kanë bërë të mundur sequestrimin e aseteve kriminale për pastrim parash, sipas nenit 287 i Kodit Penal, në vlerën 34 587 611 euro dhe për hetime penale dhe pasurore sipas Ligjit Antimafia në vlerën 52 600 000 euro.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018, janë sequestruar më shumë se 41 milionë euro pasuri, llogari bankare dhe kesh, prej të cilave më shumë se 9 milionë euro për veprën penale: pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, si dhe 32 milionë euro më shumë në zbatim të ligjit antimafia. Këto janë paraqitur edhe në *slite*.

Goditje të rëndësishme u janë dhënë grupeve kriminale të krimit të organizuar. Kështu, janë goditur 34 grupe kriminale, prej të cilëve 22 grupe me aktivitet në fushën e narkotikëve, 6

grupe me aktivitet në fushën e krimit ekonomiko-financiar dhe 6 grupe me aktivitet në fushën e trafikeve të paligjshme. Ndërkohë, në rritje janë edhe referimet për veprën penale: grup i strukturuar kriminal në 35 raste gjatë këtij viti dhe 20 të tilla vitin e kaluar.

Janë zhvilluar 287 operacione policore, prej të cilave 62 operacione në bashkëpunim me partneret ndërkombëtarë. Të ndara sipas tendencave kryesore operacionet janë si më poshtë:

155 operacione policore në fushën e narkotikëve, prej të cilave 44 operacione në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe 111 operacione kombëtare.

47 operacione policore në fushën e trafikeve të paligjshme, prej të cilave 19 operacione në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe 28 operacione kombëtare.

85 operacione policore në fushën e krimit ekonomiko financiar, prej të cilave 4 operacione në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe 81 operacione kombëtare.

Bazuar në të dhënat dhe informacionet që disponojnë strukturat e Policisë së Shtetit dhe agjencitë e tjera të inteligjencës, niveli i kërcënimit në vendit tonë nga kryerja e akteve terroriste vazhdon të jetë i ulët. Vendi ynë, si anëtar i koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, ka mbështetur e vazhdon të mbështesë partnerët në këtë luftë, duke e konsideruar bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit si një nga prioritetet tona kryesore.

Në vijimësi ne kemi përmirësuar kuadrin ligjor dhe organizimin strukturor, me qëllim për të parandaluar dhe luftuar çdo kërcënimin ndaj sigurisë. Kjo ka sjellë përmirësimin në vijim të treguesve të punës, kështu ndër të tjera ka rritje në tërësi të hetimeve proaktive, si dhe rritje të hetimeve për veprën penale: financim i terrorizmit. Në këtë kuadër, nga ana jonë po punohet edhe për realizimin e detyrimeve tona në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Në qendër të vëmendjes ka qenë edhe parandalimi dhe goditja e veprave penale kundër personit. Për këtë periudhë janë evidentuar në total 2 465 vepra penale kundër personit dhe janë zbuluar 2 315 ose 93,9% prej tyre. Në krahasim me të njëjtën periudhë kemi 249 vepra penale më pak, ndërsa fuqia zbuluese është në shifra të përafërta. Vendin kryesor në këtë grup tendencash e zënë plagosjet e lehta dhe kanosjet.

Në grupin e veprave penale kundër jetës janë evidentuar 49 vrasje, nga 45 të ndodhura vitin e kaluar ose mesatarisht 1,5% vrasje për 100 000 banorë. Ndërkohë, në disa vende të rajonit, si në Maqedoninë e Veriut kjo mesatare është 0,8%, në Malin e Zi është 2,07% dhe në Kosovë është 3,59% vrasje për 100.000 banorë. Nënvizojmë se treguesit krahasues janë nxjerrë

për periudhën nëntëmuajore janar – shtator të vitit 2019. Nga vrasjet e ndodhura 40 prej tyre janë zbuluar ose 81.6%, me 66 autorë të dyshuar, nga këta janë arrestuar dhe ndaluar 43 dhe shpallur në kërkim 19 autorë.

Nënvizojmë se nga vrasjet e ndodhura, 14 prej tyre kanë ndodhur në familje dhe kanë shkaktuar 17 viktima, nga 10 vrasje në familje të ndodhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Vrasjet nga pakujdesia kanë ndodhur në dy 2 raste, ndërsa vrasje të mbetur në tentativë kanë ndodhur 80 raste, nga 100 të ndodhura një vit më parë, dhe janë zbuluar 67 prej tyre ose 83,8%.

Siç shihet edhe nga treguesit e mësipërm, krimet kundër jetës janë ulur, kemi rënie gjithashtu edhe të kanosjeve serioze për hakmarrje ose gjakmarrje, si dhe rënie të veprës penale të armëmbajtjes pa leje, ku për këtë periudhë janë evidentuar 806 raste, pra 78 më pak se një vit më parë dhe janë zbuluar 694 prej tyre ose 86,1%.

Por për këtë periudhë është rritur evidentimi i krimeve seksuale. Nga 88 krime të tilla që kanë ndodhur në vitin 2018, për këtë periudhë kanë ndodhur 131 raste, ndërsa forca zbuluese ndaj tyre vazhdon të jetë e lartë në mesataren mbi 90%.

Ndërkohë, ashtu siç u theksua edhe më lart, vazhdon të mbetet shqetësues fenomeni i dhunës në familje. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 1146 vepra penale në familje, sipas nenit 130 të germës “a” të Kodit Penal. Ndërkohë që gjatë kësaj periudhe janë evidentuar dhe trajtuar nga strukturat e policisë 4 032 raste të dhunës në familje.

Trendi i rasteve të dhunës në familje ka pasur një rritje nga viti në vit dhe ne vlerësojmë se kjo ka ndodhur për disa faktorë:

Së pari, është rritur ndërgjegjësimi i viktimave për denoncimin e rasteve.

Së dyti, rritja e besimit të publikut, në veçanti e viktimave të dhunës ndaj strukturave të Policisë së Shtetit.

Së fundi, me ndryshimet ligjore të vitit 2018 janë shtuar subjektet që mund të kërkojnë mbrojtje, në zbatim të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”.

Shqetësuese vazhdon të mbetet edhe përfshirja e të miturve në veprimtari kriminale apo të dëmtuar nga veprat penale. Janë evidentuar gjithsej mbi 1400 të mitur të dyshuar si autorë të veprave penale. Numri më i lartë i të miturve të dyshuar si autorë paraqitet në tendencat kriminale me rrezikshmëri të ulët shoqërore si “Vjedhje”, “Shkelje e rregullave të qarkullimit

rrugor”, “Dëmtime të tjera me dashje”, “Plagosje e lehtë me dashje”, “Shkatërrimi i pronës”, “Kanosje”, ndërsa në tendencat kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, numri i të miturve të dyshuar autorë është relativisht i ulët. Janë evidentuar gjithsej mbi 900 të mitur të dëmtuar nga veprat penale. Numri më i lartë i të miturve të dëmtuar nga veprat penale paraqitet në tendencat kriminale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si: “Dëmtime të tjera me dashje”, “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, “Vjedhje të tjera” dhe “Plagosje e lehtë me dashje”.

Duke e vlerësuar kriminalitetin në radhët e të miturve dhe ndaj tyre, në radhë të parë, si një problem të rëndësishëm social, strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit janë angazhuar në projekte të ndryshme për mbështetjen e tyre për edukim dhe integrim, duke bashkëpunuar për këtë qëllim me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me shkollat, shoqërinë civile dhe donatorë të ndryshëm.

Rënie të ndjeshme janë vërejtur edhe në lidhje me grupin e veprave penale kundër pasurisë. Kështu, nga 6147 vepra të tilla të ndodhura vitin e kaluar, këtë vit janë evidentuar nga policia 5585 me një forcë zbuluese në rënie në 54,7% nga 61,5%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në këtë grup veprash penale kanë rritje veprat penale “Shtrëngim me anë të kanosjes”, 43 nga 19, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; “Vjedhjet e bankave” 12 nga 7, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; “Vjedhjet e automjeteve”, 247 nga 210, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; dhe “Shkatërrim prone me zjarr”, 317 nga 225, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa të gjitha tendencat e tjera kriminale, si: “Vjedhje me armë” kemi një ulje 11 raste nga 18, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; “Vjedhje me pasojë vdekje” 0 nga 3 raste, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; “Vjedhje me dhunë” 66 raste nga 92, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; “Shkatërrim prone”, “Vjedhje banese”, “Vjedhje lokale tregtie”, “Vjedhje kompanie”, “Vjedhje të energjisë elektrike” apo vepra penale të tjera kundër pasurisë kanë pësuar ulje të ndjeshme, ndërsa forca zbuluese ndaj tyre në përgjithësi është në të njëjtat nivele.

Krimet mjedisore si “Ndërtimi i paligjshëm” dhe vepra penale të tjera kundër mjedisit janë evidentuar 2134 të tilla, nga të cilat janë zbuluar 2109. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rezulton se kanë ndodhur 1445 vepra penale ose një rritje me 689 vepra penale më shumë.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet kryesore të Policisë së Shtetit, duke u fokusuar kryesisht në luftën kundër drogës, trafiqeve të

paligjshme dhe grupeve të strukturuar kriminale me këto tendenca. Gjatë periudhës janar – tetor 2019 janë evidentuar në total 1737 vepra penale në fushën e narkotikëve dhe janë zbuluar 1490 ose 85,8%. Duke krahasuar të dhënat me të njëjtën periudhë të vitit 2018, konstatohet se kemi ulje në evidentimin e veprave penale me 17 vepra më pak.

Për sekuestrimin e lëndëve narkotike gjatë kësaj periudhe, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, konstatohet: ulje e sasisë së kokainës me minus 484 kilogramë; rritje e sasisë së heroinës me plus 5 kilogramë; ulje e ndjeshme e sasisë së marijuanës me minus 11 mijë e 275 kilogramë; ulje e ndjeshme e sasisë së vajit të hashashit me minus 50 litra; rritje e sasisë së hashashit me plus 779 kilogramë.

Për sasinë e kokainës së sekuestruar, theksojmë se vetëm në një rast është sekuestruar 137 kilogramë, e dyshuar si kokainë në operacionin “LIMIT”, gjatë zhvillimit të të cilit janë përdorur metodat speciale të hetimit, dorëzim i kontrolluar. Ky operacion është realizuar në bashkëpunim me autoritetet policore greke dhe DEA-n amerikane.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe luftës kundër kultivimit. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga “Plani Kombëtar kundër Kanabisit 2018-2020”, strukturat e Policisë së Shtetit kanë marrë dhe po zbatojnë të gjitha masat e nevojshme planifikuese, organizuese dhe operacionale në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Për këtë qëllim janë ndjekur me përparësi veprimtaritë e strukturave vendore për realizimin e detyrave që kanë të bëjnë me goditjen e aktivitetit të trafikimit dhe shpërndarjes së farave të kanabisit.

Gjithashtu, është bërë ndarja e zonave të përgjegjësisë dhe krijimi i grupeve të monitorimit. Sipas drejtorive vendore të policisë dhe përgjegjëse të këtyre grupeve, janë caktuar drejtorë qendrorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Këto grupe monitorimi kanë zhvilluar takime në strukturat vendore për prezantimin, njohjen me situatën në qark dhe ndarjen e zonave të përgjegjësisë mbi bazë drejtorie, komisariati dhe stacioni policie, si dhe kanë ndjekur çdo ditë në vijimësi dinamikën e zbatimit të detyrave dhe raportimet periodike të strukturave vendore të policisë.

Për sensibilizimin e komunitetit në parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike janë zhvilluar 609 takime me pjesëmarrjen e 14 mijë e 725 personave, në të cilat kanë marrë pjesë edhe drejtues të institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, drejtues të organeve të pushtetit lokal, përfaqësues dhe nxënës të shkollave e të tjerë.

Ndërkohë që për kontrollin e territorit në rang vendi, si serra, miniera, magazina, objekte, ish-objekte ushtarake, shtëpi të braktisura, stane, stalla, ambiente të hapura, e të tjera, janë angazhuar 56 mijë e 32 punonjës policie dhe 12 mijë 554 mjete, duke realizuar 131 mijë e 186 kontrolle dhe rikontrolle me 377 mijë e 298 orë shërbimi.

Vetëm nga monitorimet ajrore të kryera nga *Guardia di Finanza* gjatë këtij nëntëmujori janë evidentuar treguesit, si më poshtë: 80 misione fluturimi, 225 orë kohë fluturimi, 7350 kilometra katrorë me sipërfaqe të kontrolluar ose 25% e sipërfaqes totale, 108 raporte monitorimi, nga të cilat 56 raporte monitorimi (kamër + sensor) dhe 52 raporte ekstra (vetëm kamerë), 1103 vende të dyshuara në total (koordinata), nga të cilat 893 koordinata (vende) të konfirmuara, ku është gjetur bimë narkotike, 210 koordinata (vende), ku nuk është gjetur e kultivuar bimë narkotike, si dhe 25 mijë e 931 bimë të asgjësuara.

Aktualisht jemi njoftuar nga partnerët tanë se në datën 31 tetor kanë përfunduar misionet e fluturimit për vitin 2019.

Si rezultat i punës parandaluese, kemi tregues të mirë në drejtim të goditjes së kësaj veprimtarie. Janë evidentuar 453 vepra penale dhe nga 409 raste kultivimi janë zbuluar 235 ose 57,6%. Janë konstatuar 1006 vende kultivimi me gjithsej 90 mijë e 175 bimë narkotike të asgjësuara dhe sekuestruara, nga të cilat 14 mijë 886 bimë janë kapur në kubikë dhe 246 në proces tharjeje. Në qoftë se do të bënim një krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, Policia e Shtetit ka realizuar ose ka çelur 76 hetime proaktive në krahasim me 40 të tilla. Nga 76 hetime proaktive 33 janë realizuar me 140 autorë, ku 96 autorë janë arrestuar, 28 janë ndjekur në gjendje të lirë dhe 24 janë shpallur në kërkim. Vlen të theksohet se nga totali i bimëve narkotike të asgjësuara, 20 mijë bimë janë në funksion të procedimeve proaktive për të bërë të mundur dokumentimin me metoda speciale të veprimtarisë së këtyre grupeve kriminale.

Gjithashtu, janë proceduar penalisht edhe 193 autorë, administratorë të njësive administrative, kryepleq fshatrash, inspektorë të shërbimit pyjor, si dhe punonjës policie për veprat penale “Shpërdorim detyre” dhe “Moskallëzim krimi”, nga të cilët janë arrestuar 14 është ndaluar 1, janë ndjekur në gjendje të lirë 171 dhe janë shpallur në kërkim 7. Nga 193 personat e proceduar, 5 prej tyre janë punonjës policie, 6 kryetarë të njësive administrative, 111 kryepleq fshatrash dhe 71 punonjës të shërbimit të policisë pyjore.

Gjatë periudhës janar – shtator të vitit 2019 janë evidentuar 1437 vepra penale në fushën e trafikeve të paligjshme, nga të cilat janë zbuluar 1399 ose 97,4% e tyre. Nga krahasimi i të

dhënave statistikore për 10-mujorin e vitit 2019 me ato të së njëjtës periudhë të vitit 2018, rezulton se kemi një rritje të konsiderueshme të veprave penale me 193 raste dhe rritje të zbulueshmërisë me 0,6 %.

Rritja e numrit të veprave penale vjen si rrjedhojë e shtimit të evidentimit të veprave penale “Kalim i paligjshëm i kufirit” dhe “Trafikimi i mjeteve motorike”, ndërkohë që kanë ulje të ndjeshme tendencat veprat e “Trafikimit të armëve dhe municioneve”.

Nga analiza e bërë situatës në fushën e trafikeve të paligjshme, vlerësohet se Shqipëria mbetet një vend origjine për kontrabandimin e shtetasve shqiptarë drejt vendeve të BE-së, Britanisë së Madhe, vendeve nordike, SHBA-ve dhe Kanadasë për qëllime emigracioni ekonomik. Format e identifikuar të kontrabandimit janë nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, rezervimit me qëllime turistike në vendet e Amerikës Latine e të tjera.

Gjithashtu, Shqipëria mbetet një vend transit për kontrabandimin e emigrantëve, të cilët vijnë nga Lindja e Mesme dhe hyjnë në vendin tonë në mënyrë të paligjshme nga kufiri i gjelbër me Greqinë, për të ndjekur itinerarin drejt Malit të Zi dhe Kosovës me destinacion vendet e BE-së.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe luftës kundër korrupsionit. Për periudhën janar – tetor 2019 janë evidentuar 1035 vepra penale, janë zbuluar 946 ose 89,6 % e tyre. Krahasuar më të njëjtën periudhë të një viti më parë, kemi 203 vepra penale më shumë të evidentuara.

Janë evidentuar 2836 vepra penale në fushën ekonomiko-financiare, nga të cilat u zbuluan 2635 ose 92,9 %. Krahasuar më të njëjtën periudhë të një viti më parë, kemi 122 vepra penale më pak, ndërsa fuqia zbuluese është rritur me 5%.

Për këtë periudhë kanë ndodhur 4716 vepra penale në fushën e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, ku vendin kryesor prej 2507 e zë drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt. Të krahasuara me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i këtyre veprave penale rezulton me ulje, respektivisht në 119 dhe 207 vepra penale më pak. Për këtë grup veprash janë penalizuar 4023 autorë, prej të cilëve 1993 janë arrestuar dhe janë ndaluar.

Ulje vërehet edhe në drejtim të aksidenteve rrugore. Kështu, për periudhën janar-shtator 2019 kanë ndodhur 1136 aksidente nga 1303 të ndodhura në të njëjtën periudhë të vitit 2018, të cilat kanë shkaktuar 152 të vrarë, 235 të plagosur rëndë dhe 1378 të plagosur lehtë. Vlen të nënvizojmë se gjatë këtij viti strukturat policore janë angazhuar edhe në ballafaqimin e veprave penale të tubimeve të paligjshme, ku janë evidentuar 120 vepra penale ose 79 vepra penale më

shumë se në vitin e kaluar, të veprës penale “Pengimi i qarkullimit të mjeteve” në 93 raste, si dhe të veprave penale që cenojnë zgjedhjet e lira në 37 raste.

Ndërkohë, janë evidentuar 628 vepra penale kundër punonjësve të policisë, me një trend në rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilën kanë ndodhur 645 vepra penale ose 17 më pak. Janë evidentuar 428 vepra penale kundër punonjësve në detyrë shtetërore, 404 vepra penale kundër drejtësisë dhe 1108 vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Ky është një prezantim përmbledhës për situatën e kriminalitetit dhe të rendit e të sigurisë në vendin tonë për këtë periudhë. Në këtë prezantim shpresoj të kem trajtuar të gjithë problematikën që ju jeni të interesuar. Ndërkohë që ne jemi të gatshëm të japim sqarime për çdo pyetje apo koment që mund të kërkohet nga ana juaj.

Faleminderit për vëmendjen!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti drejtor!

Sigurisht që çështja e kriminalitetit dhe çështjet që lidhen me rendin dhe sigurinë publike janë çështje që janë me interes, kanë sensibilitet të lartë në publik. Kjo tregon edhe qëllimin pse ne e kishim të nevojshme që ta zhvillonim këtë shkëmbim informacioni me ju. Nga ana tjetër, do të thosha se rezultatet, pavarësisht se ndonjëherë konsiderohen si thjesht shifra, në fakt, nuk është kështu, sepse ato shifra shërbejnë edhe për krahasimin, shërbejnë edhe për të arritur në konkluzione më të sakta. Unë mendoj se gjatë këtyre vjetëve në përgjithësi politika penale ka ecur paralel me shifrat. E bëj këtë konstatim jo thjesht për shkak të përvojës, por sepse na duhet vazhdimisht të kuptojmë çfarë mundemi të bëjmë më mirë. Ne jemi ligjvënës dhe në të gjitha takimet që kemi pasur në drejtoritë kryesore të policive të qarqeve në vend e kemi thënë shumë hapur këtë gjë me të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e thjeshtë të Policisë së Shtetit, me qëllim që të marrim më të mirën nga puna e tyre, të marrim vërejtjet konkrete, të njihemi me mungesat konkrete dhe t’i reflektojmë ato në legjislacion.

Më vjen mirë po ashtu të them se ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që edhe ministri i Brendshëm, në qoftë se ai dëshiron, mund të jetë prezent në këtë mbledhje. Kjo ishte një mbledhje e planifikuar më herët, pavarësisht se ne sot kemi një mbledhje për buxhetin me ministrin e Brendshëm.

Ju kërkoi ndjesë për ndërprerjen, vijojmë me mbledhjen.

Atëherë, doja të thosha se më vjen mirë që e konstatoj këtë gjë. Nisur edhe nga përvoja ime e gjatë e punës, sepse kam qenë deputete edhe në kohën kur kemi qenë në opozitë, edhe sot, ashtu si një pjesë e kolegëve të mi të këtij krahu që jemi në maxhorancë, dua të them se politika penale i ka pasur parasysh vazhdimisht rezultatet e pasluftës kundër krimit në momentin që ato janë ndërtuar si të tilla. Ne nuk kemi ecur thjesht me ashpërsimin e masave të dënimit, kjo është shumë pak, ta themi, madje më duket se është një shikim i përciptë i të gjithë punës që ndodh në Kuvendin e Shqipërisë. Patjetër që ndëshkimi më i rreptë vlen, pasi vlen edhe për të bërë parandalimin e posaçëm, siç e konsiderojmë ne, por vlen edhe për parandalimin e përgjithshëm. Unë nuk e shpjegoj dot ndryshe pse në statistikë, që ne kemi administruar këtë vit nga Ministria e Drejtësisë, na rezulton se në burgje nuk ka mbingarkesë, përkundrazi, të gjitha burgjet në Republikën e Shqipërisë janë në normën e tyre normale. Nga ana tjetër, besoj se jo vetëm puna juaj, por i gjithë kuadri ligjor ndihmon që puna të organizohet më mirë. Për shembull, ngritja së shpejti e BKH-së, së bashku me SPAK-un, pa dyshim që do ta ndihmojnë policinë që të performojë edhe më mirë, në mënyrë që rezultatet e punës së saj të mund të arrihen deri në fund. Po ashtu, fillimi i aplikimit të regjimit të “41 Bis” është diçka shumë e vlefshme dhe që në vetvete thërret përgjegjësi të tjera të Policisë së Shtetit, sepse Policia e Shtetit ka një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin e të gjithë personave të dënuar për kryerjen e veprave penale, në kuadër të organizatave kriminale për bashkëpunim të tyre nga brenda burgut me persona të tjerë jashtë burgut.

Po ashtu, rihapja e Akademisë së Policisë, e cila rihapet pas 10 vjetësh që ishte mbyllur, mendoj se do të ndikojë në rezultatet e luftës kundër krimit. Siç e thashë, ne kemi qenë prezentë në shumë drejtori të policisë së qarqeve dhe kemi parë se ka një numër jo të përshtatshëm policash në komunitet. Numri është i vogël për të përballuar të gjitha nevojat, që kryesisht kanë qytetet e mëdha në Shqipëri, por rikthimi në punë i Akademisë, patjetër që do ta ndihmojë shtimin e efektivëve të policisë dhe, siç është dukur, interesi është shumë i lartë.

Nga ana tjetër, të mos harrojmë se ne në ligjin “Për Policinë e Shtetit” ndryshuam limitin nga 1% deri në 3% të personave që vijnë nga jashtë Policisë së Shtetit. Kjo është një masë për të përmirësuar cilësinë brenda radhëve të Policisë së Shtetit, për të ftuar aty njerëz, të cilët kanë njohuri të posaçme që vijnë nga drejtime dhe nga fusha të tjera, por që janë të domosdoshëm për luftën kundër krimit edhe për shkakun se krimi ndryshon vazhdimisht trend, përsoset vazhdimisht, kështu që edhe ne nuk mund të ngelemi një akt hap pas. Pra, mendoj që të gjitha

këto e kanë rritur në vetvete punën tuaj, jo më kot policia shqiptare është pjesë Europolit, jo më kot rezultojnë këto shifra të mira të bashkëpunimit ndërkombëtar. Megjithatë, përtej fjalëve të mira dhe përtej korrektësisë suaj në dhënien e detajeve për punën, sigurisht që ngelen ende probleme dhe unë për këto dua të ftoj të gjithë kolegët e komisionit që të drejtonin pyetje. Njëkohësisht, dua që t'ju ftoj dhe ju shumë sinqerisht që të flisnit hapur për nevojat të tjera që ju mund të keni në punën tuaj. Ne sot do të diskutojmë buxhetin dhe një pjesë të atyre gjërave që lidhen me infrastrukturën, me pagesat, me mjetet patjetër që ne do t'ia kërkojmë ministrit të Brendshëm dhe qëllimi ynë ky është, që paraja publike të përdoret nga ato drejtime kryesore që i vlejnë luftës kundër krimit, por më pas për pjesë më të hollësishme, që lidhen me drejtimet kryesore të Policisë së Shtetit, me policinë kriminale, me sigurinë publike, me policinë e qarkullimit rrugor, natyrisht që do të ishte e mira që këto t'i ndanim që të kuptojmë edhe ne se çfarë mund të bëjmë më shumë me instrumentin ligjor dhe ku mundemi ta plotësojmë atë më mirë.

Fjala është për ju, kolegë.

Urdhëroni, zoti Zeneli!

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti drejtor!

Normalisht, ne jemi një komision që gjithmonë u kemi dhënë mbështetje të gjitha institucioneve të sigurisë. Arsyeja ka qenë, sepse siguria nuk është politike, por është e të gjithë qytetarëve pa ngjyra. Megjithatë, ju na sollët këtu përpara komisionit tonë një statistikë. Normalisht, statistikën gjithmonë fryhen, japin ngjyra, por nuk është ai rezultati që prekin qytetarët, por as unë, si anëtarë i këtij komisioni. Një ndër rreziqet më të mëdha që i vijnë shoqërisë sonë janë grupet e strukturuar kriminale, jo se veprat e tjera janë më të pakta në rolin e që luajnë ata në sigurinë e qytetarëve shqiptarë. Në retorikën politike që edhe ju si drejtor e keni pranuar që ka disa vjet që flitet për 40 familje mafioze që operojnë në Shqipëri. Unë dua të di nga ju nëse keni mundësi të na thoni, cilat janë këto 40 familje? Çfarë është bërë me këto 40 familje gjatë kësaj kohe? Sepse, në opinionin tim, por edhe të qytetarëve shqiptarë shpeshherë goditja ndaj këtyre grupeve kriminale të strukturuar jepet vetëm ndaj ushtarëve apo pjesës fundore të këtyre grupeve. Dua të di nga ju: është nga paaftësia e Policisë së Shtetit për t'i goditur peshqit e mëdhenj apo drejtuesit e këtyre grupeve të strukturuar kriminale, që janë një

rrezik evident në shoqërinë tonë, apo nga lidhja që kanë këta krerë të grupeve të strukturuar kriminale me politikën shqiptare?

Faleminderit!

Ardi Veliu – Faleminderit, i nderuar deputet!

Policia e Shtetit është organizatë, e cila në përbërje të saj ka disa struktura, të cilat janë përgjegjëse edhe për luftën ndaj krimit të organizuar. Ne çdo ditë jo vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, por edhe drejtoritë vendore punojnë për të mbajtur në kontroll gjendjen e rendit në tërësi, njëkohësisht, për të luftuar grupet e organizuara kriminale, të cilat janë edhe rreziku kryesor për prishjen e rendit e sigurisë publike dhe janë rrezik i shtuar për kryerjen e veprave të rënda kriminale.

Në lidhje me pyetjen për grupet kriminale, absolutisht që ne kemi një databazë, ku kemi të evidentuar aktivitetin e grupeve kriminale. Kjo databazë, nuk është se ka filluar dje apo sot, por ka një historik, sepse Policia e Shtetit është një organizatë, e cila punon mbi bazën e sistemeve, të cilat aktualisht, falë edhe mbështetjes së parlamentit apo qeverisë shqiptare, janë bërë realitet.

Vetëm gjatë vitit të kaluar janë goditur një sërë grupesh kriminale, të cilat kanë qenë në listën e grupeve kriminale të evidentuara nga task forca e ligjit, por edhe nga Policia e Shtetit. Besoj se ju i keni ndjekur komunikatat për shtyp, por edhe konferencat për shtyp që ka bërë Policia e Shtetit në lidhje me sukseset dhe realizimet e prangosjes së këtyre personave, por duhet të kuptojmë një gjë, dhe ne kërkojmë mbështetjen edhe të Komisionit të Sigurisë, që policia në këtë luftë nuk mund të jetë e vetme. Rasti më konkret është rasti i djeshëm, ku jeni njohur nga media, pavarësisht këmbënguljes së punës së palodhur të hetuesve, të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe Policisë së Shtetit. Besoj se vendimet e gjykatës i keni njohur se çfarë treguesi kanë dhënë. Unë nuk dua të bëjë komente në lidhje këtë, por ne nuk mund të jemi të vetëm. Kështu që duhet të kemi mbështetjen e gjykatave, nuk po them të prokurorisë, sepse prokuroria është absolutisht partnerja jonë kryesore dhe ka udhëhequr udhëtimin dhe na ka mbështetur, por me gjykatat Policia e Shtetit po zhgënjehet nga dita në ditë.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Zeneli.

Më pas fjalën e ka zoti Qefalia.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti drejtor!

Normalisht, mora një përgjigje deri diku të asaj që kërkoja, megjithatë te pjesa e fundit që ju thatë, absolutisht edhe unë jam i shqetësuar si çdo qytetar shqiptar në lidhje me këtë. A mos jemi përpara një cic-mici, pra policia me gjykatat mundohen t'ia lënë fajin njëra-tjetrës? Gjykata me faktet që ju dërgoni së bashku me prokurorinë përpara gjykatës. Nëse ju keni prova se gjykata po vepron në kundërshtim me ligjin, ato prova duhet t'i administroni dhe jo të na vini përpara opinionit publik dhe përpara komisionit e të na bëni retorikë. Retorikat, zoti Drejtor i Përgjithshëm, me gjithë respektin që kam për uniformën e policisë, duhet të mbarojnë një orë e më përpara. Reforma në drejtësi për këtë është bërë, pra që çdo njeri, sado i fortë të jetë, çdo gjyqtar, çdo deputet, çdo ministër, çdo ish-ministër, Kryeministër dhe të gjithë me radhë të shkojnë përpara drejtësisë. Absolutisht, puna kryesore ju takon juve, edhe për këta gjyqtarë që ju po i atakoni në këtë moment.

Faleminderit!

Ardi Veliu – Zoti deputet, nuk dua të replikoj. Nuk kam ardhur këtu të fals në erë, por kam ardhur si drejtuesi i organizatës që të mbroj punën e palodhur që 11 mijë punonjësit e Policisë së Shtetit po sakrifikohen dhe po përplasen çdo ditë. Nuk është retorikë, në qoftë se juve ju duket retorikë rasti i djeshëm, më pas kjo është çështje perceptimi, nuk është pjesa ime. Ne kemi dokumentuar veprimtarinë e gjykatave dhe në 27 raste ju keni dëgjuar edhe prononcimin e zotit ministër, ku ne i jemi drejtuar KLGJ-së, KLP-së në lidhje me shkeljet flagrante, të cilat, në këndvështrimin tonë dhe në analizën e provave që ne kemi bërë, janë haptazi në kundërshtim me ligjin. Nuk e di se çfarë duhet të bëjmë tjetër? Kjo nuk është retorikë, është një veprimtaria komplet e Policisë së Shtetit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ju lutem, të mos e bëjmë kështu, sepse është më shumë se sa një koleg që kërkon të flasë!

Zoti Alban, ju lutem, më dëgjoni një minutë! Ky lloj debati se kush e ka fajin, do të ishte pafund. Në qoftë se nuk marrim parasysh se deri në momentin që do të ngrihet Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që është një nga institucionet e tjera që parashikon reforma e drejtësisë, ne ndoshta nuk do të kemi një shikim të saktë të gjithë kësaj. Mungesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që presupozohet, dhe për këtë gjë është ndërtuar, të ndjekë çdo shkelje disiplinore në dosje, në hetim apo në gjykimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, sigurisht që na i bën pak të vështirë të shkojmë deri në fund të këtij debati. Ka një vërtetë në këtë mes që policia nuk shkon vetë

drejtpërdrejt në gjykatë, por shkon nëpërmjet prokurorisë dhe, natyrisht, prokuroria nuk është e lidhur në kuptimin se çfarë sjell policia, bën prokuroria, nuk janë aspak magazina të njëra-tjetrës, as gjykata e prokurorisë dhe as prokuroria e policisë, sepse janë aktorët kryesorë që i përcakton Kushtetuta për të ngritur akuzën publike. Kështu që, në rast se dhe prokuroria vetë nuk bindet për provat që sjell policia, sigurisht që nuk ka arsye që ta çojë në gjykatë, pra nuk duhet ta çojë në gjykatë. Këtë nuk e kam për të mbrojtur punën e policisë, por kështu ndodh dhe kështu e përcakton ligji se duhet të ndodhë. Janë pushtete tërësisht të ndara nga njëri-tjetri, madje ka një luftë të vjetër të heshtur në polici dhe në prokurori në kuptimin që prokuroria është më e pirur, për shembull, të jetë shumë e varur nga ajo që shikon policia, pra kërkon që të jetë pak më e ftohtë, të ketë një qasje tjetër në këtë pjesë. Unë them se kjo është e vërtetë e prekur nga të gjithë.

Reforma nuk ka arritur dot që të japë të gjitha rezultatet e pritshme, sepse, sigurisht, ka pasur vonesa, nuk ka pasur atë ecuri që kemi menduar, në momentet kur e miratuar. Në sistem ka ende shumë gjyqtarë dhe prokurorë, kryesisht janë të gjithë nga shkalla e parë, për të mos thënë dhe e gjithë shkalla e dytë, që ende nuk janë vetuar, nuk e kanë kaluar këtë proces. Kështu që ne duhet të jemi të vetëdijshëm që këto probleme do t'i kemi, por, nga ana tjetër, duhet të nxisim që sa më shpejt të kemi inspektorin, duhet të nxisim KLGJ-në dhe KLP-në që të jenë më reaktivë ndaj rasteve. Puna e tyre nuk mund të reduktohet thjesht në emërime të strukturave drejtuese të prokurorisë dhe gjykatave. Absolutisht, puna e tyre duhet të jetë në bllok edhe sa i takon reagimit të çështjeve, të cilat, natyrisht, zgjojnë reagim te qytetarët.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Drejtor i Përgjithshëm,

Absolutisht perceptimi im dhe i qytetarëve shqiptarë, e thashë kam shumë respekt për uniformën e policisë, sepse e di me çfarë mundi dhe sakrificash përballen, sidomos me këta grupe të strukturuar kriminale, edhe me drejtuesit e tyre. Është shumë e vështirë, madje më parë ka qenë shumë e vështirë që t'i çojë këta para drejtësisë. Absolutisht e mbështes punën e Policisë së Shtetit në çdo hallkë, por merakun im dhe i opinionit të gjerë është se nuk mund të merret se kush e ka fajin. Ata drejtues të këtyre grupeve kriminale i duan para drejtësisë. Ky është merakun im dhe i të gjithë qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Zeneli!

Fjalën e ka e ka zoti Qefalia dhe më pas zoti Braho.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Drejtor i policisë, dua të falënderoj për të gjithë ekspozenë që paraqitët, sepse ishit shumë shterues, madje më shumë se kushdo tjetër, duke sjellë në vëmendjen e komisionit të gjitha ato statistika dhe shifra! Njëkohësisht, në prezencën tuaj dhe të komisionit dua të falënderoj edhe drejtorët e policisë së qarqeve, që ne patëm mundësi t'i takojmë nga afër, duke sjellë në vëmendje të komisionit disa nga problematikat, të cilat janë vërtet aktuale dhe duhen marrë në konsideratë pse jo, meqenëse jemi në prag të buxhetit.

Ju në fjalën tuaj prezantuat goxha shifra, por unë, zoti drejtor, kam një merak, pasi lufta ndaj krimit është një luftë e përhershme dhe e vazhdueshme. Madje, ju sollët edhe statistika të ndryshme për vrasje, por unë ndaj një mendim disi ndryshe, pasi nuk është vetëm numri i ulët i vrasjeve në raport me shumë vite të tjera, por e rëndësishme është të përcaktohet, pasi vrasjet e ndodhura kohët e fundit janë gati si vrasje mafioze, të cilat kanë një prapaskenë të jashtëzakonshme dhe si anëtarë i kahershëm i Komisionit të Sigurisë jam i vetëdijshëm që krimi, sidomos vitet e fundit, ka ardhur duke u sofistikuar, madje kjo e shoqëruar me potencë ekonomike, por edhe me mjete, me teknologji dhe me gjithçka që e suporton krimin.

Zoti Drejtor, jam i interesuar sa është e përgatitur policia jonë për t'i përgjigjur në të njëjtën shkallë kriminalitetit, i cili tashmë vjen në një formë më të sofistikuar? Ju paraqitët disa shifra, të cilat me të vërtetë janë domethënëse për sa i përket rritjes së numrit të telefonatave, madje, në mos gabohem, numri i telefonatave kishte arritur në 400 e ca mijë. Ky është një konkluzion shumë i qartë, zoti drejtor, që është rritur besueshmëria e qytetarëve shqiptarë te Policia e Shtetit, madje jo vetëm duke telefonuar, por ju e përcaktuat edhe në disa shifra që 81% ka arritur zbulueshmëria dhe paraqitja menjëherë në këto vendngjarje.

Zoti Drejtor, ajo që dua të them në lidhje me këtë: mos ka ardhur koha që Policia e Shtetit duhet t'i rishikojë edhe një herë detyrat e saj organike, të mos shpërndahet në shumë detyra, të cilat i ka mbi kurriz shtesë, siç bëhet fjala për ndërtimet pa leje apo probleme të tjera, sepse kjo e humbet vëmendjen e policisë. Mos ka ardhur koha për të ndërhyrë ne si komision për t'i përcaktuar më saktë këto detyra specifike? Sepse jo në pak raste ju përmendët edhe një shifër tjetër, që në masat, që ka marrë policia, ka marrë edhe masa dhe ka ndëshkuar edhe punonjës policie dhe oficerë policie. Është një gjë që të inkurajosh që Policia e Shtetit është në rrugën e duhur edhe falë drejtimit tuaj dhe të gjithë stafit të policisë, por jemi dëshmitarë, sepse ne vijmë nga zona, ku kemi kontakt me qytetarët dhe në jo pak raste ka pasur edhe punonjës policie, të

cilët janë të kompromentuar në evidentimin e ngjarjeve, në evidentimin e ngarkesave që marrin qytetarët për ndërtime ndoshta edhe jo shumë problematike, sidomos në zonat rurale të Tiranës. Unë jam shumë i ndjeshëm dhe shumë fleksibël që kjo gjë duhet parë edhe nga ana e organizatës së huaj për të ndëshkuar ato punonjës policie, të cilët abuzojnë me detyrën që kanë. Pasi është shumë e rëndësishme që të ndiqet krimi se sa të ndiqet një banor i një zone të thellë që ndërtoi një çati apo diçka tjetër.

Kam edhe një pyetje të tretë, që ju e ezauruat, pasi gjej rastin t'ju falënderoj, pasi keni qenë shumë i hapur me të gjithë anëtarët e komisionit dhe në tërësi me deputetë të veçantë, të cilët kanë paraqitur interes për të pasur një informacion të saktë. Thamë që krimi është një fenomen, i cili nuk mund të luftohet vetëm nga policia. Kjo është më se e qartë: nëse nuk ka një bashkëpunim me organet ligjzbatuese, të cilat e bëjnë të mundur për ta sulmuar krimin dhe për ta goditur atë në embrion, rezultate do të jenë gjithmonë fiktive. Ju e thatë dhe e thatë me shqetësim të madh dhe unë e kisha ndërtuar pyetjen para se ju t'i përgjigjesht. Cilat janë grupet apo sa janë grupet apo individët, të cilët i janë rikthyer përsëri krimit, pasi ju keni operuar? Ju konstatoni, përgatisni dokumentacionin me oficerët e Policisë Gjyqësore, me prokurorët dhe paraqitet në gjykatë. Në mos gabohem, dua ta rikonfirmoni edhe një herë që këto grupe apo individë i janë rikthyer sërish krimit dhe nuk kanë marrë ndëshkimin e merituar; më thatë që është një numër mbi 20, dua ta rikonfirmoni drejtpërdrejt.

Ajo që përmendi kryetarja me të drejtë që me formëzimin e institucioneve përkatëse të sistemit të drejtësisë kushdo gjyqtarë apo prokuror, i cili do të mbulojë apo do të mbyllë çështje, do të ndëshkohet, por njëfarë fleksibiliteti dhe njëfarë ndjeshmërie do të duhet edhe nga ju si institucion, pavarësisht se nuk e keni detyrë të mirëfilltë, por në fund fare te ju togëzohet problemi. Kështu që në këtë rast dua që ta ritheksonit edhe një herë këtë dhe ta bënit prezente edhe pranë Komisionit të Sigurisë për ta bërë një çështje të të gjitha organeve ligjzbatuese. E përmenda edhe një herë, sepse vetëm ju si organizatë policie, nuk mund ta vendosni rendin në vend, sepse ju keni shumë sektorë, keni qarkullimin, keni krimin ekonomik, keni ambientin, keni mjedisin, keni ndërtimet pa leje, pra keni një sferë të jashtëzakonshme dhe, nëse nuk bashkëpunon Shërbimi Informativ, nëse nuk bashkëpunojnë organet e pavarura, siç është prokuroria dhe gjykata, krimi do të ngelet në vend dhe vrasjet do të pasojnë njëra-tjetrën dhe ne do të mburremi këtu, duke thënë po kemi një numër më të vogël vrasjesh se sa vitet e kaluara.

Faleminderit edhe për komentet që dëgjuat!

Ermonela Felaj – Faleminderit, koleg për të gjitha pyetjet dhe diskutimin tuaj!

Në fakt, desha t'i bashkohesha edhe unë pyetjes së e parë të zotit Qefalia dhe doja ta shtoja si një nënpyetje të vogël: realisht, çfarë vëreni ju si shqetësuese te krimi i vrasjes? Sepse, pavarësisht shifrave që deklarohen, besoj se bindja në opinion është ndryshe, pra ka një shqetësim edhe më shumë se sa për numrin, se ndoshta njerëzit numrat nuk i masin dot që të bëjnë krahasime dhe të mbajnë mend çfarë ndodhi vjet, parvjet e të gjitha me radhë, por i shqetëson mënyra e kryerjes së tyre, ana objektive, që ngelet shumë e rëndësishme. Për këtë, si hetues të drejtpërdrejtë të vendit të ngjarjes, dua realisht të kem një opinion për këtë pjesë.

Faleminderit!

Ardi Veliu- Faleminderit për pyetjen!

Unë e përmenda edhe gjatë raportimit tim që gjatë kësaj periudhe kemi 5 vrasje më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe disa prej këtyre janë vërtet vrasje të sofistikuara, ku edhe neve na është vështirësuar puna për të siguruar prova të qenësishme për të bërë të mundur zbardhjen dhe identifikimin e autorëve të këtyre veprave penale. Gjatë raportimit unë përmenda edhe vrasjet, ose mesataren e vrasjeve për 100 mijë banorë edhe me vende të cilat janë rreth vendit tonë dhe, nëse më lejoni, unë dua t'i përsëris. Maqedonia e Veriut ka një mesatare prej 0,8 vrasjesh për 100 mijë banorë, pra është më e ulëta në krahasim me vendet e rajonit, pas asaj vjen Mali i Zi me 2,7; Kosova 3,59, ndërsa ne e kemi 1,5. Unë nuk them se Policia e Shtetit është organizata më e mirë policore në rajon, por me këtë dua të siguroj dhe të garantoj se Policia e Shtetit është një organizatë, e cila punon 24 orë në 7 ditë të javës, shumë e motivuar dhe shumë e angazhuar që të sigurojë rendin, të përmbushë misionin e saj të ngarkuar nga ligji.

Gjithashtu, në raport unë përmenda që 40 nga vrasjet e ndodhura gjatë kësaj periudhe kemi mundur t'i zbardhim në kohë rekord dhe 81,6 % e fuqisë zbuluese të këtyre ngjarjeve na bën optimistë edhe ne si organizatë, por besoj se edhe te qytetarët është një tregues, ku rendi dhe siguria në vendin tonë është në një situatë të stabilizuar dhe nuk përbën problem. A i kemi marrë ne të gjitha masat dhe a është organizata e policisë në gjendje që të parandalojë dhe të shmangë këto ngjarje të rënda kriminale?! Siç e thashë edhe më parë, ne jemi duke punuar dhe duke analizuar, me qëllim për të parandaluar. Ndoshta ne, si organizatë policie, do të kishim nevojë, edhe me ndihmën e Komisionit të Sigurisë, të na jepen më shumë attribute apo më shumë kompetenca në drejtim të parandalimit. Ndoshta në të ardhmen kjo mund të merret nga ju në konsideratë, por duke e parë organizatën e policisë, e cila në vetvete është e përbërë nga 11 mijë

punonjës policie, por në krahasim me organizatat e policisë së vendeve të tjera të rajonit dhe me numrin e punonjësve të policisë për numër banorësh që kanë në përgjegjësi, ne jemi një organizatë policie jashtëzakonisht e vogël. Pavarësisht se në strategjinë 2015-2020 është përcaktuar që Policia e Shtetit duhet të rritet çdo vit me një numër mesatar prej 500 punonjësish policie çdo vit, kjo nuk është bërë e mundur dhe gjatë kësaj periudhe ne kemi një shtesë në numër dikur rreth 1000 punonjës policie, që janë shtuar gjatë vitit 2014 dhe 100 punonjës policie para 7 muajsh. Do të donim që edhe ju si Komision Sigurie të ushtronit presion pozitiv që numri i punonjësve të policisë të vijë në normën e Bashkimit Europian. Bashkimi Europian ka një numër punonjësish policie normë 220-240 banorë për një punonjës policie, ndërsa ne e kemi numrin e punonjësve të policisë 1 punonjës për 380 banorë, pra ka një përmbysje të shifrave. Nuk dua të justifikohem me këtë, por dua të jem realist me kërkesat dhe me atë çfarë prezantoj.

Lidhur me veprat penale, për sa i përket ruajtjes së mjedisit apo të kontrollit të territorit, përderisa ne i kemi të normuara dhe i kemi detyruese, jemi të detyruar të respektojmë ligjin, të ushtrojmë kompetencën dhe të kërkojmë zbatimin e ligjit për të gjitha detyrimet që neve na janë parashtruar. Gjatë punës së përditshme, pavarësisht shifrave që unë përmenda në lidhje me ndjekjen penale të 6 punonjësve të policisë, dua t'ju them se, përveç ndjekjes penale, ne në drejtorinë e standardeve profesionale kemi filluar me qindra hetime administrative në lidhje me mosveprimin apo mos respektimin e protokollove apo të procedurave standarde nga punonjës policie të të gjitha niveleve, duke u dhënë masa disiplinore me shtyrje afat gradimi dhe me masa të tjera sipas hierarkisë së vendosur në rregulloren e policisë dhe kjo punë do të vazhdojë gjithmonë.

Një etapë tjetër, e cila do të punojë për vetëpastrimin e organizatës së policisë, ju e keni parë, është procesi i vetingut, ku edhe ne jemi subjekt i tij. Besoj se ky proces do të ribëjë një filtrim të të gjithë punonjësve të policisë dhe absolutisht që do të ndikojë në rritjen e integritetit, jo vetëm atij individual, por edhe atij profesional të të gjithë organizatës.

Lidhur me përgatitjen e Policisë së Shtetit dhe aftësitë për të monitoruar dhe mbajtur aktivitetin kriminal të strukturave të krimit të organizuar, ju siguroj që ne jemi në gjendje jo vetëm t'i monitorojmë dhe t'i mbajmë nën kontroll, por edhe të tregojmë vullnet dhe veprime konkrete për të ashpërsuar akoma më shumë, nëse do të kemi mbështetjen tuaj, veprimtarinë kriminale të këtyre organizatave.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Veliu!

Fjalën e ka zoti Braho, pastaj zonja Gjebrea dhe zoti Xhindi.

Spartak Braho – Kam parasysh një fakt të rëndësishëm, që më detyron të marr fjalën dhe të diskutoj, sepse konstatimi kryesor i Komisionit të Sigurisë është që Policia e Shtetit, punon sakrifikon dhe arrin rezultate, në vija të përgjithshme, por ne duam të rritim nivelin e kërkesave, me qëllim që ai që quhet rend dhe siguri sot në Shqipëri të jetë vazhdimisht i garantuar, që njerëzit të jetojnë të qetë, kriminaliteti të goditet e të tjerë.

Komisioni i Sigurisë ka bërë inspektim në disa drejtori, një praktikë që vlen të përmendet. Nuk e di nëse jeni në dijeni të këtij materiali, por Komisioni i Sigurisë ka bërë inspekte në Tiranë, Elbasan Fier, Durrës, Vlorë Shkodër dhe Lezhë. Pavarësisht se problematika në polici është shumë më e gjerë, ky material rrok mjaft çështje, që për mua janë alarmuese. Unë e di që ju i dini këto problematika, por këta duan zgjidhje. Unë dua t’ju them që ky material, zonja kryetare, duhet të mbetet në komision dhe të mos dalë përjashta. Unë e njoh shumë mirë problematikën e drejtorisë së policisë së Durrësit, ku një pjesë e saj është bërë palë me krimin dhe duhet të bëni kujdes me qarkullimin e personave apo strukturave që kanë me nga 20 vjet atje. Ka kodoshë, oficerë policie dhe inspektorë, të cilët duhet t’i monitoroni me kujdes, sepse një shef krimesh nuk mund të rrijë 20 vjet në një vend. Studioni mirë këtë gjë dhe lëvizini një orë e më parë.

Së dyti, më pëlqeu dhe e vlerësoj merakun tënd, që baza e policisë është lufta parandaluese. Ne kemi vite që duam, edhe komisioni, edhe Kuvendi, edhe drejtuesit e Policisë së Shtetit dhe ministrat përkatës, ta kthejmë piramidën e policisë me bazë poshtë, sepse një periudhë ishte me bazë lart dhe gjykojmë, ndoshta e kam gabim, që kjo bazë ende nuk ka vajtur plotësisht poshtë. Puna parandaluese, ashtu siç e tha edhe kolegu Qefalia, nuk është vetëm detyrë e Policisë së Shtetit, ajo është motori që e vë në nxitje dhe në lëvizje, por është detyrë e të gjithë shoqërisë dhe personi kyç që duhet të lëvizë dhe të monitorojë është inspektori i policisë. Ju jeni oficer policie i vjetër, nguliteni mirë, e di që nuk është nevoja t’jua them unë, sepse është alfa, por inspektori i policisë është baza e punës parandaluese dhe jo këta inspektorët që vazhdojmë t’i kemi nëpër zyra. Unë kam pasur rastin edhe t’i njoh nga afër dhe mund të them shumë fjalë të mira për një kategori, por inspektorë që përleshën, pësojnë aksidente me kriminelët dhe shkojnë nëpër gjyqe e u falin dënimet për çfarë duhen?!

Ju uroj suksese dhe këtë materialin shikojeni, është material shumë realist, por ju ngarkon rëndë me përgjegjësi.

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Braho!

Besoj se e gjithë fjala juaj ishte shumë konstruktive, edhe shpreh punën e këtij komisioni, edhe për punën e drejtuesve më të lartë të Policisë së Shtetit. Është e vërtetë ajo pjesa ka të bëjë me parandalimin dhe bashkimin e shumë aktorëve në këtë luftë. Ndërkohë që ju po flisnit, unë u kujtova për një çështje që ne jemi munduar ta monitorojmë, deri diku, atë të oficerëve të sigurisë nëpër shkolla. Nga fjala e drejtorit vura re që ka një numër jo të vogël të miturish të përfshirë në krime. Ndonëse ne i kategorizojmë si vepra penale, që nuk kanë një rrezikshmëri të lartë shoqërore, por gjithsesi kriminaliteti nis në ato nivele e për t'u rritur e për t'u perfeksionuar në nivele të tjera. Pavarësisht se është bërë vendimi për vendosjen e oficerëve në shkolla, bashkëpunim i Ministrisë së Brendshme me Ministrinë e Arsimit, nga konstatimi që unë kam vetë në terren, por besoj se edhe kolegët e kanë në terrenet e tyre ku punojnë, nuk mendoj se Policia e Shtetit ka pasur aq shumë mundësi sa të vendosë për këto profile njerëzish. Do të doja që Policia e Shtetit të ishte e përfshirë më shumë dhe fjalën e fundit ta kishte Policia e Shteti për këta njerëz, sepse supozohet të jenë bashkëpunëtorët kryesorë, të cilët duhet të identifikojnë konfliktet në shkolla, tendencat që kanë fëmijët 16-17-18 vjeçarë në shkolla për t'u lidhur me krimin dhe për t'u bërë autorë të krimit, por njerëzit që janë vendosur shpeshherë nuk besoj se i plotësojnë këto pritshmëri. Ndoshta kjo është një nga ato iniciativa ligjore që i kemi përshëndetur kur janë marrë, por vlen t'ju ballafaqojmë ju, Ministrinë e Arsimit dhe të dhënat për kriminalitetin e të miturve në çdo rreth për të kuptuar se sa e efektshme ka qenë kjo masë në realitet. Në qoftë se nuk gaboju, janë 81 shkolla në rang republike, ku janë vendosur oficerë sigurie .

Zonja Gjebrea fjala për ju.

Elona Gjebrea- Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Drejtor, të nderuar drejtues të lartë të policisë, ju faleminderit që keni ardhur sot në këtë dëgjese me komisionin tonë!

E vlerësoj shumë dhe mendoj se është në të mirën tonë që të njohim punën, por të kemi edhe ne mundësinë të shprehim sugjerimet apo problematikat që hasim, qoftë nga dëgjesat që kemi bërë në komisariatet e policisë, por edhe nga puna jonë e përditshme. Duke qenë se kam punuar në Ministrinë e Brendshme e di më në detaje të gjithë punën e policisë dhe problematikat

që kanë, do të doja solidarizim për punën e policisë dhe të gjithë punonjësve, të cilët punojnë në kushte të vështira dhe në luftë me krimin dhe informalitetin, që nuk është i pakët në Shqipëri.

E dëgjova me vëmendjeje raportimin tuaj dhe kam disa sugjerime, të cilat kanë lidhje me të gjitha vizitat që kemi bërë në drejtoritë.

Pjesa e mungesës organike në disa struktura është diçka që vihet re. Në fakt, ju përmendet shifrat 1 polic për disa banorë, ndërkohë që unë kam disa shifra të tjera që në qoftë se ne i shikojmë për 100 000 banorë ne dalim mbi mesataren e vendeve të BE-së. Shqipëria ka 392 policë për 100 000 banorë, ndërkohë që Gjermania ka 297, Franca 326 dhe mesatarja është 318. Gjithsesi, për sa kohë ne nuk kemi një modernizim dhe përmirësim të teknologjisë, edhe puna e policisë është më e domosdoshme. Ajo që vëmë re është që nuk kemi salla operative siç duhet të ishin në të gjitha qytetet dhe uroj që të jetë e reflektuar në buxhetin që do të vijë nga Ministria e Brendshme dhe ta diskutojmë sot. Sigurisht që do t'ju inkurajoj të keni mundësi që të keni bashkëpunim me donatorë të huaj në rastet kur nuk ka mundësi që buxhetit i shtetit t'i përballojë këto, pasi modernizimi i policisë sigurisht që ndihmon edhe në parandalim, edhe në të gjithë uljen e krimeve. Sigurisht që kjo nuk është e vetmja, por pa dyshim që është shumë e rëndësishme, sepse shumë qytete kryesore duhet t'i kenë sallat moderne operative.

Kam një sugjerim që ka të bëjë me aksidentet rrugore. Ndoshta duhet të ngrihet një task-forcë për problemin e sinjalistikës, mungesës së informimit të shoferëve dhe problematikat me përdorimin e automjeteve nga mosha të reja e pa autorizim, prandaj kërkojnë të kemi një mobilizim kombëtar dhe të mos jetë vetëm Ministria e Brendshme përgjegjëse, sepse nuk është vetëm ajo, ka edhe ministri të tjera, dhe të ketë një task-forcë kombëtare lidhur me këtë. Ndoshta kjo është bërë, prandaj kërkoj ndjesë nëse nuk e kam këtë informacion!

Kam një sugjerim për sa i përket policimit në komunitet. Në disa raste bëhet një koncept i dukshëm dhe në disa raste një koncept abstrakt. Unë e di që është bërë shumë punë dhe ndoshta ka nevojë për një ndërgjegjësim, por ndoshta duhet një qasje më ndryshe dhe bashkëkohore. Është e rëndësishme dhe është parë edhe në praktikën e vendeve të tjera që policimi në komunitet ka shumë efekt dhe në Shqipëri është mbështetur policia, po ashtu ka dhënë mbështetjen e vet, por mendoj se duhet një qasje pak më bashkëkohore në lidhje me këtë.

Ju përmendet pjesën e dhunës në familje. Unë kam ndjeshmëri nga puna e mëparshme që kam bërë për trafikimin e qenieve njerëzore. Nuk e shikoj të përmendet numri 116-006, që është prezantuar dhe kemi pasur projekt të madh në lidhje me këtë, por shpresoj të jetë ende

funksional. Ky numër ka qenë në sallën operative të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe sigurisht koordinatori kombëtar kundër trafikimit ka punën më të madhe për të krijuar një ndërgjegjësim kombëtar për këtë, por mendoj se produktet që janë bërë dhe që kanë pasur edhe një kosto është mirë të mbahen dhe të ruhen.

Ju përmendet që Shqipëria tashmë është një vend origjine jo vetëm tranzit për emigrantët e pashoqëruar, në qoftë se e kuptova drejt, pra përveç tranzit, kemi kaluar edhe vend origjine dhe, ndoshta ka ardhur koha që për Qendrën Kombëtare Pritëse të kemi një transferim apo një miniqendër pritëse në kufi, sepse është kosto edhe për ju me mjete, naftë e të tjerë për t'i çuar në një qendër pritëse dhe më pas për t'i kthyer në vendin nga kanë ardhur. Mendoj se kjo ka nevojë për një adresim, sepse për sa kohë ne kemi përsëri sfidë emigrantët e pashoqëruar dhe punën me refugjatët. Për shkak të konflikteve të ndryshme ndërmjet shteteve, gjithmonë ka valë dhe bëhet si një valvul shkaktare dhe pa dyshim Shqipëria është akoma një vend pritës në lidhje me këtë.

Unë ju falënderoj për të gjithë punën e mirë që keni bërë dhe pa dyshim që do të keni mbështetjen e vazhdueshme të Komisionit të Sigurisë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea për të diskutimin tuaj!

Fjalën e ka zoti Xhindi dhe më pas zoti Harusha dhe zonja Duka.

Anduel Xhindi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti drejtor për të gjithë paraqitjen e punës së Policisë së Shtetit që paraqitët këtu në komision!

Unë doja të bëja disa pyetje.

Së pari, shohim një rritje të aksidenteve automobilistike kohët e fundit nga drejtues të moshave të reja. Sa masa administrative me pezullim të lejeve të drejtimit ka për këto mosha?

Se dyti, ka funksionuar Komiteti Ndërminstor për Sigurinë Rrugore, por pjesë e këtij komiteti është edhe Ministria e Brendshme. Vrasjet me pagesë kohët e fundit janë bërë një fenomen i shtuar, i rrezikshëm dhe kriminal. Çfarë planesh operationale ka marrë Policia e Shtetit për të zbuluar këto vrasje?

Së fundi, çfarë masash janë marrë për parandalimin e vrasjeve në njësitë vendore? Sa nga ngjarjet e vjetra kriminale janë zbuluar dhe çfarë po bëhet për zbulimin e ngjarjeve të tjera?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Xhindi!

Me mirëkuptimin tuaj, a mund t'ia jap fjalën zotit Harusha, se pyetja e tij lidhet me aksidentet rrugore, që ishte dhe një nga pyetjet tuaja, me qëllim që të kemi një përgjigje të plotë?

Po, urdhëroni!

Luan Harusha – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, drejtor!

Të nderuar pjesëmarrës,

Unë kam një pyetje, se shoh një shifër të aksidenteve rrugore, 4716 raste. A ka ndonjë tabelë për këto raste, ndonjë identifikim? Çfarë masash merren në disa pika, rrethrotullime në Tiranë, për shembull, te rrethrotullimi te Shqiponja, ose te TEG-u, ku është një katrohurë trafiku?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Edhe unë i bashkohem kësaj pyetjeje për shkeljen e qarkullimit rrugor dhe drejtimin në mënyrë të parregullt, pa dëshmi, ose në gjendje të dehur, sepse realisht vihet re që ka një rritje të këtyre rasteve. Ndoshta më përpara policia ka qenë më e fokusuar dhe e kemi ndjerë edhe vetë problemin e parkimeve në vende ku nuk lejohet, mosmbajtja e rripit të sigurimit, apo mospërdorimi i celularëve. Ka disa segmente që janë problematikë, ndoshta jo por këtë vepër, por për vepra të tjera. Edhe media e ka vënë në dukje rrethrotullimin e TEG-ut si një vend problematik. Në orët e vona të darkës, nëse të ndodh të kthehesh nga Elbasani për në Tiranë, ti sheh aty makina të tëra të ndaluara dhe me gjasë aty përdoren lëndë narkotike, përderisa shihen grupime të rinjsh. Nuk e di a ka qenë kjo gjë në vëmendjen te Policisë së Shtetit? A është marrë ndonjë masë? Nëse nuk është marrë, mendojmë se duhet të ndërhyhet në atë segment, nuk mundet që një segment i tërë rrugor, që është në vëmendje të të gjithëve, se ka fluks të shtuar si rrugë, të ketë këtë lloj ndodhish.

Fjala për ju.

Ardi Veliu – Faleminderit, të gjithëve!

Do të mundohen t'u jap përgjigje të gjitha pyetjeve që u bënë nga zoti Braho e me radhë.

Së pari, dua t'ju falënderoj, si Komisioni i Sigurisë në lidhje me angazhimin që keni marrë për të monitoruar punën e Policisë së Shtetit dhe jo vetëm Drejtorinë e Përgjithshme, por duke prekur edhe drejtoritë vendore, drejtoritë e kufirit, repartet speciale, apo të ndërhyrjes së shpejtë, stacionet e policisë kufitare e me radhë. Sinqerisht e vlerësojmë si një ndihmë të çmuar që na jepni si komision, për rritjen e performancës së strukturës sonë policore. Pa dyshim që në

punën tonë të përditshme jo gjithçka shkon në mënyrën më të mirë të mundshme, absolutisht ka edhe problematika, që vijnë si rezultat i gabimeve apo i problematikave në funksionimin e organizatës, por edhe disa çështje të tjera. Vërtetë pika fundore është Policia e Shtetit, por jo gjithçka është në dorën e saj.

Materiali që na keni dërguar, bashkë me konstatimet dhe gjetjet, ju siguroj se do të kalojnë në një analizë të veçantë dhe do të mundohemi ta kthejmë në një program pune, për të zgjidhur të gjitha ato problematika që janë konstatuar nga ju, si dhe duke propozuar zgjidhje për ato problematika në struktura dhe institucionet e tjera, që nuk janë atribut i Policisë së Shtetit.

Në lidhje me gjendjen e rendit dhe të sigurisë në Durrës, për sa i përket aktivizimit, pjesës së performancës së policisë, apo strukturës vendore të policisë së Durrësit, ne kemi kryer disa ndryshime në drejtimin e Drejtorisë Vendore të Durrësit. Këto ndryshime kanë filluar që muajin e kaluar dhe sot janë në proces. Sot unë kam ndryshuar zëvendës drejtorin e hetimit, do të ketë edhe ndryshime të tjera në punonjës dhe drejtues, por kjo kërkon kohë, sepse çdo lëvizje duhet të bëhet mbi bazën e një analize dhe të një performancë, se unë nuk mund të bëj lëvizje thjesht për të bërë lëvizje.

Gjithsesi ne do ta kemi në konsideratë shqetësimin e deputetit për të gjitha problematikat që u trajtuan, duke filluar që nga specialisti i Policisë së Rendit, inspektori i krimeve dhe i gjithë zinxhiri komandues.

Në lidhje me çështjen e piramidës të strukturës policore, ju garantoj se baza e piramidës janë komisarati, stacionet e policisë, janë drejtoritë vendore të policisë dhe Drejtoria e Përgjithshme monitoron, menaxhon dhe drejton të gjitha veprimet hetimore dhe gjithçka që po kryet nga Drejtoria Hetimore Qendrore dhe nga drejtoritë vendore të policisë.

Në lidhje me pjesën e organikës, që u trajtua nga deputetja Gjebrea, është e vërtetë që, nga konstatimi që keni bërë, ka një vakum të disa funksioneve, që janë funksione bosh, por kjo ka ardhur për faktin se, siç jeni në dijeni, Akademia e Sigurisë nuk ka funksionuar dhe nga viti 2007 deri në vitin 2014 është marrë me trajnimin dhe formimin e punonjësve të policisë, të rolit zbatues, ose të vijës së parë dhe dashje pa dashje kjo solli një vakum shumë të madh për sa i përket pjesës së promovimit të gradave dhe të një mungese të theksuar të nivelit të nënkomisarëve.

Unë nuk kam pse ta fsheh që sot kemi një vakum, pra funksione bosh, të rolit të nënkomisarit. Janë 158 nënkomisarë mangut, që do ta konsideroja motori i organizatës së policisë, pastaj kjo vazhdon edhe në funksione të tjera.

Aktualisht në Akademinë e Sigurisë janë 900 persona që po shkollohen dhe po trajnohen, nga këta 630 po vazhdojnë shkollën bazë të policisë në dy grupe. Një grup është i përbërë nga 500 vetë dhe filloi para 4 javësh, kurse grupi i dytë ka 112 dhe mbaron trajnimin teorik dhe praktik në muajin shkurt dhe do të gradohet edhe me gradën e inspektorit. Krahas kësaj, janë duke funksionuar me kapacitet të plotë të tria klasat e vitit të parë, të dytë dhe të tretë, punonjës policie në statusin e studentit, të cilët, pas një karriere të suksesshme dhe pas disa proceseve shumë korrekte për ngritjen në gradë, arritën të fitonin të drejtën për t'u promovuar. Aktualisht në Akademinë e Sigurisë janë dhe 140 punonjës policie, që po marrin trajnim në lidhje me gradën nënkomisar. Kështu që Akademia është në funksion të plotë, këto janë kapacitetet, ne kemi komanduar edhe punonjës policie, të cilët janë trajnuar dhe kanë të gjithë eksperiencën e nevojshme për të kryer rolin e trajnerit në Akademinë e Sigurisë për të lehtësuar këtë situatë jashtëzakonisht të ngarkuar.

Ju siguroj se mesatarja e punonjësve të Policisë së Shtetit, në krahasim me cilindo vend të rajonit, është jashtëzakonisht e ulët. Ne kemi diku të 400 punonjës policie të Departamentit të Kufirit, që kryejnë shërbim në kufirin me Greqinë, kur pala greke ka 4-fishin e punonjësve tanë të angazhuar në kufirin shqiptaro-grek. Tani llogarinë bëjeni vetë! Janë shtuar 16 vendkalime të reja, që janë hapur dhe nuk janë shoqëruar me shtesë organike.

Doja ta lija pjesën e aksidenteve, duke qenë se u përmend nga tre deputetë, me qëllim që të jepja një përgjigje më të plotë, prandaj dua të merrem me pyetjen që bëri zonja Gjebrea për vendin transit. Po, është e vërtetë, e përmenda edhe në raport, që kemi një rritje të numrit të veprave penale, që janë konstatuar gjatë këtij 10-mujori për kalim të paligjshëm të kufirit. Ju jeni në dijeni që bashkë me skuadrat e Frontex-it, të cilat janë të atashuara prej muajit qershor në kufirin shqiptaro-grek, jemi duke punuar shumë mirë, duke përdorur teknologjinë që na kanë ofruar, por gjithsesi numri i shtetasve, që vijnë nga zonat e konfliktit apo nga Lindja e Mesme është jashtëzakonisht i shtuar dhe ne, në bashkëpunim me IOM-in, por edhe me Ministrinë e Brendshme, kemi ngritur dy pika pritje në Kakavijë dhe në Kapshticë, që merren me intervistimin dhe akomodimin e gjithë këtij kontingjenti, i cili kapet nga patrullat tona, ku një pjesë e mirë riatdhesohen në vendin e origjinës, kurse pjesa e tjetër kërkon azil dhe plotëson

formularët. Në raste të tilla ne jemi të detyruar të respektojmë protokollet e konventave ndërkombëtare.

Po e filloj me pyetjen e zotit Xhindi në lidhje me vrasjet me pagesë.

Po, në disa raste kontaktojmë që vrasjet bëhen nga autorë me pagesë, ne kemi disa hetime në dorë, hetime që po avancojnë, por për efekt të sekretit hetimor nuk mund të jap më shumë detaje. Në lidhje me ngjarjet e vjetra të zbuluara nga Policia e Shtetit në fokusin e punës tonë të përditshme nuk është vetëm dinamika ditës, por edhe analiza në lidhje me ngjarjet e vjetra dhe ne, gjatë këtij 10-mujori kemi arritur të zbulojmë 3 ngjarje të vjetra, pra tri vrasje të dokumentuara dhe personat janë arrestuar. Po kështu kemi në dorë edhe 5 ngjarje të tjera dhe shpresojmë e besojmë në analizën e provave që kemi gjetur dhe do të bëhet shumë shpejt zbardhja e tyre. Për sa u përket numrit të shtuar të aksidenteve, unë e thashë edhe në raport, ne kemi 4170 ngjarje rrugore, se duhet të kemi të qartë konceptin e ngjarjes rrugore. Ngjarja rrugore vjen si rezultat i përplasjes ndërmjet dy mjeteve ose një mjeti dhe një këmbësori. Pa dyshim që në këtë rast kemi të lënduar, të plagosur, apo humbje jetësh. Në të gjitha këto janë kryer veprime procedurale dhe numri i shtuar i ngjarjeve ka të bëjë me nivelin shumë të ulët të edukimit të përdoruesve të rrugës. Në respekt të Kodit Rrugor, përdorues rruge nuk është vetëm drejtuesi i mjetit, por çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë, i cili përdor një rrugë dhe përgjegjësia në respekt të Kodit është e përbashkët dhe nuk do të thotë që drejtuesi i automjetit ka më shumë ose më pak përgjegjësi se personi tjetër, këmbësori, në rastin konkret, i përfshirë në aksident.

Perceptimi është që numri i aksidenteve është në rritje, jo numri i aksidenteve të total është në ulje, ne kemi një rritje të numrit të aksidenteve me pasojë fatale dhe nëse do të analizojmë shkaqet dhe arsyet pse është kjo situatë, atëherë ju garantoj që numri më i madh i aksidenteve me pasoja fatale është në rrugët dytësore. Falë programeve të qeverisë shqiptare është bërë e mundur lidhja e akseve kryesore rrugore me rrugët dytësore, qendrat administrative të fshatrave, ku në shumë raste ka mjaftuar vetëm rritja e cilësisë, apo standardit të rrugës, por nuk është shoqëruar me sinjalistikën tjetër të nevojshme. Në zonat rurale, edukata rrugore për sa i përket përdorimit dhe njohjes së Kodit Rrugor është shumë e limituar, sepse në shumë raste kemi përfshirje të mjeteve me motor. Në shumë raste motoçiklistët lëvizin pa kasketë dhe pa lejë drejtimi.

Numri i punonjësve të Policisë së Shtetit, pavarësisht organizimit që kemi bërë, që e kemi mbledhur në nivel qarku, për të rritur fleksibilitetin e këtij shërbimi dhe për ta larguar nga rruga,

ku çdo përdorues rruge, kur niset nga Tropoja, apo nga Saranda, të mos e dijë se ku është punonjësi i policisë dhe të reagojë në momentin kur afrohet tek ajo pikë, por duke rritur befasinë për të qenë gjithmonë në korent dhe për të mbuluar të gjitha akset. Ia kemi dalë apo jo, kjo është çështje për t'u gjykuar, por ju garantoj në numrin e masave administrative që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me punën e policisë. Nëse do të ndalemi vetëm në fenomenet si, pija alkoolike, gjatë këtij 10-mujori u është pezulluar leja e drejtimit 2276 drejtuesve automjesh, 5696 raste të ndëshkuara për shpejtësi tej normave të lejuara. Nëse i referohemi shkakut në disa raste të analizës së aksidenteve, kjo vjen sepse drejtuesi i automjetit humbet përqendrimin kur përdor telefonin teksa nget automjetin. Ne kemi kërkuar, por do të kërkojmë sërish mbështetjen tuaj që sanksionet ndaj drejtuesve të mjeteve, që përdorin telefonin të unifikohen me vendosjen e rripit. Ju e keni parë që niveli i aplikimit dhe i zbatimit të vendosjes së rripit janë në rënie, nëse analizojmë shkaqet e aksidenteve rrugore, për shkak se në 99% të rasteve drejtuesit e automjeteve e vendosin rripin e sigurimit. Në shumë raste, kur jemi ballafaquar me aksidentet me pasoje fatale, drejtuesi i automjetit, pavarësisht se ka humbur jetën, ka qenë me rripin e sigurimit të vënë, pra e kishte respektuar këtë dispozitë.

Për sa i përket fenomenit të TEG-ut, është kthyer në një temë debati. Është e vërtetë që disa drejtues automjesh luksi në moshë të re e përdorin këtë segment si një pistë për të matur shpejtësinë. Ju garantoj se çdo ditë e çdo natë në atë segment ka shërbim të Policisë Rrugore, i cili ndëshkon dhe jam i gatshëm që sa dal nga komisioni t'ju sjell një pasqyrë për masat dhe pezullimet e lejeve së drejtimit që kemi marrë. Nëse do t'ju nevojitet.

Po të analizojmë vetëm rrethrotullimin, ai që në projekt është konceptuar gabim, por nuk bashkohem me vlerësimin e disa specialistëve, apo pseudoekspertë të Policisë Rrugore, të cilët nuk kanë informacionin e nevojshëm kur analizojnë rastin. Në 9 raste me pasoje vdekjeje në rrethrotullimin e TEG-ut është vetëm një rast që ka drejtimin nga Sauku në TEG, të gjitha rastet e tjera janë me drejtim nga Mulleti në TEG. Kjo vjen për faktin se shumë qytetarë, duke ecur për një kohë të gjatë në atë segment, fillojnë të përgjumen, se këto aksidente ndodhin pas orës 10, ose pas orës 12 të natës. Në momentet e para kur u hap rrethrotullimi ishte i pakompletuar me sinjalistikën e nevojshme. U desh të ndodhnin 4 aksidente me pasoja fatale, me 7 jetë të humbura, dhe pavarësisht se kishim dërguar disa herë kërkesa në mënyrë të përsëritur te Autoriteti Rrugor Shqiptar për të plotësuar rrugën me të gjithë sinjalistikën e duhur horizontale

dhe vertikale, ne sot përsëri propozojmë që ai rrethrotullim të ketë një ridizenjim tjetër për t'i dhënë rrugës lirshmëri. Zgjidhja aktuale nuk është e duhura, por kjo i përket një faze tjetër.

Nuk e di a arrita t'u përgjigjesha të gjitha pyetjeve. Mbase ka ngelur ndonjë!

Ermonela Felaj – Jo faleminderit! Besoj se ishit shterues, sepse normalisht problematika është shumë e gjerë, por do të donim të respektonim kohën e secilit në dispozicion. Sigurisht që ai është një rreth problematik dhe më vjen mirë që ju keni reaguar duke iu drejtuar Autoritetit Rrugor.

Ardi Veliu – Më falni, zonja kryetare, se shpeshherë kam dëgjuar të përmenden fëmijë deputetësh, por nëse shohim *database*-in e Policisë Rrugore, një pjese të mirë të anëtarëve të nderuar të këtij parlamenti iu është pezulluar leja e drejtimit për shpejtësi tej normave të lejuara. Këtë jua garantoj dhe dua të them që policia është në krye të detyrës. Pra, kemi deputetë, të cilët shpërdoruan lejet e ndërtimit, kemi anëtarë të familjeve të deputetëve po ashtu, nuk kemi parë nga vjen dhe kush është drejtuesi i automjetit, i cili ka konsumuar këtë shkelje.

Ermonela Felaj - E kemi marrë ne mësimin për këtë pjesë që në vitin e parë 2013-ën, kështu që nuk duhet të ketë shkelje dhe puna nuk duhet të jetë me aksion. Puna duhet vijuar, niveli i intensifikimit që keni pasur duhet të ruhet. Ka edhe rrethrotullime të tjera që janë problematike sa i përket sinjalistikës, nuk po them se është direkt puna juaj, por reagimi juaj ndihmon, për shembull, rrethrotullimi te Filologjiku është problematik, vijat e bardha aty nuk funksionojnë, duhet t'i bësh me shenjë drejtuesve të mjeteve, e madje a të shikojnë apo jo, gjithashtu në bulevardin qendror ndizet semafori jeshil kalon kalimtarët.

Ardi Veliu - Unë doja të thosha edhe pak më parë që niveli kulturor i përdoruesve të rrugës nuk është absolutisht në standardit që shoqëria është duke kërkuar. Në momentin që kemi vija të bardha, çdo kush që ka marrë një leje drejtimi presupozohet se i di rregullat.

Ermonela Felaj - Po nuk është një gjë që është përmbushur por nga ana tjetër edhe sinjalistika ka problemin e saj. Rasti që po trajtohet nuk ka të bëjë me përdoruesin e rrugës, sepse përdoruesit e rrugës futen në rrugë sapo që ndizet drita jeshile.

Burrë- Sinjalistika rrugore është debat i Rrugës, nuk është I Policisë së Shtetit.

Ermonela Felaj – Nuk e kisha debat me ju këtë pjesë, por e kisha si mbështetje që në momentin që ju reagoni, ne reagojmë, ndaj Autoritetit Rrugor, jo për një pikë, por për të gjitha pikat që janë problematike, që ne i konstatojmë se jemi përdorues, jemi drejtues mjeteve, dhe natyrisht që nuk na vjen mirë që këto të funksionojnë si të tilla, sepse e kuptojmë që edhe ato

bëhen shkak, ndoshta nuk janë shkak parësor i aksidenteve, por që janë një shkak patjetër që janë. Unë e vlerësoj që ju e përmendët që ai rrethrotullim ka pasur problematikë që në projekt, ka pasur problematikë në vendosjen e sinjalistikës dhe ju keni reaguar, të njëjtën gjë ju nxisim ta bëni me çdo lloj rrugë kalimi tjetër.

Zonja Duka dhe zonja Dralo për ta përmbyllur si dëgjuesë.

Faleminderit!

Elena Xhina – Unë përfitoj nga rasti për të bërë një pyetje që lidhet me një projektligj që ka ardhur në Komisionin e Sigurisë. Ky projektligj sjell disa ndryshime në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale. Te ky projektligj krahas disa detyrave shtesë që ka në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale mendoj që t'i shtohen edhe disa detyra të tjera që kanë të bëjnë me humbjen e përgjegjësisë prindërore, me kontestimin e mjeteve të sekuestruara nga kryerja e veprës penale, ose nga produktet e veprës penale. Unë do të doja të dija nëse është tërhequr mendimi juaj lidhur me këtë projektligj? Ju parashtruat faktin që keni shumë detyra të ngarkuara dhe pak forca policie. A mendoni që mund t'i kryeni këto detyra në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale, krahas atyre që keni?

Pyetja tjetër: ju na parashtruat faktin që shumë punonjës të policisë nga ana juaj për shkak të kontrollit që ushtrohet për shkak të punës së tyre, janë me masa disiplinore. Nga ana tjetër nga një diskutim që unë kam pasur me disa prokurorë është konstatuar një shqetësim se shumë referime që vijnë nga policia nuk janë fare vepra penale. Pra çdo ngjarje që ndodh pavarësisht ka ose nuk ka elemente të veprës penale referohet në prokurori. Kjo sjell një ngarkesë fiktive. Po të vëmë re statistikën që sjell prokuroria më shumë janë vendime pushimi të çështjes ose mosfillimi. A e keni konstatuar ju një gjë të tillë?

Unë jam deputete e qarkut të Elbasanit, i cili njihet për problematikat që ai mbart dhe nga vizita që ne bëjmë me komisionin në Drejtorinë e Policisë së Elbasanit një nga shqetësimet që na u ngritën është edhe mungesa e mjeteve, të cilat shumë edhe nuk punojnë, apo edhe mungesa e radiove. Unë desha të di a ka ndonjë vëmendje të shtuar për ju për qarkun e Elbasanit? A është në vëmendjen tuaj që duke siguruar më shumë mjete më shumë e trupa policore, sepse janë shumë pak, që parandalimi të ketë më shumë efektivitet dhe të ketë më siguri të këtyre banorëve?

Ermonela Felaj– Faleminderit!

Zonja Duka dua të bëj një ndërhyrje të vogël për të lehtësuar përgjigjen.

Pyetja e parë ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve penale, dhe pyetja tjetër ka të bëjë me nëse jeni konsultuar ju me këtë projekt. Kjo merre shkas nga një diskutim që u bë pak më parë nga deputeti Qefalija, që tha se në gjykimin tim policia duhet të qëndrojë në fokusin e saj të punës, ndërtimet pa leje, e të tjera që ndjek Policia e Shtetit, por që duket si një punë ekstra, në fakt. Kështu që me kohë policinë duhet ta çlirojmë nga kjo dhe ta sjellim në brazdën normale të punës së vet. Ligji i ekzekutimeve të vendimeve penale ju ngarkon prapë disa përgjegjësi që nuk i keni pasur. Fjala vjen heqja e përgjegjësisë prindërore është përgjegjësi për përmbarimin, sekuestrimi i aseteve kriminale dhe konfiskimi i tyre duhet të bëhet nga agjencia e re që u ngrit. Për këtë ishte pyetja e parë e zonës Duka.

Pyetja tjetër është e qartë ne e kemi parë drejtorinë e policisë të qarkut Elbasan është një nga ato drejtori që në gjykimin tonë absolutisht që duhet të rikonstruktohet. Në vendin ku është vendosur në mënyrën si është projektuar është e papranueshme për një qark me dendësi me probleme të kriminalitetit. Pra shpresojmë se do të kemi një fjalë të mirë për këtë, por në mbledhjen tjetër me ministrin për buxhetin.

(Ndërprerje incizimi.)

Artemis Dralo - Faleminderit!

Me gjithë problematikat që u dëgjuan ajo që unë dua të ngre është nga problematikat e konstatuara nga vizitat që janë kryer në drejtoritë e policisë në vend. Duke marrë shkas nga vendi që unë mbuloj Gjirokastra, problemi që unë dua të ngre është i drejtpërdrejtë, nuk ka të bëjë me vështirësitë financiare, as me kontribute ose mbështetje, e kam ezauruar ehë drejtorinë vendore dhe sot e ngre edhe këtu. Problemi është evident në shumë drejtori të vogla pro aq më shumë në Gjirokastrë, i cili si qytet është i qetë dhe nuk ka problematika, por në përdorimin e lëndëve narkotike besoj se si qytet duhet të ketë vëmendje më të lartë nga ana e policisë. Ajo që unë do të ngre mund të zgjidhet lehtësisht, por që ka rrezik shumë të madh dhe që rishtasi ka sjellë problematika në atë qark dhe është përdorimi i lëndëve narkotike në orët e vona në ato pak lokale që ky qytet ka. Është në masë, është i dukshëm dhe nuk e di pse ka mungesë vigjilence nga ana e policisë dhe nuk e di pse nuk është konstatuar dhe zgjidhur me elemente të kapura, ose nën hetim. Është shumë i përhapur tashmë. Unë mendoj se kjo është drejtpërdrejtë punë e policisë dhe se mund të zgjidhet me 2-3 patrulla gjatë natës.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjala për ju zoti Veliu.

Ardi Veliu - Sa i përket materialit që keni në lidhje me ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale do t'ju lutesha të më lini kohë, sepse duhet të pyes grupin e punës në lidhje me ecurinë ose atë çfarë ne kemi dhënë mendim në lidhje me këtë ligj dhe unë jam i papërgatitur për këtë pikë. Por gjithsesi nëse do të vendoset nga ligjvënësi dhe do të gjykohet që edhe këtë detyrë duhet ta bëjë Policia e Shtetit ne do ta respektojmë vendimmarrjen.

(Ndërprerje incizimi.)

Ermonela Felaj – E kuptojmë që ju nuk jeni pyetur nga Ministria e Drejtësisë.

Vazhdojmë me pyetjen tjetër.

Ardi Veliu - Në lidhje me marrëdhëniet që ne kemi me prokurorinë unë them se marrëdhëniet me prokurorinë janë shumë të mira. Këtë e kam prekur qoftë në analizat vjetore që kam bërë në çdo drejtori vendore të policisë por edhe në rastet kur jam ftuar në analizat që ka bërë prokuroria dhe ku kemi analizuar punën e bërë për periudha të caktuara.

Në përgjithësi Policia e Shtetit referon në prokurori materiale për një vepër penale konkrete të caktuar, por ka edhe rast kur ne kemi dërguar materiale për vlerësim. Nëse ju e keni për këtë rast kur ne kemi dërguar raste për vlerësim siç është ndërtimi pa leje, mbase mund të hajë diskutime te pjesa e saj por ju siguroj që ky numër referimi është jashtëzakonisht i vogël në krahasim me numrin e madh të referimeve që Policia e Shtetit dërgon pranë institucioneve të prokurorisë. E përsëris ne kemi marrëdhënie shumë të mira me prokurorinë por vlen për të ardhmen për të pasur marrëdhënie edhe më të mira lidhur me rastet kur ne i referojmë për vlerësim.

Në lidhje me situatën e Elbasanit Policia e Shtetit në programet e saj për zhvillimin dhe rifreskimin qoftë të teknologjisë qoftë të mjeteve që ka në përdorim pothuaj ka rinovuar në pjesën më të madhe në 9 qarqe ka rinovuar mjete që janë në përdorim të policisë rrugore dhe të patrullave të përgjithshme. Në këtë program në 80% është përfshirë edhe drejtoria e policisë së Elbasanit, qoftë sa i përket patrullave të përgjithshme qoftë ai përket mjeteve të shërbimit të Policisë Rrugore. Nuk është se nuk i njohim problematikat, por ne do të bëjmë një shpërndarje të barabartë të të gjitha pjesëve të teknologjisë që kemi dhe nuk mund të trajtojmë një drejtori vendore më shumë dhe të tjerat t'i lëmë të pakompletuara, por në javën në vazhdim ne do të kemi një shpërndarje të një partie tjetër mjetesh që kanë ardhur si investim i qeverisë shqiptare dhe i delegacionit europian. Javës tjetër këto mjete do të shpërndahen dhe patjetër që do të ndikojnë në përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës së mjeteve. Po kështu në muajin janar

kemi një grupim tjetër mjetesh , furgonë të cilët do t'i marrë policia shqiptare në programin e qeverisë dhe të delegacionit europian dhe them se pas muajit janar nuk do të ketë më probleme me mjetet policisë.

Sa i përket radiove ka problematika, të cilat janë problematika të dinamikës ditore dhe i konstatojmë rast pas rasti dhe struktura përkatëse mendoj se ka dhënë zgjidhje. Sot me zhvillimet teknologjike patjetër që Policia e Shtetit ka nevojë për mbështetje sa i përket teknologjisë që duhet të marrë sa i përket komunikimit për faktin se nuk duhet të mjaftohemi me sisteme të cilat duhet të punojnë në modul radio, por duhet të kemi pajisje që të na ndihmojnë në komunikim, në transferimin e datave të videove të fotove të transmetuara në kohë reale. Të gjithë informacionin që ka sektori i analizës ose strukturat përkatëse me punonjës të policisë të cilat janë duke zhvilluar një operacion ose janë duke kryer veprime në vijën e parë. Besoj se pjesa e rakordimit me policinë dhe prokurorinë sa i përket veprave penale ne kemi implementuar sistemin e menaxhimit policor të çështjes . këtë sistem e ka ngritur edhe Prokuroria e Përgjithshme, thjesht duhet tani një rilidhje e të dy sistemeve për të avancuar dhe për të pasur data të dhëna analiza dhe tregues të saktë nga institucionet.

Në lidhje me shqetësimin e deputetes Drano, sa i përket pjesës së përdorimit të kanabisit në Gjirokastrë, nuk është se ne po e fshehim.

(Ndërprerje incizimi.)

Dhe themi se në Shqipëri nuk konsumohet kanabis apo lëndë tçë tjera narkotike, por deri sa ne kapim madje vetëm sot në Tiranë është kapur 4-,3,9 kilogram heroinë tregon se Policia e Shtetit nuk është se po vegjeton, por po punon çdo ditë. Drejtoria e Gjirokastrës para 7 ditëve 6 veta i arrestoi dhe 5 i shpalli në kërkim. Pra edhe drejtoria e Gjirokastrës nuk është e veçuar por është duke punuar. Ky fenomen ekziston, patjetër që ne kemi përgjegjësinë tonë, por unë në takimet që kam pasur me shkollat dhe rasti më i fundit ishte javën e kaluar në shkollën “Ismail Qemali” kemi kërkuar që në kurrikulat e shkollave të futen e elemente të veçanta në lidhje me informacionin me sigurinë, ku të ketë tema të veçanta jo vetëm për sigurinë rrugore, por edhe për dëmin që sjell përdorimi i duhanit i drogës dhe elemente të tjera të sigurisë që kanë të bëjnë me mënyrën si duhet të sillemi kur jemi në një situatë rreziku.

Ermonela Felaj – Falemidneirt zoti Veliu!

Besoj se një seancë e vetme nuk i ezauron dot të gjitha pyetjet dhe të gjitha nevojat por është e vlefshme edhe për të vendosur këtë lloj kontakti të vijuar midis nesh. Unë do të besoj se

në fund të këtij diskutimi është e rëndësishme që edhe me ato që ne kemi pasur rast të kontaktojmë tanimë i duhet dhënë një fokus tjetër punës me policinë kriminale. Shumë nga drejtuesit ju i keni të këtij profili që vijnë nga policia kriminale, i keni edhe në qarqet kryesore të vendit dhe ato e kanë shprehur këtë si një lloj shqetësimi që duhet adresuar dhe duhet pasur një qasje tjetër në punën me policinë kriminale, një polici e cila duhet të pajiset më mirë, të strukturohet më mirë dhe infrastruktura që i vihet asaj në dispozicion të jetë sa më e plotë. Nëse ne duam të kemi prova nga ato që asnjë gjyqtar ose prokuror nuk do të mund të manipulonte ose t'i fshinte dot thelbi i kësaj pune mbettë policia kriminale.

Ardi Veliu - Zonja deputete e gjithë Policia e Shtetit është në dispozicion të policisë kriminale.

Ermonela Felaj - Secila nga policitë është e rëndësishme, pro ajo kriminale është në një stad më lart sepse kërkon një lloj kualifikimi më të lartë sa i takon kryerjes së veprimeve që janë më intiligjente.

Problemët e aksidenteve rrugore mbeten problem. Ka një perceptim të shuar në to. Ne do t'ju nxisnim që reagimi institucional i juaji të ishte edhe më i fortë. Ju vetë e pohuat që jeni drejtuar disa herë për sinjalistikën autoritetit rrugor do të donim që në çdo rast të kishte një detajim më të mirë të të gjithë kësaj problematike dhe ne të viheshim në dijeni të kësaj që edhe ne të bënim punën tonë. Fakti që ne kemi një përgjegjësi të konkretizuar që merremi me forcat e rendit të sigurisë pra flasim për policinë dhe ushtrinë kjo nuk na ka penguar që të invokojmë dhe përgjegjësinë e institucioneve të tjera që impaktojnë punën e policisë për shkak të përgjegjësisë të tyre. Ne nuk kemi pasur asnjë problem në këtë pikë, pra i kemi thirrur ato në këtë komision.

Së fundi, nuk patëm rast të pyesnim por kjo do kohë. Ka pasur vazhdimisht një qëndrim brenda radhëve të këtij komisioni që ligji i policisë së Shtetit duhet riparë dhe diskutimi ka qenë për pikën që ndalon rikthimin në detyrë të të gjithë atyre që kanë më shumë se dy vjet të larguar nga Policia e Shtetit. Mendoj se kjo duhet të vihet në vëmendjen tuaj në kushtet kur siç e thamë ne kemi nevojë për të shtuar numrin e punonjësve të Policisë së Shtetit. Unë këtë çështje nuk e shoh thjesht që na e plotëson vetëm akademia, sepse përvoja pa diskutim që ka një rol thelbësor në punën e Policisë së Shtetit. Këtë nuk mund ta mohojmë. Nuk mund të pretendojmë që dikush që sapo doli nga bankat e shkollës bën të njëjtën punë si dikush tjetër që ka vite përvojë pune përplasje e të tjera. në momentin që ne kemi vendosur filtra me ligjin për SHÇBA-në, ne kemi futur testin e së vërtetës, të integritetit që u bëhet punonjësve që pranohen rishtas në radhët e

Policisë së Shtetit. Me vetingun që është duke vijuar në radhët e Policisë së Shtetit rrjeta mbrojtëse i kemi. Mbase duhet ndërhyrë në këtë pikë që punonjës të policisë të cilët për arsye të ndryshme ristrukturimi bëjnë më shumë se 2 vjet të larguar t'iu japim atyre një mundësi për të qenë edhe ata në këtë radhë të luftës kundër krimit, duke mos mohuar çdo lloj eksperience, çdo lloj përvojë dhe çdo lloj aftësie. Ne kemi qenë me bonsens dhe pa ndarje në këtë komision. Fakti që jemi dy krahë nuk është se na ka ndarë në këtë pikë, pra jeni diçka më të hapur dhe kemi dashur të avancojmë por në çdo rast do të na interesonte edhe opinionin tuaj, sepse ju dini rastet konkrete që nuk janë më punonjës të Policisë së Shtetit, dini nevojat konkrete dhe ndoshta do të na ndihmonit më shumë në një gjë që e kemi diskutuar si një mundësim më shumë për të propozuar ndryshim në ligjin për Policinë e Shtetit.

Unë do ta mbyll këtu fjalën time duke ju uruar suksese në punën tuaj! Nga ana jonë do të jeni të inkurajuar dhe të mbështetur!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019, ora 13:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me ministrin e Brendshëm për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Anduel Xhindi, Luan Harusha, Elona Gjebrea, Luan Duzha, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Edmond Rrushu, Edmond Stojku, Elena Xhina, Myslim Murrizi.

Mungojnë:

Arben Elezi, Alban Zeneli, Ylli Shehu, Paulin Sterkaj, Artemis Dralo, Antoneta Dhima, Nimet Musaj.

Të ftuar:

Sander Lleshaj- Ministër i Brendshëm

Juljan Hodo –Zëvendësministër i Brendshëm

Viktor Hysaj- Drejtor i Buxhetit

Gentian Opre- Drejtor i Analizës së Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Rihapim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, pasi gjatë pjesës së parë të ditës kishim dëgjesën me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe drejtues të tjerë. Fokusi ishte ai i rezultateve të luftës kundër kriminalitetit dhe të të dhënave të kësaj lufte për nëntëmuajorin e vitit 2019, dëgjesë e planifikuar më herët për t'u zhvilluar.

Ndërkohë, kemi seancën dëgjimore me Ministrin e Brendshëm për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”. Të ftuar për të prezantuar të dhënat e buxhetit të projektuar për institucionin e Ministrisë së Brendshme për vitin që vjen kemi: zotin Sandër Lleshaj, ministër i Brendshëm. Faleminderit, zoti Lleshaj!

Zotin Julian Hodo, zëvendësministër i Brendshëm. Faleminderit!

Zotin Viktor Hysaj, drejtor i Buxhetit dhe zotin Gentian Opre, i cili përfaqëson Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, që ka qenë prezent në mbledhjet e komisionit tonë gjatë gjithë këtyre ditëve.

Relatore për këtë projektbuxhet do të jetë zonja Gjebrea.

Ndërkohë, do të doja të bëja me dije se kolegëve u është shpërndarë një material i hollësishëm për të dhënat e buxhetit, që do të projektohet për vitin që vjen dhe këtë aktual. Detajet më të rëndësishme për mënyrën se si supozohet të përdoret buxheti i vitit 2020 nga ana e institucionit të Ministrisë së Brendshme, patjetër që do të na e japë ministri.

Ju faleminderit, sërish!

Fjala për ju, zoti Ministër.

Sandër LLeshaj – Mirëdita!

Të nderuar deputetë,

Zonja kryetare,

Së pari, ju falënderoj për mundësinë që na keni dhënë për të bërë këtë prezantim sot! Pamundësia ime për të ardhur dje dhe durimi juaj që më pritët, është shenjë e interesit të përbashkët që kemi për këtë çështje. Sot kam ardhur së bashku me zëvendësministrin, pikërisht për të theksuar edhe rëndësinë që i japim ne diskutimit të çështjes së buxhetit në Komisionin e Sigurisë.

Ministria e Brendshme ka 5 programe buxhetore, që janë kryesisht: Policia e Shtetit, Garda e Republikës, Planifikimi i Menaxhimit, Prefektura dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor, nga të cilat pjesën më të madhe e zënë ato programe që lidhen me sigurinë, që është Garda dhe Policia e Shtetit.

Dua t'ju them dy fjalë për buxhetin e vitit 2019 për t'u futur edhe në kontekst, për arsye se buxheti i vitit 2020 është vijueshmëri e shumë programeve të vitit 2019.

Në vitin 2019 buxheti i planifikuar ishte 20,7 miliardë, ndërkohë që me ndryshimet e bëra, gjatë vitit u rrit edhe me 1 % dhe shkoi 21 miliardë, nga i cili 20,2 miliardë ose 96% e tij ka qenë financimi i brendshëm dhe 3,9 % e këtij buxheti ka qenë financimi i huaj.

Sipas programeve, siç thashë, Policia e Shtetit ka marrë pjesën më të madhe me 80,3 % ose 16,9 miliardë; Garda e Republikës 1,5 miliardë ose 7,5% të këtij buxheti; planifikimi dhe menaxhimi 1,3 miliardë ose 6%; prefekturat dhe funksionet e deleguara kanë marrë 607 milionë ose 3.2% të buxhetit total.

Ky buxhet është realizuar në shifra të kënaqshëm, aktualisht në 91% dhe besojmë se deri në fund të vitit do të realizohet 100% duke realizuar edhe të gjitha detyrimet buxhetore që lidhen me ligjin përkatës.

Nga projektet kryesore të realizuara gjatë vitit 2019, janë përfundimi i ndërtimit të Komisarariatit Special “Renea”, i cili është një zhvillim pozitiv në fushën e rendit dhe të sigurisë publike me 123 milionë lekë. Është një projekt që ka zgjatur për një kohë të gjatë. Ndërtimi është bërë i mundur në bashkëpunim me partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë dhe Bashkimin European.

Po ashtu ka ecur mirë edhe projekti që lidhet me ndërtimin e Drejtorisë Vendore të Policisë në Shkodër, i cili ka kapur vlerën 70 % të investimit në vlerën 205 milionë lekë për vitin 2019.

Po kështu, investime të rëndësishme janë realizuar edhe në fushën e pajisjeve të policisë me mjete transporti me bashkëfinancim me strukturat e Bashkimit European dhe delegacionin european në Tiranë në vlerat 107 milionë lekë. Së shpejti do të realizojmë edhe disa evente publike për prezantuar flotat e reja të automjeteve, të cilat i shtohen Policisë së Shtetit, një numër i konsiderueshëm, i cili do t'i japë një fizionomi, pamje të re dhe kapacitet të ri operacional të gjithë Policisë së Shtetit.

Gjatë vitit 2019 ka filluar puna për projektimin e korpusit të ri të Policisë së Shtetit, korpus i cili është planifikuar të nisë nga ndërtimi gjatë vitit 2020 e më tej, për arsye se e dimë që sot është në mjediset e një ish-hoteli të dikurshëm. Ndërkohë, pjesë e këtij korpusi do të jetë edhe Akademia e Sigurisë, pra në mjediset e sotme të Akademisë të do të vendoset edhe korpusi i ri i Policisë së Shtetit, institucione të tjera të saj si Instituti i Policisë Shkencore e të tjerë. Sivjet mbyllet projekti dhe në bashkëpunim me partnerët dhe studiot prestigjioze ndërkombëtare. Siç ju thashë, në vitin 2020 planifikohet fillimi i ndërtimeve në terren për këtë investim shumë të rëndësishëm.

Ndërkohë, në vitin 2019 është realizuar një pjesë e mirë e investimeve që kanë të bëjnë me ndërtimin e Bllokut të Sigurisë dhe rikonstruksionin e dhomave të shoqërimit në Drejtorinë Vendore të Policisë së Tiranës në vlerën 102 milionë lekë.

Po ashtu janë bërë investime të rëndësishme sa u përket pajisjeve me armatim prej 100 milionë lekësh, 151 milionë lekë janë pajisje për Policinë e Rendit, 26 milionë lekë janë për Policinë Kufitare.

Dua të them që viti 2019 në përgjithësi ka shënuar investime të rëndësishme në fushën e policisë, por jo vetëm. Unë sot do të fokusohem më shumë tek ato që kanë lidhje me sigurinë, që është edhe objekt i punës së këtij komisioni.

Po kaloj te projektbuxheti i vitit 2020, i cili tashmë është miratuar në qeveri. Objektivat kryesorë të këtij projektbuxheti në fushën e Ministrisë së Brendshme lidhen së pari me Policinë e Shtetit, ku si objektiv kryesor kemi rritjen e efektivitetit të punës së Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar. Në funksion të këtij objektiv të madh qeveria ka planifikuar të ecë në dy shina paralele, e para, në mbështetjen buxhetore të këtij prioriteti të madh kombëtar, që është lufta kundër krimit të organizuar, dhe e dyta, në mbështetjen e policisë me kompetenca të reja ligjore, të cilat do të jenë edhe objekt i diskutimeve të mëtejshme në këtë komision, sapo të miratohen në qeveri. Tashmë është bërë publike iniciativa për të shtuar kompetencat e policisë dhe për të rritur efektivitetin e punës së saj në luftën kundër krimit të organizuar.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm, i cili mbështetet me buxhet në fushën e policisë ka të bëjë me kontrollin e flukseve migratore, migracionit të parregullt, i cili vijon të zhvillohet në kufirin tonë jugor, rezultati i paqëndrueshmërisë politike në rajone të caktuara të Lindjes së Mesme e më gjerë dhe vendi vazhdon të ndeshet ende me rritje të flukseve migratore. Kontrolli i këtyre flukseve është prioritet i rëndësishëm jo vetëm i vendit tonë, por edhe i partnerëve tanë

dhe i Bashkimit European. Në këtë kuadër edhe buxheti parashikon mbështetje për Policinë Kufitare, në mënyrë që të plotësojë ato objektiva apo të minimizojë risqet për sigurinë e vendit që vijnë në këtë drejtim.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i projektbuxhetit në fushën e policisë është edhe forcimi i kapaciteteve të Policisë Shkencore, nënkuptoj këtu Laboratorin e Policisë Shkencore i cili do të fillojë rindërtimin gjatë vitit 2020 për të arritur ato parametra që tashmë kërkohen, për të cilat do të flas më tej.

Garda e Republikës ka marrë disa përgjegjësi të reja në kuadër të reformës në drejtësi për ruajtjen e personaliteteve të drejtësisë. Në këtë kuadër janë shtuar fondet shtesë dhe personeli i saj për të mundësuar plotësimin e kësaj detyre.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm i Ministrisë së Brendshme për aktivitetin e vitit 2020 është plotësimi i detyrimeve në kuadër të ligjit “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit të shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si dhe Gardës së Republikës”. Siç dihet, me ndryshimet e zhvilluara dhe të realizuara në ligjin përkatës për këtë vit, faza e dytë dhe e tretë e procesit të vetingut në Policinë e Shtetit do të realizohen nga SHÇBA-ja, ndërkohë që faza e parë po vijon të realizohet me sukses nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe, meqenëse SHÇBA-ja do të futet në këtë proces të vetingut, i është dhënë edhe mbështetje buxhetore në projektin e buxhetit të vitit 2020, e kam fjalën për mbështetjen shtesë buxhetore, si dhe mbështetjen shtesë me personel, që ajo të jetë në gjendje të realizojë detyrimin ligjor që i është dhënë nga ky parlament dhe respektivisht nga ky komision.

Në shifra kryesore buxheti i vitit 2020 krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2019 shënon një rritje prej 1,4 % dhe arrin në vlerën 21 miliardë lekë. 20.2 miliardë lekë janë financim i brendshëm dhe 818.8 milionë financim i huaj, ose 3.9% rritje në krahasim me 2019.

Tavani i shpenzimeve në total për vitin 2020 sipas programeve është:

- Policia e Shtetit do të ketë 17 miliardë lekë ose 80.9 % të buxhetit në total. Në raport me buxhetin e vitit 2019 ka një rritje prej 2% plus.

- Garda e Republikës do të ketë 1.7 miliardë lekë ose 7.9 % e buxhetit total dhe në raport me vitin 2019 do të ketë një rritje prej 6 % plus.

- Programi i vetëm që pëson ulje nga programet e Ministrisë së Brendshme është ai që ka të bëjë me menaxhimin e përgjithshëm dhe administrimin, pra ai program që menaxhohet nga vetë Ministria e Brendshme, i cili do të ketë 1.1 miliardë lekë me një ulje rreth 8 % krahasuar me

vitin 2019. Uljet që i janë bërë programit të menaxhimit të përgjithshëm dhe administrimit shkojnë në favor të rritjeve të shënuara të Policisë, Gardës, SHÇBA-së e me radhë.

- Gjendja civile ka 683.5 milionë ose plus 1% krahasuar me vitin 2019.
- Ndërkohë që prefektura dhe funksionet e deleguara kanë 540 milionë lekë ose 1.35 % më shumë nga një vit më parë.
- Këto shpenzime shkojnë kryesisht në favor të shpenzimeve të personelit rreth 15.7 miliardë lekë
- Shpenzimet operative 3.5 miliardë
- Investimet 1 miliard
- Shpenzimet për investimet nga financimi i huaj 819 milionë. Pra, rreth 75% të buxhetit e merr personeli, 16.9% shpenzime të tjera dhe për investimet janë 5% investimi i brendshëm dhe 3.9% financimi i huaj, që këto rreth 9% e totalit janë investimet.

Cilat janë disa nga projektet kryesore që do të mbështeten kryesisht gjatë këtij viti me investime nga Ministria e brendshme?

Së pari, projekti i parë ka të bëjë me projektimin e mjediseve për Forcën e Posaçme Operacionale. Policia e Shtetit ka edhe një forcë të posaçme operacionale, e cila këtë vit është shtuar me një komponent të veçantë të saj që është Njësia Speciale për kërkimin dhe kapjen e personave që i janë shmangur drejtësisë. Ky është një projekt i rëndësishëm i munguar në sistemin tonë të policisë, që lidhet me nevojën për të kërkuar, kapur dhe vënë para përgjegjësisë penale personat që i janë shmangur drejtësisë në aspektin e vuajtjes së dënimit apo qoftë ata që i janë shmangur një procedimi penal.

Për fat të keq, dihet që në harkun e tri dekadave, shumë shtetas shqiptarë, megjithëse janë dënuar me vendime të formës së prerë nga gjykatat e vendit, u janë shmangur dënimit dhe ky numër është dramatikisht i lartë. Janë jo qindra, por mijëra, të cilët i janë shmangur drejtësisë dhe janë ende në statusin e personit në kërkim jashtë vendit.

Në funksion të realizimit të këtij objekti për të bërë të mundur që drejtësia e dhënë të mund të ekzekutohet dhe të mos ngelet thjesht drejtësi në letër, por të ekzekutohet në realitet, është ngritur kjo njësi speciale, e cila tashmë ka filluar punën e saj. Kjo njësi do të mbështetet me mjedise dhe infrastrukturë të re. Këtë vit do të bëhet vetëm projektimi i infrastrukturës përkatëse të kësaj njësie, ndërkohë që vitin e ardhshëm planifikojmë të rikonstruojmë ato mjedise ku njësia do të vendoset.

Ndërtime ose investime të rëndësishme janë parashikuar edhe në disa fusha të tjera të policisë. Do të vijojë puna për përfundimin e investimit të Drejtorisë Vendore të Policisë në Shkodër. Këtë vit do të jetë rreth 25 milionë lekë për ta mbyllur të gjithë këtë investim të rëndësishëm për Policinë e Shtetit.

Puna do të vijojë edhe për një projekt, i cili ka nisur më parë për Dhomat e Shoqërimit dhe Blloku i Sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Edhe për këtë vit janë parashikuar 142 milionë lekë. Me mbylljen e këtij investimi, të paktën për qytetin e Tiranës dhe për Drejtorinë Vendore të Policisë së Tiranës, do të jenë krijuar mjedise të nevojshme, të duhura, të përshtatshme me standarde të pranueshme për shoqërimin e personave në polici.

Një investim tjetër i rëndësishëm i parashikuar për vitin 2020 është investimi në pikën kufitare Qafë Botë, projekt i cili do të realizohet në bashkëpunim me Bashkimin Europian në vlerën e 32 milionë lekëve, i cili do të mundësojë që edhe kjo pikë kufitare të arrijë standardet që duhet të kenë pikat e kalimit kufitar. Theksoj edhe një herë rëndësinë e madhe që ka menaxhimi dhe kontrolli i duhur i kufirit tonë me Greqinë për arsye të flukseve migratore, të cilat përveç shumë arsyeve të tjera, paraqesin shqetësim edhe në fushën e sigurisë, arsye që tashmë dihen, rrezikut të infiltrimit në flukset migratore dhe të personave me rrezikshmëri ose histori përfshirjeje në grupe apo organizata terroriste. Për këtë arsye menaxhimi i gjithë kufirit jugor të vendit merr përparësi të dorës së parë dhe kjo shkon në favor të këtij objekti.

Ndërkohë, siç jeni në dijeni, në gjithë vijën tonë të kufirit jugor vazhdon të zhvillohet me sukses të plotë operacioni me Frontex-in, i cili po sjell rezultate shumë të mira dhe po merr vlerësim të lartë nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Vetëm para disa ditësh isha në Shkup, ku u zhvillua një konferencë e ministrave të Brendshëm të Ballkanit Perëndimor bashkë me përfaqësuesit e Bashkimit Europian, ku u vlerësua shumë lartë angazhimi i Shqipërisë në kuadër të këtij operacioni.

Një projekt tjetër shumë i rëndësishëm, prioritet i këtij viti, është edhe rindërtimi ose ndërtimi nga e para e Institutit të Policisë Shkencore. Ky projekt merr rëndësi të madhe për arsye se vendi nuk ka arritur pothuajse në harkun e tri dekadave të ndërtojë një laborator të Policisë Shkencore, i cili do të plotësojë të gjithë parametrat që duhet të ketë një institucion i tillë. Ende ky laborator është i pacertifikuar, i pakredituar, në kushte infrastrukturore të papërshtatshme, me mjedise të pamjaftueshme, me aparatura të paapdejtura e kështu me radhë.

Ne kemi vendosur ta fokusojmë vëmendjen prioritare të Ministrisë së Brendshme në rindërtimin e këtij institucioni, i cili do t'i shërbejë tashmë jo vetëm Policisë së Shtetit, por do t'u shërbejë shumë aktorëve të tjerë, i shërben sistemit të drejtësisë në tërësinë e vetë.

Në bashkëpunim me një partner strategjik të vendit është dakordësuar tashmë që do të punohet së bashku për ta bërë nga e para Laboratorin Shkencor duke ndarë rolet që Shqipëria do të bëjë infrastrukturën dhe godinën. Bëhet fjalë për një godinë të posaçme jo të zakonshme, e cila do t'i plotësojë të gjithë parametrat specifikë dhe më pas partneri i këtij projekti do të mundësojë pajisjen me të gjitha aparaturat e nevojshme që i nevojiten një institucioni dhe një laborator të tillë, si dhe do të kujdeset për certifikimin dhe akreditimin e personelit të këtij institucioni.

Pra, në këtë në mënyrë më në fund Shqipëria do të ketë një laborator shkencor dhe të padiskutueshëm në saktësinë e përfundimeve që jep për të gjitha çështjet penale apo të çështjeve të tjera. Kontributi nga ana jonë do të jetë i madh edhe në kuadër të funksionimit të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë si BKH-ja, SPAK-u e të tjera, në mënyrë që secila prej tyre t'i referohet një institucioni të padiskutueshëm.

Investime të rëndësishme janë parashikuar edhe në vijimin e projekteve që kanë të bëjnë me fuqizimin e flotës së automjeteve në dispozicion të Policisë së Shtetit. Tashmë dihet që Policia e Shtetit ka nevojë organike furnizimin me automjete të përshtatshme dhe moderne dhe për këto arsye edhe këtë vit do të vijojë puna në të njëjtën mënyrë siç është bërë deri tani, për të ta fuqizuar më tej këtë flotë, në mënyrë që të gjitha pamjet e papëlqyeshme që kanë qenë traditë te ne, si mjetet që shtyheshin policët e jo që i mbartnin ata, të kalojnë nëpër arkiva.

Këto ditë do të organizohet një aktivitet publik, për të prezantuar një pjesë të kësaj flote, ndërkohë që në muajt dhjetor dhe janar do të vazhdojë realizimi i këtij projekti, i cili do t'i japë një trajtë dhe një pamje krejt tjetër Policisë së Shtetit, të paktën në aspektin e mobilitetit. Bëhet fjalë për rreth 150 mikrobuzë, rreth 50 fuoristrada e të tjera, një kontribut shumë i rëndësishëm ndaj mobilitetit të Policisë së Shtetit.

Po kështu do të vazhdojmë me planet për blerje pajisjesh për policinë kriminale dhe policinë shkencore. Dihet që intensifikimi i luftës kundër krimit të organizuar kërkon fuqizimin e kapaciteteve investiguese të policisë në tërësi, por të policisë kriminale në veçanti me mjete dhe aparatura teknike, të cilat vihen në funksion të përdorimit të mjeteve dhe të metodave speciale të hetimit. Në vijueshmëri do të sigurohemi që të kemi të gjithë angazhimin e qeverisë për të kaluar në një fazë të re të luftës kundër krimit të organizuar, gjë që është shpallur publikisht dhe besoj

se edhe Kryeministri në ditët në vijim do të paraqesë detajet e këtij angazhimi serioz, me qëllim që lufta kundër krimit të organizuar të ketë një kapërcim kuantik të ri përpara dhe me rëndësi të jashtëzakonshme për të ardhmen e vendit dhe për perspektivën europiane të tij.

Sa i përket planifikimit dhe menaxhimit apo programeve që menaxhohen vetë nga Ministria e Brendshme nuk do të ketë ndonjë gjë spektakolare, përkundrazi ka zbritje, sepse kemi zbritur nga programi qendror me qëllimin për të mbështetur programet e policisë dhe të tjera. Megjithatë, sa i takon programit të menaxhimit një dukuri e re është investimi me një godinë të re për SHÇBA-në, me qëllim që ky institucion të marrë përsipër dhe të kryejë në kushte optimale të gjitha detyrat e tij ligjore. Nevoja për një godinë të re për SHÇBA-në lidhet edhe me faktin se ajo është vendosur pranë godinave të Ministrisë së Brendshme në kushte jo optimale, ndërkohë, me rolin e ri që i është dhënë duhet të intensifikojë edhe investimet në fushën teknike, për arsye se procesi i vetingut në polici do të vijojë edhe në fazën e dytë dhe të tretë me aplikimin e teknologjive moderne. Po ju përmend këtu fjalën e aparaturës që quhet “poligraf”, e cila do të përdoret jo vetëm në funksion të vetingut në polici, por edhe në funksion të strukturave të tjera, siç është ai i gjyqësorit dhe më gjerë. Për këtë qëllim është parashikuar ngritja e një godine të posaçme për SHÇBA-në në të cilën do të vendosen të gjitha aparaturat dhe teknologjia që do të përdoren në funksion të vetingut.

Sa i takon Gardës së Republikës kemi një rritje të buxhetit në krahasim me vitin e kaluar. Rritja argumentohet me faktin se është rritur edhe përgjegjësia dhe detyrat e Gardës së Republikës në shërbim të sigurisë së autoriteteve apo të personaliteteve të tjera që shërbejnë në sistemin e drejtësisë si, gjyqtarë, prokurorë dhe në funksion të kësaj janë parashikuar investime të caktuara për të mundësuar fuqizimin e Gardës qoftë në aspektin teknik dhe atë të personelit, duke shtuar njerëz dhe para. Ky buxhet do të shkojë kryesisht në blerje armatimi, teknologji, investime në fushën e mbrojtjes, lëndë eksplozive dhe të shkatërrimit në masë, me qëllim që Garda të vijojë të jetë në lartësinë e kërkesave që ka funksioni i saj.

Sa u përket prefekturave do të parashikohen investime të caktuara, kryesisht do të vijojë restaurimi i Prefekturës së Tiranës me idenë që kur të përfundojë ky restaurim të vendosim një model, pra modelin e Prefekturës së Tiranës, i cili do të ndiqet më tej edhe nga prefekturat e tjera të vendit. Investime të tjera janë parashikuar në sistemin e gjendjes civile, e cila është një ndër zyrtat më kryesore të shtetit. Sot për sot të gjithë shqiptarët e kanë mendjen te hipoteka, por, në fakt, dy regjistrat kryesorë janë ajo e hipotekës dhe e gjendjes civile dhe kjo e fundit është

prioriteti ynë, prandaj ne duam ta modernizojmë atë dhe qytetarëve t'u ofrohet një shërbim më i mirë. Kjo gjë ka ndryshuar shumë dhe gjendja civile u ofron njerëzve sot shërbime *online*, por e gjithë kjo ka koston e saj, sepse kërkon mirëmbajtje dhe zhvillim. Këto janë arsyt pse janë parashikuar fonde që shkojnë në këtë drejtim. Këto ishin ato që kisha për shifrat e parave.

Sa u përket njerëzve janë parashikuar shtesa në Gardën e Republikës, siç jua thashë edhe pak më parë, 27 punonjës shtohen në Gardën e Republikës, 31 punonjës në SHÇBA. Ndërkohë, janë pakësuar disa struktura të tjera, të cilat kanë qenë më parë në Ministrinë e Brendshme dhe tashmë nuk janë më, duke kaluar te Kadastra, si Komisioni për Verifikimin e Titujve të Pronësisë dhe Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave dhe për këtë arsye është ulur edhe numri i njerëzve.

Sigurisht, me të gjitha këto që ju thashë gjykojmë se buxheti i parashikuar për Ministrinë e Brendshme mundëson që kjo ministri ta kryejë me sukses misionin që ka së bashku me strukturat përkatëse, edhe pse ka një rritje jo të madhe nga buxheti i vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë jemi optimistë që buxheti i Ministrisë së Brendshme do të ketë një rritje edhe gjatë vitit për shkak të dinamikave që lidhen me performancën e ekonomisë në tërësi, një tendencë, e cila ka vijuar. Pothuajse është bërë si rregull që buxheti i Ministrisë së Brendshme të njohë gjithmonë një rritje në gjysmën e dytë të vitit dhe shpresojmë që edhe për këtë vit nuk do të ketë përjashti. Kjo perspektivë është e qartë edhe nga diskutimi që kemi pasur me kolegët tanë të financës në qeveri.

Në mbyllje, duke ju falënderuar për vëmendjen, mendoj se buxheti i plotëson kushtet që ne të vijojmë kryerjen e detyrës me sukses, si dhe jemi të bindur se do ta realizojmë ashtu siç janë edhe pritshmëritë e publikut dhe të Kuvendit.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Lleshaj, për fjalën tuaj të detajuar!

T'ju them të drejtën disa prej gjërave që ju përmendët realisht na gëzuan, sepse ne kemi qenë pjesë e konstatimit në vend. Fjala vjen, kemi qenë në Institutin e Lartë të Policisë Shkencore dhe më vjen mirë, sikundër e përmendët edhe në fjalën tuaj, që pas 30 vjetësh është bërë një investim i tillë dhe kaq shumë i domosdoshëm, pika fokale e hetimit të çështjeve penale. Investimi që do të bëhet në këtë institucion me teknologji dhe kapacitete njerëzore, një pjesë të të

cilave realisht i kemi shumë të mira është mëse i domosdoshëm dhe mendoj se hyn tek ato gjërat më mirë vonë se kurrë. E rëndësishme është që do të bëhet.

Po ashtu, ju në fjalën tuaj na sollët disa gjëra të reja sa i takon investimeve të tjera. Dua të sjell në vëmendjen e kolegëve pikën e kalimit kufitar Qafë-Botë, i cili është një investim i rëndësishëm, si dhe blloku i dhomave të sigurisë në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, duke pasur parasysh gjithë perkorsin e gjërave që ka kaluar policia gjatë këtij viti kur persona të ndryshëm të shoqëruar në ambientet e Drejtorisë së Policisë në Tiranë janë bërë shkak, që vetë objekti i Policisë së Tiranës, i cili është një objekt i rikonstruar dhe model, duke qenë vazhdimisht nën trysninë apo sulmin e njerëzve apo të sjelljeve të papërgjegjshme.

Policia e Shtetit është shumë komplekse si rezultat i problematikave që ka, prandaj nuk pretendojmë që çdo gjë që kemi konstatuar është realizuar, prandaj në vijim mendoj se do të mund të ezaurohet brenda këtij viti, por e rëndësishme është që puna tashmë ka filluar dhe vit pas viti është duke u intensifikuar, e cila patjetër do të japë rezultatet e saj edhe në luftën kundër krimit.

Dita e sotme qëlloi të ishte një ditë e frytshme, sepse, nëse në pjesën e parë u njohëm me rezultatet e luftës kundër krimit, duke pasur një ide shumë të qartë të të dhënave të krimit në shkallë kombëtare për 1 vit, e shoqëruar kjo me informacionin për mbështetjen financiare që qeveria jep për Policinë e Shtetit, sepse u bë edhe më i plotë gjithë kuadri i të dhënave. Unë mendoj se të gjithë ata që kontribuojnë sot në Policinë e Shtetit, një trupë që nuk është e vogël, por ka mijëra veta brenda saj, janë në dijeni që shteti i mbështet gjithmonë dhe kjo është vërtetë nxitëse dhe inkurajuese. Pra, duke kuptuar që qeveria dhe shteti janë të mbështetje të Policisë së Shtetit i inkurajon më shumë këta njerëz, të cilët janë në vijën e parë të luftës kundër krimit.

Diskutimin për buxhetin e kemi të hapur. Ky është një rregull i Kuvendit të Shqipërisë që këto punë të ndahen me ministrin. Besoj se kolegët janë të informuar shumë mirë me situatën që ka çdo drejtori policie në çdo qark, prandaj do të ishte mëse e domosdoshme që këtë komunikim ta ndanim posaçërisht me ju.

Pa vonesë fjalën e ka zonja Gjebrea si relatore.

Më pas do të fillojmë me pyetjet nga ana e kolegëve.

Faleminderit!

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Ministër, zëvendësministër dhe përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, ju falënderoj për prezencën tuaj!

E dëgjova me vëmendje fjalën tuaj, prandaj dua ta përmbledh me 2-3 pika atë çfarë parashikon buxheti i Ministrisë së Brendshme dhe më pas do t'ju adresoj disa pyetje në lidhje me këtë.

Është një lajm i mirë që buxheti i Ministrisë së Brendshme për vitin 2020, sikurse e thatë edhe ju, i plotëson këto nevoja, pavarësisht se do të doja që të kishte një rritje dhe kjo rritje të vazhdonte në mënyrë progresive, por gjithsesi ju ishit optimist se do të kishte një rritje 6-mujorin e dytë të vitit që vjen.

Buxheti i Ministrisë së Brendshme synon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut; garantimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit; pronës së qytetarit; sigurimin e rendit publik; kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet, të cilat të realizuara në praktikë përmbledhen përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor në funksion të një kontrolli më efektiv dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve ndaj komunitetit; rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, krijimi i një mjedisi më të sigurt për komunitetin nëpërmjet shërbimeve më profesionale në kohë dhe policimin me standarde më të larta të performancës; përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së personaliteteve vendase dhe të huaja dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, si dhe konsolidimi i mëtejshëm i një sistemi bashkëkohor të digjitalizuar të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile; të sistemit të Regjistrat Kombëtar të Adresave dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektrik dhe pasaportës biometrike.

Sigurisht që ka shumë lajme pozitive sa i takon asaj që ju parashtruat në lidhje me financimet nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020. Siç e tha edhe kryetarja, pa dyshim që është një lajm shumë i mirë fakti që do të kemi një polici shkencore, t'ju them të vërtetën kur thatë që do të transferohet në një vend tjetër po mendoja: A mund të mbaj më kjo polici shkencore dhe laborator një zhvendosje tjetër?

Më vonë dëgjova që ju thatë se së bashku me një bashkëfinancim do të kemi mundësinë të kemi një laborator dhe një polici shkencore moderne, gjë të cilën Shqipëria e meriton dhe duhet ta ketë.

Pa dyshim, financimet e huaja janë të rëndësishme. Duke parë tabelën që kemi përpara, ndoshta mund të ketë ndonjë gabim, sipas zërave që na kanë ardhur, financimi i huaj për vitin 2020 del zero. Ky duhet të jetë një lapsus, sepse ju thatë që ka, pasi edhe për vitet e tjera shoh që

shifrat është e njëjtë 818,868 sa i takon pjesës së mbështetjes së huaj. Do të doja pak më shumë detaje se çfarë kuptohet me financime të huaja, nëse do të kemi?

Nga informacionet që kam pasur di që ka pasur gjithmonë projekte me SIDA-n dhe disa donatorë të tjerë, sidomos për rikonstruksionin e komisariateve. Buxheti që kemi mesa duket nuk lejon më shumë sesa një, siç është rasti i Shkodrës. Në fakt, nga të gjitha vizitat që kemi bërë si Komision i Sigurisë nëpër qytete të ndryshme mendoj se edhe komisariati i Elbasanit ka nevojë për riparim, pasi është një qytet i rëndësishëm, por edhe komisariate në qytete më të vogla. Ne e kuptojmë që me një buxhet të tillë nuk është luks për të mbuluar shumë, por ndoshta bashkëpunimi me donatorë të huaj dhe financimi me projekte mund të ndihmojë në shtimin e mundësive për rikonstruksionin e disa godinave.

Një nga problematikat që kemi hasur nga diskutimet e frytshme që kemi bërë si komision në disa komisariate ka qenë edhe pjesa e uniformave dhe e këpucëve. Mendoj se ju do t'i parashikoni në buxhetin tuaj, por kemi pasur ankesa sa u përket uniformave dhe këpucëve në mos pasjen e...

(Diskutime pa mikrofon)

Po ashtu, një shqetësim tjetër ka të bëjë me sallat operative, mendoj se është diçka që mund të bëhet, siç është ajo e Tiranës. Nga informacioni që unë kam rikonstruksioni i kësaj sale kap një vlerë prej 80 mijë eurosh. Është një vlerë, e cila mund të përballohet edhe për salla të tjera operative aq më tepër, duke mos pasur edhe një teknologji jo të zhvilluar pajisja e këtyre sallave do t'i ndihmonte efektivët e policisë për të pasur një fushëpamje më të qartë të ngjarjes, duke ndihmuar edhe në parandalimin e tyre. Nëse kjo do të rishihet, mendoj se përmirësimi i punës së policisë do të sillte rezultate, e cila vjen si rezultat jo vetëm i një infrastrukture më të mirë, por edhe të një teknologjie më mirë.

Pajisja me mjete transporti është një problematikë që është hasur, por ndërkohë ju thatë se do të keni rreth 150 mikrobusë dhe 50 fuoristrada, pra ka një parashikim në buxhet sa i takon fuqizimit të flotës së automjeteve.

Kam shpresë se buxheti ashtu do t'ju ndihmojë. Pa dyshim do të kishim dashur një buxhet më të madh, por nga ana tjetër besoj se edhe angazhimi juaj me mbështetje të huaj do të ndihmojë në përmbushjen e atyre boshllëqeve, të cilat nuk arrijnë të përmbushen me buxhetin që kemi.

Ju falënderoj për punën tuaj dhe për mbështetjen që i jepni Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Kuptohet që përdorimi sa më efektiv i parasë publike ngelet gjithmonë diçka ku ka ende për të eksploruar dhe për të bërë më mirë.

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Më pas fjalën e ka zoti Maliqi.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, zoti Ministër, nëse më lejoni, unë do të sjell në vëmendje të kolegëve të mi që ardhja juaj në krye të Ministrisë së Brendshme pati disa hamendësime. Me Presidentin e Republikës i zgjidhët shpejt gjërat, sepse treguat shkresat dhe letrat, por u desh 1 vit për të na bindur ne. E them sinqerisht që në krye të Ministrisë së Brendshme ju keni treguar vetëm lualitet. Organizata e policisë u frustrua, pasi menduan se ardhja e një ushtaraku nga Ministria e Mbrojtjes, do të ishte si ajo e një Gjenerali të Lartë me një brigadë nga pas, por rezultoi e kundërta, pasi askush nga drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit nuk u cenua, madje krijuat një hapësirë të admirueshme, ku doli në pah edhe pretimi i Kryeministrit, për të sjellë në radhët e policisë njerëz me vullnet dhe ide të reja. Unë jam ushtarak dhe ju treguat anën tjetër të ushtarakut, atë sociale, anën e durimit dhe humanizmit.

Në këtë kontekst, Zoti Ministër, lind pyetja: sa ka qenë numri i studentëve që janë rikthyer, kanë bërë kërkesë apo kanë kryer Akademinë e Policisë? Sa prej studentëve ekselentë janë pozicionuar në detyra? Sa është momentalisht numri i studentëve që po e kryejnë Akademinë?

Së dyti, 1 vit më parë u angazhuat për të bërë vetingun dhe gjërat tashmë kanë filluar të zgjidhen, madje në buxhet është parashikuar, bashkë me vërejtjet e kolegëve të mi, krijimi i kushteve të anëtarëve të komisionit. Besoj se edhe kjo gjë do të jetë në rrugën e zgjedhjes.

Së treti, thatë se do të krijoni forca të veçanta operationale, të cilat do të ndihmojnë për të zbatuar punën e nisur të forcës së ligjit. A keni parashikuar një numër? Si do të bëhet thithja dhe absorbimi i tyre?

Së katërti, zoti Ministër, edhe në takimin e paradites me drejtorin e Përgjithshëm u soll në vëmendje të kolegëve të mi dhe të komisionit, që Policia e Shtetit vazhdon të ketë ende një numër të vogël në raport me numrin e popullsisë. A keni menduar t'u afroheni vendeve të

Bashkimit European për rritjen e këtij numri, pasi në informacionin tuaj na dhatë 27 shtesa në një sektor dhe 31 shtesa në një sektor tjetër?

Zoti Ministër, gjej rastin ta falënderoj kryetarin e komisionit, i cili ka bërë të mundur që ne të krijojmë akses për të kontaktuar drejtpërdrejt me Drejtoritë e Policisë së qarqeve të vendit. Ka dalë një problem, zoti Ministër dhe është e nevojshme të bëhen bashkëpunime edhe me palën e tretë. Këtu kam parasysh pushtetin lokal, pasi vrasjet apo ngjarjet më të rënda ndodhin pikërisht në qendrat e banuara. A ka ministria një objektiv në këtë drejtim, për të pasur një bashkëpunim, që t'i pajisin këto qytete me kamera, siç është bërë e mundur në Tiranë? Kjo do të ndihmonte në saktësimin e krimit që ndodh në qendrat e banuara? Për këtë gjë ministria nuk ka buxhet, por bashkitë kanë fondet e tyre.

I bindur për përgjigjet që do të më jepni, por ndoshta do të më jepet mundësia të flas edhe për paqartësi të tjera, dua ta mbyll fjalën time duke thënë se, edhe në dikasteret e tjera, qeveria “Rama” vazhdon të rrisë në mënyrë progresive buxhetet në zëra të veçantë. Më vjen mirë që një vëmendje e madhe është edhe në drejtim të dikasterit që ju drejtoni.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Zoti Qefalia, mendoj se ne të gjithë si komision i kemi dhënë suportin institucionit të Ministrisë së Brendshme, posaçërisht ministrit, dhe këtë e kemi bërë për faktin se siguria është një çështje shumë e rëndësishme, që na bashkon të gjithëve, ndaj nuk ka arsye të tregohemi të pandjeshëm.

Nga ana tjetër, besoj se kemi dy shembuj shumë të mirë. Ndërhyrjet që u bënë në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, për të lehtësuar mungesat në numrin e punonjësve të policisë, por ,mbi të gjitha, për të rritur kapacitetet intelektuale të domosdoshme brenda forcës, të shoqëruara me ndërhyrjet që bëme në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të SHÇBA-së”, kanë qenë në konsensus të plotë midis nesh dhe Ministrisë së Brendshme. Besoj se na kanë dhënë një start shumë të mirë veprimi. Sidoqoftë, shqetësimet e zotit Qefalia janë me vend, pasi janë shqetësime edhe të kolegëve të tjerë, të cilët mund të drejtojnë pyetje dhe është një rast i mirë për të pasur një përgjigje.

Faleminderit!

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Po kaloj shkurtimisht në dy-tri pika që i përmendët ju dhe zonja Gjebrea. Ndoshta nuk ishin në formë pyetjesh, por përmendët se kemi një polici të konsiderueshme.

Në fakt, është e konsiderueshme, por jo e mjaftueshme. Policia jonë është e vogël dhe me këtë po i jap edhe një përgjigje zotit Qefalia. Shqipëria ka një ndër policitë më të vogla në rajon dhe më gjerë. Ne jemi pothuajse në nivelet nordike për sa i përket numrit të policisë për frymë të popullsisë. Nëse ne duam të kemi një polici të ngjashme me vendet që na rrethojnë, si: Italia, Greqia, Kroacia dhe Mali i Zi, duhet të shkojmë në numrin prej 20 mijë policësh. Sot kemi 11 mijë e 58 policë gjithsej. Qeveria planifikon të shtojë numrin e policëve në mënyrë të ndjeshme dhe do të jetë investim i madh, me rreth 500 vetë. Ndërkohë, kanë filluar studimet në Akademinë e Sigurisë. Mund t'ju them se sot Akademia e Sigurisë ka rreth 900 studentë kursantë, që nuk i ka pasur kurrë në historinë e saj të re, madje edhe të vjetër, me sa më kanë thënë ata që e njohin më thellë, me të cilët ne synojmë të plotësojmë, të kompensojmë, në një farë mënyre, boshllëqet e mëdha të krijuara ndër vite nga mungesa fatale e funksionimit të kësaj Akademie.

Zonja Gjebrea përmendi disa gjëra të rëndësishme. Unë do të flas për rikonstruksionin e komisariateve. Ne kemi në plan rikonstruksionin e të gjitha komisariateve. Në Shqipëri janë rikonstutuar ose janë ndërtuar shkolla të reja, qendra shëndetësore, burgje e të tjera, por pak ose aspak komisariate, sidomos jashtë Tiranës. Ne kemi në plan një program kombëtar për të shtuar komisariate dhe të rindërtohen të gjitha sipas një modeli të caktuar. Tani jemi në fazën e mbylljes së projektit. Do të kemi një ose dy tipe komisariatesh në të gjithë Shqipërinë.

Së dyti, kemi një plan për rishpërndarjen e tyre sipas shpërndarjes së popullsisë. Popullsia pas viteve '90 ka lëvizur drejt qendrave të mëdha urbane ose jashtë vendit, ndërkohë që komisariatet kanë mbetur ku kanë qenë, me të njëjtat struktura sigurie si para viteve '90, me degët e brendshme para viteve '90, që janë bërë komisariate, të cilat janë rrënuar. Synimi ynë është t'i afrojmë komisariatet te njerëzit. Për shembull, popullsia e Tiranës, në raport me vitin '90, është pesëfishuar-gjashtëfishuar, ndërsa komisariatet janë ato që kanë qenë. Dikur kanë qenë rajone të policisë, sot janë komisariate, por ato kanë mbetur. Kamza është e gjitha me 100 mijë banorë e kështu me radhë.

Ne duam të shtojmë numrin e komisariateve në Tiranë dhe në qendrat e tjera urbane, të përshtasim numrin dhe madhësinë e komisariateve në qendrat rurale, ku njerëzit janë larguar, dhe të investojmë që komisariatet të bëhen siç duhet të jenë. Nuk besoj se do të jetë një dramë e madhe për vendin, por është një investim i madh për sigurinë e vendit tonë nëse arrijmë ta bëjmë. Do ta bëjmë, sepse projekti është shumë i qartë.

Për sa u përket uniformave, është një plagë e vjetër, për të cilën ne po punojmë. Shpresoj që brenda këtij viti të zgjidhet çështja e formulës së pajisjes me uniformë të punonjësve të Policisë së Shtetit. Unë e kam deklaruar që ditën e parë në këtë zyrë se do të heqim dorë nga furnizimi me uniformë të punonjësve të policisë nëpërmjet magazinave. Punonjësit e policisë, si në botën moderne, do të marrin paratë dhe do të blejnë uniformat, sipas nevojës, në një apo dy subjekte që do të licencohen nga qeveria, që të ketë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë me subjektin furnizues dhe jo një marrëdhënie të përqendruar, ku një pritës malli vendoste për të gjithë policët e Shqipërisë, ku bëheshin tendera dhe procedura, që dështonin çdo vit. Për disa vite rresht nuk është realizuar një procedurë e rregullt për furnizimin me uniforma të Policisë së Shtetit. Mendoj dhe jam optimist që fillimi i vitit 2020 do ta gjejë të zgjidhur këtë situatë. Çdo polic do të ketë një partner furnizues dhe ministria do të luajë vetëm rolin e mbikëqyrësit të kësaj marrëdhënieje. Policët do ta blejnë ose nuk do ta blejnë, por do ta reklamojnë, do të kenë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me subjektin. Secili prej nesh ka një marrëdhënie me atë që blejmë veshjet.

Zonja Gjebrea ngriti problemin e rëndësishëm për sallat operative. Sigurisht, sallat operative janë zemra dhe truri i çdo strukture policie, por janë të pazhvilluara siç duhet. Në Tiranë është bërë një përpjekje, por në rrethe ende nuk është bërë. Ne kemi një projekt, i cili, në kuadër të numrit të famshëm 112, synon të konsolidojnë një shërbim të informacionit dhe të drejtimit të policisë në nivele kombëtare. Po merremi me këtë gjë.

Për sa i përket pyetjes së zotit Qefalia, nuk ka pasur rikthime në punë në polici të atyre që janë larguar, sepse ligji na ndalon të rikthejmë ata që kanë mbi 2 vjet të larguar. Meriton të rishikohet kjo klauzolë. Ndoshta vitin e ardhshëm do të gjejmë një mundësi ta ritrajtojmë këtë çështje, sepse ka kapacitete, por nuk u lejohej të kthehen në polici, ndërkohë që ne kemi nevojë dhe kërkesa. Për shembull, një oficer të nivelit drejtues nuk mund ta marrim, sepse nuk na lejon sistemi i gradave, ndërkohë që ai mund të jetë duke pritur në shtëpi për të shërbyer.

Për sa u përket studentëve të ekselencës, e them me shumë kënaqësi që ne sivjet, në kuadër të ndryshimeve ligjore që kemi bërë, arritëm të hapim një kanal përmes së cilit të tërheqim studentë të ekselencës, që mbarojnë universitetin, për në Policinë e Shtetit.

Sivjet kemi mbyllur kursin e parë. Shumë prej jush kanë qenë të pranishëm në ceremoninë e diplomimit. Nga një numër me rreth 300 kandidatë, përzgjedhëm 36, të cilët arritën ta përfundojnë me sukses kursin e Oficerit të Policisë Kriminale.

Studentët e ekselencës, që kanë mbaruar ekonomi, financë, informatikë ose jurisprudencë, me rezultate shumë të larta, me parametra të tjerë, krejtësisht optimale, me një nivel të gjuhës angleze e me radhë, të cilët janë diplomuar, do të angazhohen në kuadër të një njësie të posaçme për luftën kundër krimit ekonomik.

Po ashtu, u përzgjedhën 30 të tjerë nga 500 kandidatë, për arsye se ne i kemi qëndruar strikt kërkesës, që do të hyjnë vetëm ata që plotësojnë të gjitha parametrat e kërkuara. Pra, nga 500 kandidatë janë pranuar vetëm 30, të cilët i kanë të gjitha parametrat super të larta, kanë mesataren mbi 8, kanë nivelin e gjuhës angleze të testuar sipas standardeve ndërkombëtare, po në këtë nivel, kanë parametrat fizikë dhe kanë kushtet e sigurisë. Do ta vazhdojmë me konsekuencë përthithjen nga universitet, sepse ne duam të rrisim dukshëm cilësinë e policisë në tërësi, por sidomos cilësinë e strukturave të hetimit të krimit, ku kërkohen profile shumë të spikatura profesionale.

Për krimin ekonomik do të ndërtojmë atë që quhet “Struktura E”, ekonomia. Do të ndërtojmë një strukturë tjetër, “Struktura I”, informacioni ose inteligjenca, që të kemi inteligjencë *best policing*, siç i thotë e gjithë bota, një polici të bazuar në inteligjencë. Do të kemi njësinë “Struktura C”, që është njësia e krimit kompjuterik, dhe për t’i populluar këto njësi duhen specialistë të një niveli shumë të veçantë. Këto struktura nuk mund të funksionojnë në bazë të oficerëve të linjës së policisë, por duan specializim të mirëfilltë dhe këtë do ta vazhdojmë me konsekuencë.

Për fat të mirë, edhe partnerët ndërkombëtarë janë shumë aktivë dhe po na mbështesin, në mënyrë që dalëngadalë të krijojmë profile profesionale të certifikuara ndërkombëtarisht. Një oficer i policisë së krimit ekonomik është krejtësisht i ndryshëm nga një oficer i kufirit apo nga një oficer i rendit publik. Pra, është si një profesion më vete, si për shembull një doktor dhe një inxhinier. Ne duam t’i krijojmë këto profesione, sepse janë asete krejtësisht të munguara.

Për sa u përket pyetjeve që bëhen për vetingun. Siç e thashë, vetingu ka filluar dhe ka pasur disa rezultate të para, sepse, edhe kur kemi konfirmime, edhe kur kemi përjashtime, unë i quaj rezultate.

Për sa u përket Forcave të Posaçme Operacionale, mund të them se kemi filluar me fuqizimin e strukturës së posaçme operacionale, me strukturën e kapjes së personave në kërkim. Kjo strukturë ka rreth 100 veta dhe do të jetë e angazhuar vetëm me këtë çështje, me personat që

i janë larguar drejtësisë ose që i janë shmangur procedimit penal. Ndërkohë, e gjithë struktura është në këtë kuadër për krimin ekonomik dhe krimin kompjuterik.

Lidhur me pyetjen tjetër për sa i përket numrit të punonjësve të Policisë së Shtetit si është dhe si do të shkojë, siç e thashë gjithsej janë 11 mijë e 58 punonjës. Ne synojmë që vitin e ardhshëm të kemi 500 punonjës plus, sepse këtë vit e kemi shtuar numrin e punonjësve në 100. Pra, kanë qenë 100 minus dhe ne shtuam 100, gjithashtu në vitin 2020 do të shtojmë edhe 500 të tjerë. Këtë gjë nuk e përmenda, pasi është në kuadër të një programi të veçantë dhe nuk del ende te këto shifrat këtu, por ju premtoj se kjo gjë do të realizohet pasi ndërkohë kanë filluar edhe trajnimet. Sot në Akademinë e Policisë janë 500 studentë plus, me të cilët do të fuqizojmë kryesisht strukturat e ndërhyrjes, pra strukturat e reagimit të shpejtë nëpër qarqe dhe nëpër drejtoritë vendore, sepse nuk kemi kapacitete ndërhyrjeje në raste krizash, ku duhet të arrestohet dikush apo duhet të ndiqet dikush penalisht, që ka kryer një krim e kështu me radhë. Ne duhet të shtojmë në çdo qark disa grupe të gatshme, që duhet të ndërhyjnë shpejt për të zgjidhur situata, të cilat dy vetë në patrullën e përgjithshme nuk mund t'i zgjidhë. Ka shumë raste që e kanë ndarë me mua këtë shqetësim që nuk mund të zgjidhej nga patrulla.

Për sa i përket bashkëpunimit me pushtetin vendor, ishte një çështje tjetër që ngriti zoti Qefalia, në përgjithësi ne po punojmë fort për të ngritur kolonën e dytë që i takon të ketë Ministria e Brendshme. Siç e kam thënë edhe herë të tjera, historikisht Ministra e Brendshme është konceptuar si një ministri e policisë ose si ministria e sigurisë. Në fakt, nuk është vetëm kaq, por Ministra e Brendshme përveç kolonës së sigurisë ka edhe një kolonë tjetër që është pushteti vendor, aq më tepër në kushtet kur funksionimi i Ministrisë së Shtetit për pushtetin vendor nuk është më dhe kjo detyrë i ka kaluar Ministrisë së Brendshme. Ne po punojmë për ta ngritur kolonën e pushtetit vendor, duke filluar nga një drejtori qendrore e pushtetit vendor, Drejtoria e Përgjithshme e Pushtetit Vendor, si dhe agjencia përkatëse për të mbërritur te prefekturat me idenë që edhe prefekturat duhet të zgjerojnë rolin dhe kompetencat e tyre, të jenë partnerë kryesorë në diskutim me njësitë e qeverisjes vendore, në mënyrë që kjo kolonë të zhvillohet.

Për sa i përket rolit që duhet të ketë pushteti vendor në krijimin e sigurisë, patjetër që siguria është atributi i pushtetit vendor dhe kryetari i bashkisë duhet të jetë përgjegjës për bashkinë e tij. Ne po përpiqemi në dy mënyra për të rritur bashkëpunimin direkt me ta, por një gjë e re, që besoj se do të kemi mundësi së shpejti ta prezantojmë publikisht, është fakti që ne po

rikonceptojmë rolin e policive bashkiake. Policinë bashkiake janë konceptuar si struktura të pushtetit vendor për të luajtur një rol komplementar me Policinë e Shtetit në ndërtimin e një sigurie më të plotë për qytetarët. Ky është një koncept i degraduar dhe ngjarjet e këtij viti na kanë bindur se strukturat e policive bashkiake janë struktura rudimentare, në shumë raste të degraduara dhe në disa raste janë të shkatërruara. Të gjithë jemi dëshmitarë, ku kemi pasur disa raste kur strukturat e policive bashkiake u janë kundërvënë fizikisht strukturave të Policisë së Shtetit, të cilat kanë qenë në ushtrim të misionit të saj. Çfarë po ndodh? Po merren masa për rishikimin e ligjit përkatës për policinë bashkiake, në mënyrë që ato të shndërrohen në instrumente serioze komplementare edhe të Policisë së Shtetit, edhe të autoriteteve vendore, në mënyrë që të shmangim këtë situatë të pakëndshme dhe të papranueshme që u evidentua qartësisht vitin që shkoi. Ndërkohë, po marrim masa dhe, në bashkëpunim me strukturat e pushtetit vendor, do të rrisim edhe praninë e teknologjisë në funksion të sigurisë në mjediset e qyteteve tona. Mund t'ju them se, për fat të keq, kudo që do të shkoni në qoftë se jeni të kujdesshëm në qytetet e Shqipërisë, do të shikoni, që semaforët mungojnë ende në rrugët e qyteteve të mëdha të Shqipërisë. Unë nuk e di, përveç Tiranës, nuk më ka qëlluar të ndeshim ndonjë semafor edhe në qytetet të tjera të mëdha të vendit. Nuk është teknologji e lartë semafori, por është teknologji e shekullit të kaluar.

Së pari, në bashkëpunim me autoritetet vendore po përpiqemi të vendosim disa minimume në rrugët e vendit. Për shembull, do të kemi së shpejti një iniciativë për t'i detyruar autoritetet vendore të harxhojnë 5 lekë për të vënë dy semaforë, të paktën edhe për të thënë se jemi në Europë.

Së dyti, për monitorimin e akseve kryesore rrugore me kamera, jo vetëm në qytete, kemi disa projekte të rëndësishme, të cilat besoj se do të jemi në gjendje që në vitin 2020 t'i zhvillojmë drejt konkretizimit.

Tashmë, për fat të mirë, edhe teknologjia mundëson revolucion të vërtetë në këtë fushë dhe ne do të bëjmë disa hapa të rëndësishëm për ta monitoruar qarkullimin dhe gjendjen e sigurisë edhe përmes sensorëve të tillë, si kamerat.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Lleshaj!

Zoti Maliqi e ka fjalën. Pastaj zoti Braho dhe zoti Xhindi.

Lefter Maliqi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faktikisht, na hutoi pak kolegu Qefalia me vlerësime e mbivlerësime, mbase i kishte personale, jo për institucionin.

Projektbuxheti ka një rëndësi të veçantë edhe në luftën për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale. Sigurisht, si pjesë e opozitës, jam për një rritje të buxhetit të Ministrisë së Brendshme, për rritje të pagave të Gardës së Republikës, të Policisë së Shtetit dhe të gjitha me radhë.

Një falënderim e kam edhe për qëndrimin e djeshëm të Komsionit të Sigurisë, për shkak të mungesës së ministrit, zotit Lleshaj!

Besoj se pjesëmarrja juaj ka rëndësi edhe për institucionin, por edhe për Komisionin e Sigurisë, për shkak se ne e dimë shumë mirë që në publik, qoftë institucioni i parlamentit, qoftë qeveria, ka një rënie të ndjeshme në vlerësim.

Ky rast besoj se ka qenë i përsëritur, prandaj Komisioni i Sigurisë, Ministria e Brendshme, por edhe ministritë përkatëse, që kanë lidhje me Komisionin e Sigurisë Kombëtare, duhet të vlerësojnë të paktën njëri-tjetrin. Them se është rast i përsëritur, sepse, me sa di, pavarësisht se nuk kanë qenë deputetët e Komisionit të Sigurisë, kur është bërë dhënia e diplomave të disa studentëve të Akademisë së Rendit, kanë qenë të nënvlerësuar nga protokolli juaj. Kështu që, të paktën sot është momenti që këto gjëra t'i bëjmë publike.

Po e nis nga fundi. Duhet edhe 500 policë në bazë të standardeve tona. Nuk jam kundër, por në krahasim me numrin real të popullsisë, mendoj se janë shumë, sepse po ta shikosh, me shpopullimin që i ka ndodhur vendit, sidomos këta dy vjetët e fundit, numri në bazë të popullsisë, po të bëhesh realist, është i mjaftueshëm. Megjithatë, ngul këmbë te rritja e pagave për Gardës, policinë, të kushtet e të gjitha me radhë.

Ju thatë se nuk ka pasur rikthime në polici nga këta që kanë kaluar mbi 2 vjet. Në dijeninë time të plotë, ka. Shumë mirë që ka të rikthyer. Është gabimi i parlamentit, i komisionit këtu, i Partisë Demokratike dhe i Partisë Socialiste, vendimi që kanë marrë para disa vjetësh, sepse të drejtën e diplomës nuk keni të drejtë t'ia hiqni asnjërit. Ti ke mbaruar për ushtri, unë për polici, tjetri për mjekësi. Nuk mund t'i heqësh tjetrit të drejtën e ushtrimit të profesionit, përveç rasteve kur ka abuzuar me detyrën apo është përjashtuar nga radhët e Policisë së Shtetit. Ky është një gabim. Nuk merrem me emra konkretë, sepse i kam kolegë dhe miq.

Për buxhetin, zoti Ministër, thjesht për ta ditur, te sektori i Policisë Kriminale, meqenëse kemi parandalimin, goditjen dhe pastaj zbulimin e veprimtarisë kriminale, a keni akorduar

ndonjë buxhet shtesë për Policinë Kriminale, për pajisje dhe mjete? Sepse kam qenë në disa komisariate dhe ka shumë mangësi, që është roli kryesor...

Së dyti, mos ka ardhur momenti për rishikimin e strukturave të Policisë së Shtetit?

Unë jam dakord që kjo nuk është bërë në kohën tuaj si ministër, por kanë mbi 6-7 vjet këto struktura, në bashkëpunim me PAMECA-n dhe ICITAP-in dhe ne akoma nuk kemi jemi në standardet europiane. Jemi një vend tjetër. Kjo do të thotë se kur shkojmë nëpër drejtori, siç kemi qenë ne të Komisionit të Sigurisë, ka një fryrje, ndërkohë që komisaritet janë bosh, me trupa policie, me sektorë të ndryshëm e të gjitha me radhë. Të gjithë e dimë, të paktën ne që vijmë nga ai sektor, që inspektori i krimeve, inspektori i rendit, agjenti i krimeve të zonës e njeh situatën kriminale në çdo zonë dhe ka një lloj xhelozie, përplasjeje dhe mosbesimi midis sektorëve të drejtorisë së policisë me komisaritet e policisë, që janë evidente.

Unë mendoj se, mbase nuk është e realizueshme, por kjo duhet të ndodhë, sepse janë shumë komisariate me shumë pak forca policie, ndërkohë që kemi fryrje të drejtorisë së përgjithshme dhe të drejtorive të qarqeve.

Sidomos këto kohët e fundit, meqenëse unë kam punuar rreth 8 vjet në Policinë e Shtetit, është përdorur shumë gazi lotsjellës, më shumë se 20-30 vjet bashkë.

Pyetja është: kush do ta mbajë përgjegjësinë?

Dakord, gjeni arsyet tuaja ligjore se turmat po shkojnë për të pushtuar parlamentin apo qeverinë dhe se janë masa parandaluese. Po për banorët e Bregut të Lumit a ka ndonjë hetim? Se aty nuk pati turma. Mund të jenë edhe 300 veta. Nuk mund të përdorë një polici me 500 veta ndaj 300 vetave gazi lotsjellës, ndaj fëmijëve, nënave e me radhë apo edhe ndaj banorëve të Astirit.

A ka ndonjë hetim paraprak për këtë? A ka ndonjë ndëshkim të ndonjërit, që e ka dhënë këtë urdhër?

Kemi disa ankesa të Policisë së Shtetit për orët shtesë dhe lekët e ushqimeve. Ata thonë se kanë mbi 6 vjet që nuk i kanë marrë disa, ndërkohë që ka qenë me vendim. Si qëndron problemi? A do të ketë ndonjë dëmshpërblim apo nuk do të ketë?

Ju herë pas here përmendët këtu vetingun. Tani, edhe ju, si Ministër, i keni kaluar të gjitha etapat, sepse vini nga radhët...

Pavarësisht objektivit të qeverisë suaj, unë mendoj dhe e them me forcë të madhe argumentuese se vetingu në polici ka qenë jo vetëm një dështim, por edhe një *show* për t'i

mbajtur nga ana psikologjike policët, me 400-500 mijë lekë rrogë, ndërkohë që drejtorët, shefat e komisariatit, shefat e kufirit mund të kalonin...

Si mund të kalojë në veting një polic që ruan objektin, një polic i Shqiponjave, i grupit të gatshëm, i terrenit, i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, ndërkohë që është SHKB-ja ajo që, nëse ka lidhje me krimin, e menaxhon dhe e heton?!

Ndërkohë, kemi doganat, tatimorët, ata nëpër hipoteka, të korruptuarit, që nuk kalojnë në veting dhe kalon polici i shkretë.

Nuk ma heq dot njeri nga mendja që ky është thjesht një presion psikologjik, për t'i mbajtur... Ndërkohë që edhe ne si deputetë nuk kalojmë në veting.

Meqenëse jeni i pranishëm këtu (nuk ka ndonjë sekret këtu), nuk e dua me shifra, por të paktën për ta ditur opinionin, si është bashkëpunimi juaj me Shërbimin Informativ Shtetëror? Se me drejtësinë e morëm vesh, pak a shumë, edhe nga raporti.

A ju kanë dhënë juve (se të parët e di që kanë pasur informacione), si Ministër, informacione nga Shërbimi Informativ Shtetëror për drejtues të Policisë nëpër komisariate apo qarqe, që janë të lidhur me drogën, trafiket, krimin e organizuar?

A keni hetuar? I keni verifikuar? A i keni proceduar (jo me emra, se kjo mund të përbëjë edhe sekret hetimor për shkak të bashkëpunimit)?

Në raste të tilla si është bashkëpunimi me Shërbimin Informativ Shtetëror?

Mbaj mend që në '97-2005 ka qenë Partia Socialiste në pushtet dhe në atë kohë ka pasur bashkëpunim mes Ministrisë së Brendshme dhe SHIK-ut dhe ka pasur shumë ndëshkime nga Ministria e Brendshme në bazë të informacioneve. Nuk e di si është aktualisht.

Ju uroj suksese, pavarësisht këtyre pyetjeve dhe kësaj gjendjeje!

Unë mendoj se rendi në Shqipëri, ta dinë mirë shqiptarët, vendoset për një muaj, jo për 100 ditë, siç tha Kryeministri. Rendi nuk është vendosur. Ligji është i barabartë për të gjithë, por kjo ndodh në Europë, jo në Shqipëri.

Ligji në Shqipëri është vetëm për të varfrit, të cilët i kanë mbushur burgjet plot. Të pasurit dhe bosët e krimit të organizuar, pjesa më e madhe e tyre, janë në liri të plotë. Kjo nuk ndodh vetëm me qeverinë tuaj, por ka ndodhur edhe me qeveritë e mëparshme, por se si do të jetë vullneti politik, me masa shtrënguese që keni marrë ju si ministri apo me nismat ligjore, shpresojmë dhe besojmë që krimi të marrë një goditje vendimtare, në mënyrë që edhe vendi të zhvillohet, siguria të rritet e të gjitha me radhë...

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Maliqi!

Do ta ftoj zotin ministër të jetë eficient me përgjigjet, me sugjerimin që të mos i japim përgjigje çdo komenti, sepse në fund të ditës, komentet mbeten personale dhe nuk jemi këtu për t'i mbushur mendjen njëri-tjetrit, por që nëpërmjet fjalës sonë dhe fjalës suaj, të tretët, publiku, ai që është përfituesi ose jopërfituesi, në një rast tjetër, të kuptonte të vërtetën.

Po, zoti Braho, për procedurë.

Spartak Braho – Ndërhyrja juaj ma shtoi argumentin.

Ne sot jemi mbledhur për buxhetin. Ky është rendi i ditës. Edhe ju si drejtuese mos lejoni të bëjnë pyetje për Stamo Dumon.

Deputeti Lefteri është oficer i vjetër. Diskutoi për buxhetin. A është i kënaqur me këtë buxhet? Nuk është i kënaqur. Le ta mbyllim historinë e bashkëpunimet me SHIK-un.

Ermonela Felaj – Kjo ishte një pyetje që zoti Maliqi e bëri gjatë ditës së djeshme dhe, në njëfarë mënyre, ua bëri përfaqësuesve të SHISH-it. Ne e orientuam që në rastin kur do të kishim ministrin, mund ta ezauronim si pyetje. Kjo është, që të mos e bëjmë debat. Për hir të së vërtetës, kjo është arsyeja për të cilën unë nuk ndërhyrja, sepse e patëm thënë më herët.

Lefter Maliqi - Nuk është për debat. Duhet të më mirëkuptojë edhe ministri, edhe ju. Unë nuk flas për interesat e mia, as të opozitës, as nuk më intereson opozita. Unë flas për realitetin që prekim në bazë dhe buxheti ka të bëjë edhe me këto rezultate për vitin 2020 në luftën ndaj krimit, në mënyrë që të ketë një përmirësim të goditjes ndaj krimit e të gjitha me radhë.

Unë nuk thashë të më thoni emra konkretë, por dua të di a çalon apo jo bashkëpunimi i këtyre dy sektorëve tepër të rëndësishëm, SHISH-it dhe... Nuk ka ndonjë gjë. Unë kam qenë anëtar i Komisionit të Sigurisë edhe më parë dhe e kemi bërë këtë pyetje. Janë dhënë disa pakënaqësi, disa realitete. Kjo është.

Ermonela Felaj – Mirë. Nuk besoj se mund t'i marrim përgjigjet e pyetjeve tuaja. Ndërkohë të kalojmë edhe në pyetjet e kolegëve të tjerë.

Faleminderit!

Sandër Lleshaj – Gjithmonë e kam të vështirë të kundërshtoj zotin Maliqi, por më mirëkuptoni.

Nuk ndaj mendimin se nuk ka rend në Shqipëri. Në Shqipëri rendi është i vendosur. Nëse doni një indikator për këtë është numri jashtëzakonisht i lartë i të huajve, që vijnë të vizitojnë Shqipërinë. Ky është një argument që provon se Shqipëria është vend i sigurt, perceptohet si i tillë. Ka miliona njerëz që vijnë dhe shpenzojnë kohë e para në Shqipëri.

Bashkëpunimi me SHSH-in është në një ndër periudhat më të mira të bashkëpunimit me Policinë e Shtetit. Ka një situatë besimi reciprok ndërmjet dy institucioneve, që konkretizohet me një numër shumë të madh operacionesh të përbashkëta në të gjitha fushat.

Vetingu është një proces i nisur me kohë. Ju keni qenë vetë dëshmitar, zoti Maliqi, që ne kemi bërë një ndryshim të rëndësishëm në koncept, ku vendosëm që vetingun për një pjesë të madhe të policisë ta bëjë SHÇBA-ja dhe vetëm për pjesën drejtuese të saj të bëhet nga Komisioni i Jashtëm. Po ndodh kjo gjë.

Orët shtesë të policisë janë paguar të gjitha. Nuk kemi asnjë deficit sot me pagesën ndaj Policisë së Shtetit, si rrallëherë.

Pyetjen për gazin lotsjellës po e lidh në kontekstin buxhetor. Shpresoj se pyetjen e bërë në konceptin e buxhetit, jo në konceptin operacional, se për atë koncept nuk jap përgjigje, sepse është policia ajo që jep përgjigje për anën operacionale. Në konceptin e buxhetit duhet të them se nuk kemi pasur nevojë për ta blerë, pasi e kem gjetur të blerë. Është blerë me kohë dhe nuk ka qenë nevoja... Kjo është përgjigjja në aspektin buxhetor për gazin. Për sa i përket përdorimit është një çështje e vetë policisë. Nuk mund t'i urdhëroj apo t'i orientoj policët për ta përdorur. Mund t'ju them diçka: ndaj me ju mendimin që është përdorur më shumë gaz lotsjellës këto kohët e fundit, por nuk janë përdorur fare plumbat.

“A ka nevojë për rishikim struktura e Policisë së Shtetit?” Po, e ndaj plotësisht me ju shqetësimin. Ne duhet të bëjmë një rishikim. Ndërkohë, kemi në funksion një grup pune, i cili po e rishikon strukturën e policisë, që synon t'i shfuqizojë komisaritet, t'i kthejë ato në struktura të plota, që i kanë të gjitha kompetencat, të ulë numrin e drejtorive vendore dhe të ulë madhësinë e drejtorive vendore, të cilat do të jenë struktura administrimi dhe menaxhimi, ndërkohë që puna operacionale hetimore e të tjera do të zhvillohen në nivelin e komisariateve ose në nivelin qendror në njësitë e specializuara.

Policia Kriminale, a ka buxhet të dedikuar dhe shtesë për këtë vit? Po, Policia Kriminale është prioriteti kryesor i punës sonë dhe do të ketë mbështetje me buxhet shtesë, në drejtim të pajisjes me teknologji dhe pajisje të tjera moderne, të cilat shkojnë në favor të hetimeve me

metoda speciale. Edhe në ligjin që do të lançohet së shpejti do të shikoni masa konkrete të rëndësishme, të cilat sigurojnë që Policia Kriminale të njohë një epokë të madhe modernizimi, të cilën nuk e ka pasur më parë, në të gjitha aspektet.

Për sa i përket rikthimit të të larguarve nga policia, gjithashtu e ndaj me ju ..., e përmenda edhe në përgjigjen e zotit Qefalia,

Për shtimin e numrit të policive, ju thatë që nuk e ndani këtë, sepse po shpopullohet vendi, por, po e them edhe një herë, kjo është e provuar, mjafton të pjesëtoni numrin e punonjësve të policisë sonë, që është 11058, me numrin e përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë, ku mund t'i referoheni numrit 2,8 milionë banorë, i cili është numri i rezidentëve të matur nga INSTAT-i ose 4,5 milionë që është numri i shqiptarëve të regjistruar në gjendjen civile. Pra nëse e pjesëtojmë me 2,8 milionë, përsëri kemi një polici shumë të vogël, pra kemi gjysmën e policisë që ka Mali i Zi, Greqia, Italia dhe Kroacia, por, nëse e pjesëtojmë me 4,5 milionë shqiptarë që mbajnë pasaportë dhe kartë identiteti, atëherë shkojmë në nivele alarmante. Unë e them që kemi nevojë për ta shtuar policinë dhe kemi në plan ta shtojmë në mënyrë që të arrijmë ato standarde që kanë edhe vendet e tjera të Bashkimit Europian. Kjo është e shkruar dhe e miratuar në këtë parlament në strategjinë e policisë, ku është miratuar zhvillimi dhe rritja progresive e numrit të policisë.

E fundit, folët për një farë nënvlerësimi, në fakt këtë nuk mund ta pranoj. Ju jeni Komisioni i Sigurisë, por edhe ne jemi një ministri që ka një dinamikë mjaft komplekse. Dje nuk kisha mundësi të merrja pjesë, por këtu ishte zëvendësministri i cili ka atributet e plota.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji e lejon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal zoti Braho.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e shpjegoj këtë. Në fakt, ligji e njeh që zëvendësministri e përfaqëson ministrin me attribute të plota...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe atë e di.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vjen mirë, sepse sot më ka marrë im atë, i cili është 80 e ca vjeç, në mëngjes dhe më tha: “Çfarë ke bërë që ke bashkuar bashkë opozitën dhe maxhorancën”, sepse ishte një artikull ku shkruhej “Bashkohet bashkë opozita dhe maxhoranca kundër ministrit Lleshaj”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë ju kërkoja ndjesë për dje, sepse nuk kisha mundësi të vija për arsye objektive dhe sot kam ardhur i përforcuar. Pra, nuk është çështje nënvlerësimi, sepse nuk do të kishim këtë paraqitje që kemi sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht të rinj jemi

Lefter Maliqi – Nuk dua të bëj debat...

Ermonela Felaj – Po ti po merr mikrofonin. Të lutem një fjali që t’ua kalojmë fjalën kolegëve.

Lefter Maliqi – E para, dua t’i sqaroj të gjithë që unë nuk përfaqësoj opozitën. Unë jam deputet i pavarur dhe jam krenar për këtë, nuk e di se çfarë do të ndodhë gjatë rrugës.

Ermonela Felaj – Jo, jeni në opozitë me ne, nuk ka rëndësi kë përfaqësoni.

Lefter Maliqi – Më fal, unë e vlerësoj zotin Lleshaj për përgjigjet që dha dhe shpresoj që viti 2020 të jetë edhe më i mirë për rendin dhe sigurinë. Që ka probleme me rendin dhe sigurinë në vend, këtë e di çdo shqiptar që na dëgjon, por sigurisht që ka edhe përmirësime të punës.

Për gazin lotsjellës, unë e di shumë mirë që është detyrë operacionale e policisë, por edhe unë kam qenë drejtues policie dhe pa urdhër nuk veproja, çoftë drejtori i përgjithshëm apo kushdo. Prandaj unë e quaj shkelje përdorimin e tij për banorët e Astirit dhe Bregut të Lumit, të paktën si specialist dhe pedagog në Akademinë e Rendit.

Kurse në lidhje me shpopullimin e popullsisë nëpër sondazhet apo zyrat pranë institucioneve tuaja të qeverisë, e dimë shumë mirë dhe e prekim në bazë, si në Berat nga jam unë, por edhe në qytetet e tjera me radhë, pavarësisht se janë të regjistruar në gjendjet civile, apo në këto institucione, e vërteta është që jemi mbi 2 milionë banorë faktikisht, sepse kanë ikur.

Mua më vjen keq, zoti Ministër, por unë këmbëngul për rritjen e pagës së policëve të thjeshtë, që janë në terren, që rrinë në shi ditë e natë, përballen me vështirësi, përplasen dhe me turmat, qofshin të opozitës, apo ato të tjerat. Unë jam për disa kushte maksimale për Policinë e Shtetit, sepse ata e meritojnë me shumë se kushdo tjetër.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Sa më shumë aq më mirë për të gjithë.

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Unë dua të diskutoj thjesht për buxhetin me idenë që ky komision ka tagrin t'i ndryshojë gjërat, në kuptimin e përmirësimit të tyre.

Zoti Ministër, ju folët me optimizëm dhe natyrisht që optimizmi është i ligjësuar për shkak të rezultateve në drejtimin e Ministrisë të Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, por a e dini që buxheti i Ministrisë së Brendshme është 1 milion euro më pak se vitin që kaloi?

Nga 6 zëra, 4 janë me ulje. A kemi mundësi ne, zonja kryetare, që t'i korrigjojmë këto shifra? Si ka mundësi që Policia e Shtetit merr me pak, kurse planifikimi i menaxhimit merr gati 1 milion euro më pak, shërbimi i gjendjes civile merr më pak? Këtu nuk dëgjuam të na paraqitej ky realitet. Pse këto shifra janë me të ulëta? Unë po i krahasoj me tabelat që kemi para, nëse janë të sakta është kështu si them unë, por nëse nuk janë, atëherë nuk është defekti të unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra fondi faktik.

Ermonela Felaj – Ne e kemi edhe përfaqësuesin teknik të Ministrisë të Brendshme, kështu që po qe nevoja do të na japë këtë shpjegim, që ndoshta nuk e sigurojmë dot.

Spartak Braho – Ishallah e kam unë gabim, por e krahasoj me këto qitapët e mëdha dhe është e njëjta situatë. Pra, nuk kemi rritje, por zvogëlim të buxhetit të Ministrisë së Brendshme.

Zoti Ministër, sa është shuma e parashikuar në buxhet për objektin e laboratorit të Policisë Shkencore? Ju keni një vlerësim shumë pozitiv dhe mua më bëhet qejfi që thelbi i veprimtarisë zbuluese të krimit është laborator i Policisë Shkencore. Hetimi atje ka mbaruar, se po të mbërtheu Policia Shkencore me aktet e saj nuk ke ku shkon, kështu që ky laborator duhet të jetë pjesë e rëndësishme e modernizimit të veprimtarisë zbuluese, se nuk e gjej këtu. Ju thatë që do të jetë një investim i përbashkët i shtetit shqiptar me një partner strategjik, pra shteti do të ndërtojë objektin. Sa është parashikuar, se nuk e gjejmë këtu?

Pyetja e dytë. A është parashikuar rritje pagash për 11 mijë policë dhe oficerë e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit? A është parashikuar ritrajtim, apo përmirësim i trajtimit financiar të tyre? Në drejtoritë e policisë së Elbasanit dhe Durrësit, gati 20-25% e efektivave nuk banojnë në Durrës, vijnë nga të gjitha rrethet, kryesisht nga Tirana, dhe shpenzimet e tyre jashtë familjare shkojnë 50-60% e pagës. Me çfarë jetojnë këta njerëz? Nëse 50-60% të pagës u shkon rrugë, ushqim, me çfarë jetojnë? Bashkë kemi biseduar një herë, madje

kam bërë edhe një propozim konkret që të ngrini mensa nëpër drejtoritë e policive, që oficeri i policisë të hajë brenda atij organizimi më lirë dhe më komod, se sa të shkojë nëpër restorante, ku është shtrenjtë, por edhe të shmangin kontaktet me elementin që duhet ta takojë.

Kështu që e kam këtë merak për t'i rregulluar këto gjëra, por sido që të jetë do t'i votoj. I thashë Ermonelës a kemi mundësi t'i ndryshojmë, t'i rrisim ose të paktën t'i barazojmë se nuk mund të diskutojmë që Ministria e Brendshme është me 1 milion euro më pak. Është qesharake.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Braho!

Po, zoti Lleshaj

Sander Lleshaj - Faleminderit, zoti Braho!

Ju keni të drejtë në shifra, por edhe unë, sepse u referohemi shifrave të ndryshme. Ne kemi rritje krahasuar me buxhetin e planifikuar të Ministrisë së Brendshme për vitin 2019, por ky buxhet është rritur në mes të vitit me një shifër tjetër, prandaj del kjo diferenca. Nëse ne e krahasojmë me buxhetin e planifikuar, pra me buxhetin e miratuar nga parlamenti në muajin dhjetor, ne kemi një rritje 1,4%, por në mes të vitit, me aktin normativ për rishikimin e buxhetit, buxheti është shtuar dhe doli kjo diferenca.

Ne presim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di, por nëse është shifra jonë...

Ermonela Felaj – Mund t'ju sqaroj unë për shifrën. Shifra dhe tabela që ka përpara zoti Braho është punuar nga këshilltarët e komisionit, nuk kanë bërë gjë tjetër veç se kanë marrë shifrën e dhënë në projektbuxhetin e 2019-s plus shifrën e sjellë në buxhetin e ri dhe kanë bërë diferencën për secilën nga këto pjesë, pra planifikim, menaxhim dhe administrim, Policia e Shtetit, garda, pushtete të deleguara dhe shërbimi i gjendjes civile.

Sander Lleshaj – Është e sigurt që rishikimi i buxhetit do të bëhet si zakonisht nga mesi i vitit. Ne presim të kemi një prapë një rritje tjetër, madje më të konsiderueshme se ajo e vitit të shkoi.

Sa ka Instituti i Policisë Shkencore?

Bëhet fjalë për një shifër të konsiderueshme, e cila përbëhet nga dy elemente: elementi i infrastrukturës, pra godina, dhe elementi pajisje. Sivjet janë parashikuar 103 milionë lekë për këtë vit, por nuk e mbyll dot. Aty mund të shkojë 3-4 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të bëhet godinë e re e Institutit të Policisë Shkencore, ndërkohë që pajisjet do të vijnë nga pala tjetër. Totalisht, si program shkon gati 10 milionë dollarë, pra bëhet fjalë për diçka shumë serioze, por ne do të kemi rreth 30% të tij, besoj kaq do të jetë detyrimi që ka pala jonë për të paguar.

A është parashikuar rritje pagash?

Nuk është parashikuar në këtë buxhet që keni para, sepse nuk është parashikuar për asnjë institucion dhe përgjithësisht këto rritjet e pagave janë bërë gjysmën e dytë të vitit, se kështu është krijuar kjo traditë dhe ne shpresojmë që në gjysmën e dytë të vitit të kemi mundësi të bëjmë një përmirësim të pagave të punonjësve të policisë. A duhen shtuar? Patjetër.

Para disa ditësh isha në një takim të ministrave të brendshëm të Ballkanit, ku ishte i pranishëm edhe ministri i Brendshëm i Kosovës, po bisedonim për pagat e tyre se ata kanë një buxhet interesant dhe më tha që roja i tij merrte 900 euro, ai i kishte thënë “Kaq marr dhe unë”, se kaq i bie përafërsisht. Dua të them që ka nevojë për përmirësim. Ne shpresojmë që nga gjysma e dytë e vitit të kemi mundësi të ndërhyjmë në trajtimin e punonjësit të policisë. Një masë që është parashikuar deri tani ka të bëjë me faktin që ne do të përpiqemi të krijojmë mundësinë që një pjesë e punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët për arsye moshe, apo fizike, kanë vështirësi në kryerjen e detyrës, të mund të largohen nga Policia e Shtetit, pa pasur penallti financiare, në kuptimin që do të largohen dhe do të marrin trajtim të veçantë, afërsisht të barabartë me trajtimin që merrnin kur ishin në punë. Kjo do të na japë mundësinë të fusim elementë të rinj që të rinovojmë trupën e Policisë së Shtetit dhe ky është një investim që shkon në favor të Policisë së Shtetit dhe nuk është pak.

Sa u takon oficerëve që shërbejnë jashtë vendbanimit të tyre të përhershëm, është një problem i vjetër sa vetë policia. Kemi ndërmend të bëjmë propozime, se këtu vetëm propozime kemi, do të vijmë këtu t’ju kërkojmë para, për të parë mundësinë e përmirësimit të trajtimit të atyre që janë jashtë vendbanimit. Në synojmë përditë e më shumë që oficerët të mos shërbejnë në vendbanimin e tyre, me qëllim që të mos kenë familjaritetin dhe riskun e përballjes me ata 1 milion kushërinj që ka secili në vendin ku lind dhe rritet. Kjo është një punë që nëse doni ta konsideroni mangësi tonën konsiderojeni, pasi vërtet çështja e trajtimit të përshtatshëm të punonjësve, që janë jashtë vendbanimit të tyre është ende e pazgjidhur. Pjesa më e madhe e tyre, edhe drejtorë policie, flenë në zyrat e tyre. Kur them për drejtorë qarku e kam fjalën për drejtues

të lartë. Ky është një problem që duhet ta marrim në konsideratë për të parë se çfarë mund të bëhet, pasi e gjitha kushton para, por ne do të bëjmë përpjekje për një lëvizje në këtë drejtim.

Vërejtja juaj është me vend dhe ju falënderoj që e bëni publikisht!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Unë e gjej me shumë vend sugjerimin e fundit të zotit Braho në lidhje me çështjen e dietës ushqimore që marrin disa punonjës të Policisë së Shtetit. Mund të ndiqni fare mirë shembullin që ka Ministria e Mbrojtjes, që ju e njihni, në njësi të veçanta, si Garda e Republikës, sa janë personat në lëvizje, Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë, RENE. Ky trajtim mund të ndiqej, megjithatë ju i dini më mirë ku i keni hallet tuaja se sa i perceptojmë ne, por nëse jepet një dritë jeshilë në këtë drejtim, kjo do të rriste frymën pozitive në radhët e këtyre forcave. Ne e kemi konstatuar këtë gjë në biseda, nuk ka qenë tema kryesore e diskutimit, por është një gjë që na është thënë. Trajtimi më i mirë e bën forcën më të qëndrueshme në detyrat e tyre dhe më të sigurt që të vijojnë punën aty.

Do t'ia kaloj fjalën zotit Xhindi, duke ju lutur të bëni pyetje pa rënë në përsëritje për ato çështje që nuk janë trajtuar ende, duke pasur parasysh që kemi që në orën 10:30 që kemi filluar.

Anduel Xhindi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë do të bëj shkurtimisht dy pyetje.

Së pari, duke parë shtimin e ndjeshëm të aksidenteve rrugore me pasojë, doja të pyesja nëse SHQBA-ja, që është në varësi të Ministrisë së Brendshme, i ka apo jo në monitorim dhe a po ushtron kontroll për mënyrën si funksionojnë shërbimet e qarkullimit rrugor?

Për sa i përket Gardës së Republikës, ndër vite është diskutuar rritja e pagave dhe ende sot e kësaj dite nuk ka asgjë konkrete. A nuk mendoni se për të pasur një standard të ri dhe për të bërë një unifikim mes pagës së punonjësit të Gardës së Republikës, punonjësit të Policisë së Shtetit dhe SHQBA-së? Jam dakord që të blihen automjete të reja, por mendoj se automjetet duhet të unifikohen si në vendet e tjera të botës dhe jo siç është këtu që disa mjete janë Chevrolet, disa Volkswagen, ca Hyundai, pasi mendoj se do të ishte më serioze.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Të marrim edhe një pyetje tjetër dhe vijojmë me përgjigjet, se do të ishte më mirë edhe për ju!

Fjalën ka zonja Dhima, pastaj zoti Duzha.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër për prezantimin, si dhe për punën dhe angazhimin tuaj për drejtimin e ministrisë, njëkohësisht dhe stafit të Policisë së Shtetit!

Prioritetet e ministrisë që drejtoni janë sigurimi i rendit publik, i pronës publike dhe private, rrugore dhe krijimi i një mjedisi të sigurt për komunitetin. Të gjitha këto do të arrihen nëpërmjet profesionistëve dhe njerëzve të përkushtuar dhe të motivuar.

A keni planifikuar fonde për rritjen profesionale të personelit tuaj dhe për pagesën jashtë orarit?

Si paraqitet realizimi i pritshëm i buxhetit për vitin 2019, kur edhe një muaj mbyllet buxheti për vitin 2019? siç parashikohet ky realizim i pritshëm në zërin “investime” dhe a do të ngelen investime, të cilat janë planifikuar, por mund të mos realizohen në fund të vitit 2019? Në vijim të fjalës suaj për buxhetin e vitit 2020 ju thatë që keni planifikuar investime nga burime të brendshme dhe të huaja dhe për burimet e brendshme ju renditët disa ndërhyrje dhe investime konkrete, që do të kryhen në vitin 2020.

Pjesa e investimeve nga burime të huaja ku do të kryhen? Në fjalën tuaj dëgjova që investimet do të shkojnë kryesisht në Drejtorinë e Policisë së Shkodrës, por a keni parashikuar investime në komisariate të ndryshme të drejtorive të policive, pasi ka komisariate, që nuk kanë as kushtet më minimale të mjediseve për të ushtruar detyrat e tyre?

Nga vizita që ne, si Komision i Sigurisë, kemi bërë në disa drejtori policie, ka dalë një shqetësim nga disa prej tyre në lidhje me kilometrat e përshkuara nga makina që kanë nën administrimin e drejtorive të policive, ose me kontratë. A keni dijeni që ka një kufizim të kilometrave për këto makina dhe a keni parashikuar rritje, sepse mund të ndodhë që makina është në një mision, ose është duke kryer detyrën dhe plotëson kilometrat? A do ta vazhdojë detyrën që i është dhënë këtij stafi, i cili ka dalë në mision? Ju thatë se buxheti për vitin 2020, pavarësisht debateve, sepse dihet që ka një buxhet fillestar, buxheti me të gjitha ndryshimet, parashikohet të rritet me 1,6% krahasuar me realizimin e pritshëm të vitit 2019. A mendoni se kjo rritje e buxhetit nga ana juaj është adresuar për zgjidhjen atyre problemeve më imediate dhe më kryesore? Njëkohësisht, në fjalën tuaj ju thatë se keni bërë ndryshime në strukturë për disa pozicione, të cilat kanë qenë në administrimin e Ministrisë së Brendshme, por që tashmë kanë kaluar në administrim të ministrive të tjera. Këto fonde për këto funksione, pavarësisht se buxheti i vitit 2019 është duke u realizuar dhe deri në datën 31 dhjetor duhet të paguhet nga ana juaj, unë mendoj se duhet të jenë të parashikuara se ku do të shkojnë edhe për vitin 2020. Ku

janë adresuar këto fonde? A janë adresuar te shtesa e personelit, pasi ju keni menduar se do të shtohet në disa struktura që janë pjesë përbërëse e ministrisë suaj?

Ermonela Felaj - Meqenëse janë bërë disa pyetje, mendoj se është më mirë që të marrim përgjigjet e tyre. Ju, zonja Dhima, erdhët me vonesë, sepse ministri e tha që e kanë realizuar planin në masën 91% dhe deri në fund të vitit do ta plotësojnë pothuajse tërësisht. Në fakt, kjo është një gjë shumë e mirë, sepse kanë arritur të marrin të gjitha paratë publike. Ndaj, më mirë le të marrim përgjigjet e pyetjeve dhe më pas fjalën do t'ia kaloj zotit Luan.

Sandër Lleshaj – Atëherë, për sa i përket pyetjes për arsimimin e personelit, sigurisht, zonja Dhima, ne kemi parashikuar angazhime të rëndësishme buxhetore për personelin në tërësi. Siç e thashë, sot kemi një rekord historik për sa i përket numrit të studentëve dhe kursantëve në Akademinë e Sigurisë. Ne nuk kemi pasur asnjëherë një numër të lartë të tyre, ndërkohë që në këtë shkollë sot kemi rreth 900 veta. Përveç kësaj, ne tashmë po bëjmë hapa strukturorë për të krijuar edhe një drejtori që do të merret me kualifikimin dhe me trajnimin në Policinë e Shtetit. Trajnimi dhe kualifikimi i këtyre studentëve nuk është shndërruar deri më sot në një proces të vazhdueshëm dhe të pandërprerë. Madje, vetë Ministria e Brendshme ka një program, ku i gjithë stafi një orë në ditë për çdo ditë i nënshtrohet një programi trajnimi, ku janë të angazhuar të gjitha burimet e brendshme.

Për sa i përket buxhetit, ne presim që ta realizojmë plotësisht deri në fund të këtij viti. Investimet e huaja janë adresuar kryesisht tek Instituti i Policisë Shkencore dhe te policimi i komunitetit, ku kemi një projekt me qeverinë suedeze, me të cilën do të bëjmë përmirësimin e kushteve në komisariate lidhur me pritjen e qytetarëve, me trajtimin e fëmijëve, si dhe me trajtimin e grave. Pra, pjesa më e madhe e investimeve do të shkojnë në drejtim të automjeteve. Pra, ne kemi projekte të mëdha dhe të rëndësishme për automjetet.

Një tjetër projekt po aq i rëndësishëm që do të bëhet bashkë me donatorët e huaj ka të bëjë me Policinë Kufitare, ku do të bëhen blerje të rëndësishme teknike, mjete moderne, të cilat do t'i shërbejnë monitorimit të kufijve me radarë dhe kamera termike, automjetet përkatëse, si dhe do të monitorojmë kufirin e gjelbër dhe kufirin blu. Pra, këtu do të shkojnë disa prej investimeve kryesore dhe më pas do të kemi edhe projekt tjetër, i cili do të financohet nga BE-ja për arsimimin e policisë. Ky është një projekt binjakëzimi i Akademisë së Policisë me një konsorcium akademish europiane, i cili do të sjellë disa milionë euro në Akademinë e Sigurisë. Pra, pak a shumë, këtu janë të përqendruara projektet kryesore. Po kështu, kemi edhe projekte të

tjera që janë në favor të pushtetit vendor, të cilat do të zhvillohen nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, si “Bashkitë e forta”, por edhe projekte të tjera që do të kalojnë nëpërmjet Ministrisë së Brendshme.

Përgjithësisht të gjitha komisaritet janë në gjendje të keqe, janë institucione të harruara në morinë e institucioneve të vendit. Ne kemi investuar shumë për të bërë burgje të reja, por jo komisariate të reja. Ndaj, tani kemi ndërmend të merremi me komisaritet, ku qeveria dhe Kryeministri kanë premtuar publikisht, ku janë angazhuar dhe ka filluar programi për komisaritet. Tani ne jemi në përfundim të disa projekteve tip, sepse nuk do të ndërtojmë çdo komisariat ndryshe nga tjetri, por do të bëjmë 3 tipe komisariatesh. Për shembull, në qoftë se themi “Tipi 1”, këto komisariate do të ndërtohet në Maliq, në Mirditë, në Mat, në Leskovik, në Delvinë; nëse themi “Tipi 2”, ato do të ndërtohen në Librazhd, në Pogradec e kështu me radhë. Pra, ne do të fillojmë punën për implementimin e këtij programi, ku do të bëjmë më shumë komisariate, por më të vogla, në mënyrë që të jemi sa më afër njerëzve. Këtë gjë e lidh me atë që tha zoti Maliqi, që do t’i zvogëlojmë drejtoritë vendore qoftë në madhësi, qoftë në numër, dhe do të fuqizojmë dukshëm komisaritet.

Një pyetje tjetër ishte nëse mbetej makina në rrugë. Kjo është një rregullim kontraktor, sepse ju e dini që një pjesë e madhe e makinave që ka sot Policia e Shtetit janë marrë nëpërmjet një *leasing*-u operacional, ku për çdo makinë është parashikuar kilometrazhi. Kjo nuk do të thotë se makina nuk punon nëse i mbaron kilometrazhi i dhënë, por, në qoftë se makina X do të bëjë 2 mijë kilometra në një muaj, ajo mund të bëjë edhe 4 mijë në një muaj, por i bie që muajin tjetër duhet ta kompensojë, pra duhet të qëndrojë pushim. Kjo gjë ndodh, pasi ne kemi blerë kilometrat për çdo makinë policie dhe jo makinën, por kjo nuk e pengon aspak operacionalitetin. Pra, mos e kuptoni kështu që një makinë i ka plotësuar 2 mijë kilometrat dhe nuk lejohet të bëjë më shumë, sepse ajo mund të bëjë edhe 10 mijë kilometra brenda një muaji, por për pesë muajt e ardhshëm ajo duhet të pushojë dhe të punohet me një makinë tjetër.

Ermonela Felaj - Për këtë duhen sqaruar drejtoritë e policisë se e kanë kuptuar gabim, sepse ata kështu na kanë thënë.

Sandër Lleshaj - Varet se kë keni pasur partner, por, pak a shumë, kjo është ideja, që një makinë policie mund të bëjë edhe 10 kilometra në muaj dhe më pas deri në fund të vitit duhet të qëndrojë pushim, sepse e ka përfunduar limitin e saj dhe kështu do të përdoret një makinë tjetër.

A shkon rritja e buxhetit në adresën e duhur? Unë besoj se po. Pra, për mendimin tonë, rritja e buxhetit që kemi parashikuar shkon në adresën e duhur. Pak a shumë ju përmendët prioritetet ku drejtohet ajo shtesë, e cila sigurisht është ajo që është.

Lidhur me pyetjen e zotit Xhindi nëse bën apo jo kontrolle në rrugë SHÇBA-ja, unë jam i qartë se ne kemi ende mangësi në funksionimin normal të policisë rrugore dhe se ende kemi policë, të cilët nuk e bëjnë detyrën ashtu siç duhet ta bëjnë. A ka bërë SHÇBA-ja kontrolle? Po, ka bërë kontrolle të shumta, madje po lexoja edhe një ankesë, e cila më kishte ardhur nëpërmjet jush, ku ankohej se SHÇBA-ja bënte kontrolle të paautorizuara, duke u kontrolluar xhepat policëve të kufirit dhe policëve rrugorë, të cilëve u kanë gjetur edhe euro. Edhe mua, që jam ministër, nëse do të më kontrolloni sot nëpër xhepa nuk do të gjeni euro, por policëve atje në rrugë u kanë gjetur euro. Gjithashtu, këtë vit janë marrë shumë masa, ku janë arrestuar rreth 50 punonjës policie dhe disa qindra të tjerë, kryesisht në fushën e qarkullimit rrugor dhe atë kufitar, janë në procedim penal për këtë gjë. Qarkullimi rrugor dhe kufitar janë dy pikat e dobëta ku ne kemi ende probleme me integritetin e punonjësve të caktuar që shërbejnë atje. Ne kemi marrë masa dhe do të vazhdojmë t'i thellojmë ato qoftë në drejtim të kontrollit, qoftë në drejtim të largimit nga shërbimi të atyre punonjësve që e përfaqësojnë keq uniformën e Policisë së Shtetit në rrugë apo në kufij. Këto dy pika janë “kartëvizita” e shtetit shqiptar, ku jo rrallëherë paraqiten aspak dinjitoze. Ndaj ne do të marrim masa të forta dhe kemi filluar në Tiranë me një ndërhyrje të thellë në fushën e rinovimit të trupës së Policisë Rrugore dhe do të vazhdojmë në të gjithë vendin. Gjithashtu, ne do të ulim edhe moshën e këtyre trupave, ku në shërbim do të vendosim djem dhe vajza të reja, të cilët do të kontrollohen dhe do të mbajmë një sistem të rreptë mbikëqyrjeje. Këtë e them për ju, por edhe për punonjësit e policisë nëse na dëgjojnë, ndaj unë e vlerësoj shqetësimin tuaj dhe jemi të ndërgjegjshëm që duhet bërë më shumë. Unë thashë se janë bërë disa qindra procedime penale dhe disa dhjetëra arrestime, por, fatkeqësisht, duhet që të vazhdojmë më tej.

Për sa u përket pagave të punonjësve të Gardës së Republikës, mund të them se ne kemi kërkuar rritjen e tyre dhe shpresojmë që në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm të bëjmë një përmirësim të pagave për Gardën dhe për policinë, të cilët patjetër që meritojnë një trajtim dinjitoz dhe më të mirë.

Për sa i përket unifikimit të flotës së automjeteve të policisë, është plotësisht me vend shqetësimi juaj. Sigurisht, ne kemi një problem të madh me thelbin e prokurimit për Policinë e

Shtetit, pasi ende operojmë me një ligj të prokurimit publik, i cili na çon në diversifikimin e flotës dhe, detyrimisht, në rritje të kostos. Në fakt, duke kërkuar ofertat më të ulëta, ne kemi blerë 20 tipe automjesh, sepse kostoja e flotës heterogjene është më e lartë se, po të kishim shkuar drejtpërdrejt te një ofertues, siç bëjnë shumë polici nëpër botë, siç bën Kosova, e cila shkon dhe i merr direkt te fabrika e Volsvagenit, shumë polici të tjera në botë i kanë të përcaktuara dhe nuk e ndjekin këtë procedurë të prokurimit publik, tashmë ne na ka çuar në një mori automjesh, të cilat më pas nuk menaxhohen. Unë kaq kisha për këto dy grupe të pyetjeve.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Duzha dhe më pas zoti Vorpsi.

Luan Duzha - Faleminderit, zoti Ministër, për të gjithë paraqitjen!

Më vjen mirë që dëgjoj se ka një projekt për ndërhyrjen në komisariate, sepse është hera e parë që ka një plan apo projekt. Ne kemi vizituar dhe kemi parë që shumë prej komisariateve lënë shumë për të dëshiruar, me kushte jo të papërshtatshme për punuar punonjësit e policisë. Për sa i përket pajisjes me automjete, sidomos për komisaritet periferike, siç është, për shembull, komisarati i Gramshit, që ka një shtrirje shumë të gjerë në fshatra, pajisja me automjete lë shumë për të dëshiruar dhe pengon plotësimin dhe organizimin e detyrave që ata kanë, sepse janë shumë dobët për sa i përket pajisjeve që kanë.

Së dyti, të gjithë jemi dëshmitarë që punonjësit e policisë punojnë me orare të zgjatura dhe orar pa orar. Gjithmonë, kur këtu miratojmë buxhetet, më duket sikur anashkalohet dhe lihet në harresë për sa i përket rritjes së fondit për orët shtesë që punojnë punonjësit e policisë. A është parashikuar ndonjë fond për këtë vit?

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Sandër Lleshaj - Faleminderit, zoti Duzha!

Siç e thashë, për sa i përket komisariateve, është absolutisht e drejtë dhe i ka kaluar koha kësaj pune, ndaj duhet të merremi me të. Për sa i përket automjeteve, unë e thashë që vitin e shkuar kemi bërë një investim të madh, kurse tani presim një kontingjent të madh, madje një pjesë e fuoristradave kanë ardhur. Pra, është një kontingjent i madh me rreth 50 fuoristrada, tashmë kanë mbërritur dhe rreth 150 mikrobusë që do të vihen në funksion të policisë. Kështu, do të bëhet një flotë shumë e madhe me makina të reja, të cilat deri në fund të muajit janar do të jenë në dispozicion të plotë. Përveç këtyre që thashë, presim edhe kontingjente të tjera automjesh nga Gjermania dhe nga vende të tjera, gjë që do të bëjë që flota e automjeteve të

policisë të jetë në gjendjen më të mirë që ka pasur ndonjëherë në historinë e saj, por ende nuk jemi atje ku duam të jemi, por, krahasuar me historinë, do të jemi më mirë. Pra, do të kemi të paktën rreth 400 automjete të reja në flotën e policisë së shtetit. A duhen më shumë? Patjetër që duhen më shumë, por të paktën le të jetë ky një lajm pozitiv.

Për sa u përket orëve shtesë, është e vërtetë ajo që policia është super e ngarkuar, pasi është shumë e vogël. Kjo është arsyeja pse ka një ngarkesë kaq të madhe, sepse është shumë e vogël dhe ka problematika të mëdha. Ne nuk jemi një vend vetëm me problematika të vogla, por kemi edhe problematika të mëdha. Çfarë do të bëjmë lidhur me këtë çështje? A do të vazhdojmë t'i paguajmë orët shtesë, t'i strapacojmë policët dhe më pas t'u japim pagë për orët shtesë, apo do të rrisim numrin e punonjësve dhe të mos bëjmë orë shtesë? Në fakt, ne po ndjekim këtë të dytën, duam të shtojmë numrin e punonjësve dhe policët të bëjnë orët normale të punës dhe të bëjnë jetën e tyre normale.

Sivjet ne do të kemi një numër shtesë dhe kjo do të vazhdojë të jetë tendencë, sepse na rezulton që vetëm për orët shtesë ne paguajmë mesatarisht në vit 700 vende pune, njësoj sikur të kishim 700 njerëz në punë gjatë gjithë vitit. Atëherë përse t'i paguajmë me shtesë, ndërkohë që mund t'i marrim në punë dhe i paguajmë me pagë fikse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, këtë do të ndjekim. Kjo është arsyeja përse kemi parashikuar një shtesë me 500 veta për vitin që vjen, pra që ta adresojmë këtë punë, dhe 100 veta i kemi shtuar këtë vit. Por ne duhet që ta shtojmë edhe më shumë, sepse nuk mjafton as kjo shtesë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit edhe ju!

Po, zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Ministër, ju falënderoj për atë që parashtruat në lidhje me buxhetin e vitit 2020, sepse tregon vullnetin e qeverisë për të luftuar krimin e organizuar dhe për të garantuar sigurinë publike.

Unë do të ndalem në dy pyetje specifike, edhe si sekretar i nënkomisionit për vetingun në polici. Dëgjova me vëmendje planifikimin që keni bërë në lidhje me rekrutimin e 31 punonjësve

të SHÇBA-së, të cilin do e ndihmojë edhe procesi i vetingut, por pyetja ime është: kjo shtesë prej 31 punonjësish a mundet që brenda afatit t’i bëjë vetingun një organizate me 11 mijë anëtarë?

Pyetja e dytë ka lidhje me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit. Unë kam marrë pjesë në një shorte të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, ndërkohë që këtu ka qenë një raport i kryetares Nakapaj për të gjithë problematikat që janë ndeshur gjatë këtij procesi. Pra përveç problemeve që ka pasur për shkak të përgjigjeve të institucioneve të treta, një nga problemet e kësaj trupe janë kushtet skandaloze, që i vërtetova edhe unë si anëtar i këtij komisioni, logjistika dhe numri i punonjësve që është zero. Përveç 30 anëtarëve, të cilët janë aty në bazë të procesit të përzgjedhjes, aty nuk ka një trup ndihmëse. Pra, ata sot janë kthyer në këshilltarë ekonomikë, juridikë dhe në sekretarë, ndërkohë që ka disa afate që përcakton ligji, të cilat duhen respektuar. Këtu ju bëj thirrje edhe ju si ministër i linjës, por edhe Ministrisë së Financës që ta mbështetni me buxhet këtë trupë, ndryshe besoj se afati i përcaktuar në ligj nuk do të përmbushet për shkak të këtyre arsyeve që thashë. E them këtë me bindje të plotë, sepse një nga arsyet që ne reduktuam vetingun e policisë, duke e ndarë zinxhirin drejtues me pjesën tjetër të nivelit bazë ishte edhe arsyeja financiare, nëse nuk gabohem, prandaj kërkoj vëmendjen tuaj.

Përfundimisht dua edhe t’ju falënderoj, sepse në momentin që përmendët prefekturat, shumica e kolegëve deputetë kthyen kokat nga unë. Kur bëhet fjalë për Prefekturën e Tiranës, pra për vazhdimin e financimit të restaurimit, ku edhe Viktori ka meritat e tij këtu, unë ju falënderoj, si ish-titullar i këtij institucioni.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vorpsi!

Pyetja është me shumë interes, sepse pjesë e punës së këtij komisioni është edhe puna që bën Komisioni për Monitorimin e Vetëingut.

Sot Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit na ka dërguar një shkresë, të cilën jua ka drejtuar edhe juve, meqenëse është rasti i diskutimit të buxhetit, për të gjitha problemet që citoi zoti Vorpsi, ku kërkon edhe mundësinë e shtimit të personelit me 15 punonjës, nga të cilët 5 janë këshilltarë ekonomikë, 5 këshilltarë ligjorë dhe 5 punonjës si staf mbështetës administrativ. Unë nuk e di nëse këta 15 punonjës që plotësohen krijojnë mundësinë për kryerjen e punës në afatin 1 vjeçar, që u kemi vënë, pra deri në qershorin e vitit që vjen. Pra për faktin që ne u kemi dhënë një afat do të ishte mirë që kjo kërkesë të mbahej parasysh. Nuk e di deri në cilën masë ju mund ta kini parasysh, por na e thoni. Nëse kjo do të vijë si një kërkesë shtesë nga ana e Ministrisë së Brendshme për Ministrinë e Financave, patjetër që do ta bëjmë pjesë e raportit tonë.

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Vorpsi, më vjen mirë që e shikoni që prefektura po merr trajtën që ju keni dashur dhe Rruga e Kavajës tashmë do të ketë një objekt dinjitoz.

Për sa i përket vetingut, ky është një ndër proceset më delikate që po zhvillohet sot dhe ne jemi koshientë për përgjegjësinë që kemi për ta mbështetur si proces. Është i ditur fakti që ne nuk kemi asnjë rol dhe nuk përfshihemi fare në përmbajtjen e punës së komisionit, por kemi si detyrë që ta mbështesim nga jashtë, me logjistikë dhe gjëra të tjera, dhe kemi bërë aq sa kemi mundur. Ju e përshkruat me nota skandaloze gjendjen aty. Ndoshta nga Kuvendi duken kushte të tilla, por këto janë kushtet që mund të ofrojmë ne. Po të shikoni se si jetojnë efektivët e Policisë së Shtetit në komisariate, si Librazhd apo në Pukë, atëherë fjala “skandaloze” nuk do t’ju mjaftojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë më mirë këta. Megjithatë, ne kemi bërë aq sa kemi mundur të bëjmë në infrastrukturë. Ne jemi shumë ngushtë me mjedise.

Kemi marrë masa që t’u japim edhe ato gjëra që, në fakt, ligji nuk ua ka dhënë domosdoshmërisht, si për shembull, trupa mbështetëse. Ne u kemi dhënë njerëz nga stafi i ministrisë për t’i mbështetur me protokollin dhe sekretarinë. Pra, janë njerëz që i kemi hequr nga ne dhe i kemi dërguar të punojnë për komisionin, sepse e dimë që kanë vështirësi të karakterit logjistik dhe sa më shumë punonjës të ketë, aq më mirë është. Kjo kërkesë për të shtuar punonjës, të cilën po e dëgjoj tani nga ju, zonja kryetare, është jashtë tagrit tonë për t’u marrë me këtë çështje. Në fakt, kur kemi propozuar ndryshimet në ligj, ne nuk kishim vendosur afat, sepse e dinim që do të kishte shtrëngesa në realizimin e afatit deri në qershor, dhe këtu u kërkua dhe u vendos një afat për të mbyllur procesin. Pra, nëse ju e konsideroni të udhës për të akorduar shtesa për këtë komision, përse jo. Pra financa duhet të merret me këtë çështje, sepse ne nuk jemi kundër. Ne duam që të mbarojë kjo punë një orë e më parë, sepse duam që të largohet presioni psikologjik që ekziston ndaj çdo njeriu që do të dalë për provim atje. Ne jemi të ndërgjegjshëm që edhe njeriu më korrekt në botë ka një farë droje dhe pasigurie kur del përpara një komisioni që të vlerëson. Pra, nuk kemi ndonjë gjë kundër nëse do të gjendet ndonjë burim për të financuar shtesat, për numrat dhe detajet duhet të diskutohet me ata që janë kompetent.

Për sa i përket pyetjes që a mundet SHÇBA-ja ta vazhdojë procesin, po mundet, sepse për SHÇBA-në nuk kemi vendosur një afat dhe procesi do të vazhdojë nga lart poshtë. Unë e kam thënë edhe kur kemi miratuar ndryshimet në ligj që, nëse arrijmë të pastrojmë trupën drejtuese të

Policisë së Shtetit, pjesa tjetër është automatikisht e pastruar, sepse drejtuesit do të kujdesen që policia të jetë në rregull.

Procesi i vetingut është një proces normal i çdo organizate, pavarësisht se ne sot i kemi vendosur një emër të huaj, të cilin e kemi huazuar nga veterinaria, pra vetingu vjen nga veterinaria. Por kontrolli i pastërtisë së figurës së personit që shërben në Policinë e Shtetit është një proces nuk mbaron kurrë, sepse policia kujdeset që në ditën e pranimi të dokumenteve të sigurohen që njerëzit, të cilët rekrutohen në polici, të mos kenë rekord kriminale, të mos kenë lidhje të gabuara e të tjera. Unë them që SHÇBA-ja do ta kryejë misionin në fazën e dytë dhe të tretë, për më tepër që po përforcohet dhe po mbështetet nga partnerët me teknologji, gjë që e thjeshton dhe e lehtëson zhvillimin e procesit. Shumë gjëra do të bëhen nëpërmjet teknologjisë, po përmend poligrafën, thjesht për të dhënë një shembull.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se shumë nga pyetjet që na kanë munduar gjatë gjithë kësaj kohe morën një përgjigje pozitive sot. Mua si kryetare e këtij komisioni, më vjen mirë që këto lajme t'i ndajmë si të mira në të gjitha trupat me të cilat ne kontaktojmë. Sigurisht që ngelen gjëra për t'u reflektuar apo adresuar në të ardhmen, por e rëndësishme është që të vendosen prioritetet si duhen. Nëse do të kisha një kryefjalë për buxhetin e Ministrisë së Brendshme, sipas asaj që ju iu referuat sot në komision, unë do të veçoja teknologjinë. Në vitin 2020 do të punohet shumë me teknologjinë dhe me modernizimin e institucioneve, ku forca e policisë ushtron aktivitetin e saj dhe mjetet që do të ketë në dispozicion, e cila është shumë e rëndësishme, për të kuptuar që në fund do të kemi rezultate shumë më të mira në luftën kundër krimit.

Pra të gjitha ngelen të rëndësishme, e thamë edhe në fillim, puna e Policisë së Shtetit dhe e institucionit të Ministrisë së Brendshme, që përfshin më shumë se Policia e Shtetit, është komplekse dhe vetëm një seancë dëgjimore nuk mjafton për t'i ezauruar të gjitha, por fakti që kanë marrë vëmendje çështjet dhe debatet më kryesore të tyre, patjetër që është për t'u vlerësuar.

Ka edhe detaje të tjera që ngelen të rëndësishme për ta tërhequr vëmendjen, të cilat nuk i thamë. Ka ardhur në rritje buxheti për funksionet e deleguara për pushtetin lokal dhe do të ishte mirë, unë e di që nuk është e gjitha një detyrim juaj, ashtu sikundër, fjala vjen, po investohet në Tiranë në zyrat ku aplikohet për ID-të, e njëjta gjë të ndodhë edhe në për qytetet e tjera, sepse gjendja në të cilën ata ndodhen është e mjerueshme. Kjo është bërë pjesë edhe e disa kronikave

televizive, prandaj do të na vinte mirë që të ketë një përçapje në këtë drejtim dhe investimi të zbriste nga qendra në qytetet e kategorisë së dytë.

Unë përfitoj nga rasti që t'ju njoftoj ju që nesër kemi lënë një seancë dëgjimore me ministren e Financave në orën 12:30. Po e bëj këtë njoftim, sepse lidhet me një punë që ju keni ngritur në institucionin tuaj, fjala është për grupin e ngritur për emergjencat civile, meqenëse pushteti qendror është një pushtet që komunikon me Ministrinë e Brendshme. Ne e kemi thirrur posaçërisht ministren nesër, që të gjitha bashkitë të kuptojnë drejt detyrimin që ato kanë për të vendosur 4% të buxhetit të tyre në funksion të emergjencave civile, por mbi të gjitha të fillojë kontrolli për institucionet qendrore, ndaj ministrive, sepse një detyrim të ngjashëm në masën 2 deri në 4% e kanë edhe ministrinë. Ju keni ngritur një grup pune, ne duam që një përfaqësues i atij grupi pune të ishte prezent gjatë ditës së nesërme, sepse mendojmë që ajo gjë që do të bëjmë nesër nuk është thjesht një çështje në ndihmë të emergjencave civile, por është një çështje që ndërlidh shumë aktorë dhe faktorë, prandaj është momenti i duhur që ne t'i japim përsëri një start kësaj pune.

Besoj që diskutimet i mbyllim këtu, ne ngelemi në mbështetje të fjalës dhe nevojave tuaja.

Unë ju falënderoj për gatishmërinë që kishit për të ardhur sot, por edhe për durimin për të qëndruar deri në fund!

Faleminderit të gjithëve dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA